

UDHËZUESI I PËRDORIMIT

SM-X520
SM-X526B
SM-X620
SM-X626B

Përmbajtja

Fillimi

- 5 Faqosja dhe funksionet e pajisjes
- 9 Karikimi i baterisë
- 12 Karta nano-SIM dhe eSIM (modelet me rrjet celular të aktivizuar)
- 14 Karta microSD
- 16 Ndezja dhe fikja e pajisjes
- 17 Konfigurimi fillestar
- 18 Përdorimi i rrjeteve
- 18 Samsung account
- 19 Transferimi i të dhënave nga pajisja juaj e mëparshme (Smart Switch)
- 19 Njohja e ekranit
- 27 Paneli i njoftimeve
- 28 Paneli i cilësimeve të shpejta
- 30 Fotografimi i ekranit dhe regjistrimi i ekranit
- 32 Formimi i tekstit
- 33 Nxjerrja e tekstit

Aplikacionet dhe veçoritë

- 34 Instalimi ose çinstalimi i aplikacioneve
- 35 S Pen
- 42 Telefon
- 45 Kontaktet
- 48 Kamera
- 60 Galeria
- 64 Bixby

- 65 Bixby Vision
- 66 Multi window (Përdorimi i disa aplikacioneve njëherësh)
- 67 Interneti Samsung
- 68 Samsung Health
- 68 Samsung Notes
- 72 Samsung Members
- 72 Samsung Kids
- 73 Samsung Global Goals
- 73 Samsung TV Plus
- 73 Samsung Find
- 73 Samsung Shop
- 74 PENUP
- 74 Kalendari
- 75 Reminder
- 76 Regjist. Zanor
- 77 Skedarët e Mi (Shikimi dhe menaxhimi i skedarëve)
- 77 Ora
- 77 Kalkulatori
- 78 Gaming Hub
- 78 Game Booster (Konfigurim i mjedisit të lojës)
- 80 SmartThings
- 81 Ndarja e materialeve
- 82 Music Share
- 83 Smart View (Pasqyrim në një ekran televizori)
- 84 Samsung Flow

85	Paneli ditor
87	Samsung DeX
88	Aplikacionet Google

Cilësimet

89	Hyrje
89	Hyr me sign-in në Galaxy
89	Lidhjet
91	Wi-Fi
92	Bluetooth
94	Kursyesi i të dhënave (Modelet me rrjet celular të aktivizuar)
94	Rrjetet e lejuara për app-et (Modelet me rrjet celular të aktivizuar)
95	Shpërndarësja celulare (Modelet me rrjet celular të aktivizuar)
95	Cilësime të tjera të lidhjes
97	Pajisjet e lidhura
98	Regjimet dhe Rutinat
98	Përdorimi i modaliteteve
99	Përdorimi i rutinave
100	Tingull
101	Cilësia & efektet zanore
101	Audio më vete për app-in
102	Njoftimet
102	Ekrani
103	Rrjedhshmëria e lëvizjes
104	Ndryshimi i metodës së ekranit ose rregullimi i ngjyrave të ekranit

105	Bateria
105	Letra e murit dhe stili
106	Faqja bazë
106	Kyç ekranin
107	Zhbllokimi i zgjatur
107	Siguria dhe privatësia
108	Njohja e fytyrës
110	Njohja e shenjës të gishtit
112	Wi-Fi e sigurt
113	Dosja e sigurt
116	Samsung Pass
117	Vendi
118	Siguria dhe urgjencat
119	Llogaritë dhe rezervimi
120	Përdoruesit
121	Samsung Cloud
122	Google
122	Funksionalitete të avancuara
123	Lëvizjet dhe gjestet
124	Efektet video
124	Avatari Galaxy
125	Lajmëtari Dual
126	Mirëqenia Dixhitale dhe kontrollet prindërore
126	Kujdesi për pajisjen
127	App-et
128	Menaxhimi i përgjithshëm
129	Mundësi hyrje
130	Përditësimi i softuerit
131	Rreth tabletës

Njoftimet e përdorimit

- 132 Masa paraprake për përdorimin e pajisjes
- 134 Shënime për përmbajtjen e paketimit dhe aksesorët
- 135 Ruajtja e rezistencës ndaj ujit dhe pluhurit
- 136 Situatat e mbinxehjes së pajisjes dhe zgjidhjet
- 139 Si të gjeni informacionin për konsumin e energjisë në gjendje joaktive për këtë produkt



Shtojcë

- 140 Zgjidhja e problemeve
- 145 Heqja e baterisë



Fillimi

Faqosja dhe funksionet e pajisjes

► SM-X520, SM-X526B:



► SM-X620, SM-X626B:





- Që pajisja të punojë normalisht, përdorni pajisjen në një vend pa interferenca magnetike.
- Pajisja juaj dhe disa nga aksesoret (shiten veçmas) përmbajnë magnete. Mbajeni larg nga kartat e kreditit, pajisjet mjekësore të implantuara dhe pajisje të tjera që mund të ndikohen nga magnetet. Në rastin e pajisjeve mjekësore, mbajeni pajisjen më larg se 15 cm. Mos e përdorni më pajisjen nëse dyshoni për ndonjë interferencë me pajisjen tuaj mjekësore dhe konsultohuni me mjekun ose prodhuesin e pajisjes mjekësore.
- Mbani një distancë të sigurt midis objekteve që ndikohen nga magnetet, pajisjes suaj dhe disa nga aksesoret (shiten veçmas) që përmbajnë magnete. Objektet e tilla si kartat e kreditit, blloqet e transaksioneve, kartat e aksesit, kartat e hipjes në avion, ose kartat e parkimit mund të dëmtohen ose të çaktivizohen nga magnetet në pajisje.



- Kur përdorni altoparlantet, si për shembull kur luani skedarë mediatikë ose përdorni altoparlantin, mos e vendosni pajisjen pranë veshëve.
- Bëni kujdes të mos ekspozoni lentin e kamerës në burim të fortë drite si për shembull drita direkte e diellit. Nëse lentja e kamerës ekspozohet në burim të fortë drite, si për shembull në dritën e diellit, sensori i imazhit të kamerës mund të dëmtohet. Sensori i dëmtuar është pjesë që nuk ndërrohet dhe shkakton pika ose njolla në fotografi.
- Nëse e përdorni pajisjen me xhamin ose trupin akrilik të thyer, ekziston rreziku të lëndoheni. Përdorni pajisjen vetëm pasi të jetë riparuar në një qendër shërbimi Samsung ose në një qendër shërbimi të autorizuar.
- Nëse në mikrofoni, altoparlant ose receptor futet pluhur ose materiale të huaja, apo nëse ndonjë prej këtyre pjesëve mbulohet, volumi i pajisjes mund të ulet ose disa veçori mund të mos funksionojnë. Nëse përpiqeni të hiqni pluhurin ose materialet e huaja me objekt të mprehtë, pajisja mund të dëmtohet dhe mund të prishet pamja e saj.



- Mund të ketë probleme me lidhjen dhe rënie e baterisë në situatat e mëposhtme:
 - Nëse ngjitni ngjitëse metalike mbi zonën e antenës në pajisje.
 - Nëse vendosni një kapak prej materiali metalik në pajisje.
 - Nëse e mbuloni zonën e antenës së pajisjes me duar ose objekte të tjera ndërsa përdorni veçori të caktuara, si për shembull telefonatat ose lidhjen e internetit celular.
- Nëse vrima e ajrimit është e mbuluar nga ndonjë aksesor, si për shembull një qese mbrojtëse ose ngjitëse, mund të ndodhin zhurma të padëshiruara gjatë telefonatave ose luajtjes së medias.
- Mos e mbuloni pjesën e sensorit të dritës me aksesore, si për ngjitëse ose kapak. Kjo mund të bëjë që sensori të mos funksionojë mirë.

Butonat e ngurtë

Button	Funksioni
Butoni Anësor	- Kur pajisja është e fikur, shtypeni dhe mbajeni shtypur për ta ndezur. - Shtypni për të ndezur ose kyçur ekranin. - Shtypeni dy herë ose shtypeni dhe mbajeni shtypur për të hapur aplikacionin ose veçorinë që keni vendosur.
Butoni anësor + butoni i uljes së volumit	- Shtypini njëkohësisht për të bërë një foto ekрани. - Shtypini dhe mbajini shtypur njëkohësisht për ta fikur pajisjen.

Caktimi i butonit anësor

Zgjidhni një aplikacion ose veçori duke shtypur butonin anësor dy herë ose duke shtypur dhe mbajtur shtypur butonin anësor.

Hapni **Cilësimet**, shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **Butoni Anësor**, dhe më pas zgjidhni një opsion që doni.

Butonat me prekje


Kur e ndizni ekranin, butonat me prekje do të shfaqen në fund të ekranit. Për më shumë informacion, shihni [Shiriti i navigimit \(butonat me prekje\)](#).

Karikimi i baterisë

Karikojeni baterinë para se ta përdorni për herë të parë ose kur nuk është përdorur për periudha të gjata.

Karikimi me kabëll

Lidhni kabllon USB me karikuesin me karikuesin me USB, dhe lidhni kabllon në xhekun multifunksional për ta karikuar baterinë. Pasi ta keni karikuar plotësisht, shkëputeni karikuesin nga pajisja.



Karikimi i shpejtë

Përdorni një karikues super të shpejtë ose karikues të shpejtë.

Mund të kontrolloni gjendjen e lidhjes së karikuesit duke hapur **Cilësimet** dhe duke shtypur **Bateria**.



- Nëse karikimi i shpejtë nuk punon, hapni **Cilësimet**, shtypni **Bateria** → **Cilësimet e karikimit**, dhe më pas kontrolloni nëse veçoria që doni është e aktivizuar. Gjithashtu kontrolloni nëse kabloja USB dhe karikuesi me USB janë lidhur siç duhet.
- Mund ta karikoni baterinë më shpejt ndërsa pajisja ose ekrani është i fikur.

Karikimi i pajisjeve të tjera

Përdorni kabllon USB për të karikuar një pajisje tjetër celulare me baterinë e tabletës suaj.

Lidhni tabletën dhe pajisjen tjetër duke përdorur kabllon USB të tabletës. Mund të nevojitet një konektor USB në varësi të pajisjes tjetër.

Kur të fillojë karikimi, ikona e karikimit të baterisë do të shfaqet në ekranin e pajisjes tjetër.



Dritarja kërcyese e zgjedhjes së aplikacionit që shfaqet në tabletë është për transferimin e të dhënave. Mos zgjidhni aplikacion nga dritarja kërcyese.

Ulja e konsumit të baterisë

Pajisja juaj ofron mundësi të ndryshme që ju ndihmojnë të kurseni energjinë e baterisë.

- Optimizoni pajisjen duke përdorur veçorinë e kujdesit për pajisjen.
- Kur nuk e përdorni pajisjen, fiken ekranin duke shtypur butonin anësor.
- Aktivizoni modalitetin e kursimit të energjisë.
- Mbyllni aplikacionet e panevojshme.
- Çaktivizoni veçorinë Bluetooth kur nuk e përdorni.
- Çaktivizoni sinkronizimin automatik të aplikacioneve që duhet të sinkronizohen.
- Ulni kohën e dritës së sfondit.
- Ulni ndriçimin e ekranit.

Këshilla dhe masa paraprake për karikimin e baterisë



- Përdorni vetëm bateri të miratuara nga Samsung që janë projektuar në mënyrë specifike për pajisjen tuaj. Bateritë e papajtueshme mund të shkaktojnë lëndime të rënda ose dëmtime në pajisje.
- Rekomandohet të përdorni karikues dhe kabllo të miratuar nga Samsung që janë bërë posaçërisht për pajisjen tuaj. Përdorimi i karikuesve ose kablllove të papajtueshëm mund të shkaktojë lëndime fizike ose dëmtime në pajisje.



- Lidhja e karikuesit në mënyrë të gabuar mund t'i shkaktojë dëme serioze pajisjes. Çdo dëm i shkaktuar nga keqpërdorimi nuk mbulohet nga garancia.
- Rekomandohet përdorimi i kablllos USB-C të dhënë bashkë me pajisjen. Përdorimi i një kabllloje Micro USB mund ta dëmtojë pajisjen.
- Nëse e karikoni pajisjen ndërsa xheku multifunksional është i njomë, pajisja mund të dëmtohet. Thajeni mirë xhekun multifunksional para se ta karikoni pajisjen.



- Për të kursyer energjinë, hiqeni karikuesin nga priza kur nuk e përdorni. Karikuesi nuk ka çelës energjie, prandaj duhet ta hiqni atë nga priza elektrike kur nuk e përdorni për të mos shpërdoruar energji. Karikuesi duhet të qëndrojë pranë prizës elektrike dhe të arrihet me lehtësi gjatë karikimit.
- Rekomandohet përdorimi i një karikuesi të miratuar nga Samsung që garanton performancën e karikimit.
- Nëse bateria është e shkarkuar plotësisht, pajisja nuk mund të ndizet menjëherë kur është lidhur me karikuesin. Lini kohë që bateria e shkarkuar të karikohet për disa minuta para se të ndizni pajisjen.
- Nëse përdorni shumë aplikacione njëherësh, aplikacione rrjeti ose aplikacione që duan lidhje me një pajisje tjetër, bateria do të bjerë shpejt. Për të shmangur humbjen e energjisë gjatë transferimit të të dhënave, gjithmonë përdorni këto aplikacione pasi ta keni karikuar baterinë plotësisht.
- Përdorimi i një burimi energjie përveç karikuesit, si për shembull kompjuter, mund të rezultojë në shpejtësi karikimi më të ulët për shkak të rrymës elektrike më të ulët.
- Pajisja mund të përdoret ndërkohë që po karikohet, por mund të zgjasë më shumë derisa bateria të karikohet plotësisht.
- Nëse pajisja merr energji të paqëndrueshme ndërsa karikohet, ekrani mund të mos funksionojë. Nëse ndodh kjo, shkëputeni karikuesin nga pajisja.
- Ndërkohë që karkohet, pajisja dhe karikuesi mund të nxehen. Kjo është normale dhe nuk ndikon në jetëgjatësinë ose performancën e pajisjes. Nëse bateria nxehet më shumë se zakonisht, karikuesi mund të mos karikojë më.
- Nëse pajisja nuk po karikohet siç duhet, çojeni pajisjen dhe karikuesin te një qendër shërbimi Samsung ose te një qendër të autorizuar shërbimi.

Karta nano-SIM dhe eSIM (modelet me rrjet celular të aktivizuar)

Vendosni kartën SIM ose USIM ose shkarkoni eSIM që ofrohet nga operatori.


Ndryshe nga një kartë nano-SIM, karta eSIM është një kartë SIM dixhitale e brendshme. Për të pasur dy numra telefoni ose dy operatorë në një pajisje të vetme, shkarkoni një eSIM tjetër.




- eSIM mund të mos jetë i disponueshëm në varësi të rajonit, operatorit ose modelit.
- Disa shërbime që kërkojnë lidhje rrjeti mund të mos jenë të disponueshme në varësi të operatorit.
- Përdorimi i kartës nano-SIM dhe kartës eSIM së bashku, ose i dy kartave eSIM njëkohësisht mund të ulë shpejtësinë e transferimit të të dhënave në disa zona.

Vendosja e kartës SIM ose USIM

► SM-X526B:



► SM-X626B:



- 1 Futni kunjën e nxjerrjes në vrimën e sirtarit për ta liruar sirtarin.
- 2 Tërhiqeni me kujdes sirtarin nga foleja e sirtarit.
- 3 Vendoseni kartën SIM ose USIM në sirtarin me kontaktet me ngjyra të drejtuar për lart dhe shtypeni me kujdes kartën SIM ose USIM në sirtar për ta fiksuar.

4 Futeni sirtarin përsëri në folenë e sirtarit.



- Përdorni vetëm kartë nano-SIM.
- Bëni kujdes të mos e humbni ose kur i lejoni të tjerët të përdorin kartën SIM ose USIM. Samsung nuk është përgjegjës për asnjë dëmtim ose pakënaqësi që mund të shkaktohet nga kartat e humbura ose të vjedhura.
- Sigurohuni që kunja e nxjerrjes të jetë pingul me vrimën. Përndryshe mund të dëmtohet pajisja.
- Nëse karta nuk është fiksuar mirë në sirtar, karta SIM mund të dalë ose të bjerë nga sirtari.
- Nëse e futni sirtarin në pajisje me sirtarin të njomë, mund të dëmtohet pajisja. Gjithmonë sigurohuni që sirtari të jetë i thatë.
- Futeni plotësisht sirtarin në folenë e sirtarit për të mos lejuar që të futen lëngje në pajisje.

Shkarkimi i një eSIM

Hapni **Cilësimet**, prekni **Lidhjet** → **Menaxheri SIM** → **Shto eSIM-in** dhe më pas ndiqni udhëzimet në ekran për të shkarkuar kartën eSIM.

Nëse operatori ju ka dhënë një kod QR, hapni **Cilësimet**, shtypni **Lidhjet** → **Menaxheri SIM** → **Shto eSIM-in** → **Skano kodin QR**, dhe pastaj skanoni kodin QR.

Menaxheri SIM

Hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Lidhjet** → **Menaxheri SIM**.

- **Kartat SIM:** Aktivizoni kartën SIM që doni të përdorni dhe personalizoni cilësimet e kartës SIM.
- **eSIM-et:** Shkarkoni ose aktivizoni eSIM.
- **SIM-et e preferuara:** Zgjidhni të përdorni një kartë SIM të caktuar për disa veçori, si për shembull telefonatat me zë, kur janë të aktivizuara dy karta.
- **Këmbimi i të dhënave:** Vendoseni pajisjen që të përdorë një kartë SIM tjetër për internetin celular nëse karta SIM e preferuar nuk mund të lidhet me rrjetin.



Mund të tarifohehi më shumë kur përdorni këtë veçori.


- **Cilësime të tjera SIM:** Personalizoni cilësime të tjera.

Karta microSD


Vendosja e një karte SD

Kapaciteti i kartës SD të pajisjes suaj mund të ndryshojë nga modelet e tjera dhe disa karta SD mund të mos jenë të pajtueshme me pajisjen tuaj në varësi të prodhuesit dhe llojit të kartës SD. Për të parë kapacitetin maksimal të kartës SD të pajisjes, referojuni faqes së internetit të Samsung.

► SM-X520, SM-X526B:



► SM-X620, SM-X626B:



- 1 Futni kunjën e nxjerrjes në vrimën e sirtarit për ta liruar sirtarin.
 - 2 Tërhiqeni me kujdes sirtarin nga foleja e sirtarit.
 - 3 Vendosni një kartë SD në sirtar me kontaktet ngjyrë ari të drejtuara lart dhe shtypeni lehtë kartën SD te sirtari për ta fiksuar.
 - 4 Futeni sirtarin përsëri në folenë e sirtarit.
-  • Përdorni vetëm një kartë microSD.
 - Disa karta SD mund të mos jenë plotësisht të pajtueshme me pajisjen. Përdorimi i një karte të papajtueshme mund ta dëmtojë pajisjen, kartën SD ose të dhënat e ruajtura në të.
 - Bëni kujdes që ta vendosni kartën SD të kthyer siç duhet.
 - Sigurohuni që kunja e nxjerrjes të jetë pingul me vrimën. Përndryshe mund të dëmtohet pajisja.
 - Kur e hiqni sirtarin nga pajisja, lidhja e internetit celular do të çaktivizohet. (Modelet me rrjet celular të aktivizuar)
 - Nëse karta nuk është fiksuar mirë në sirtar, karta SD mund të dalë ose të bjerë nga sirtari.
 - Nëse e futni sirtarin në pajisje me sirtarin të njomë, mund të dëmtohet pajisja. Gjithmonë sigurohuni që sirtari të jetë i thatë.
 - Futeni plotësisht sirtarin në folenë e sirtarit për të mos lejuar që të futen lëngje në pajisje.
-  • Pajisja mbështet sistemet e skedarëve FAT dhe exFAT për kartat SD. Kur vendosni një kartë të formatuar në një sistem tjetër skedarësh, pajisja do të kërkojë që ta riformatojë kartën, përndryshe nuk do ta njohë kartën. Për ta përdorur kartën SD, duhet ta formatoni. Nëse pajisja juaj nuk mund ta riformatojë ose njohë kartën SD, kontaktoni prodhuesin e kartës SD, një qendër shërbimi të Samsung ose një qendër shërbimi të autorizuar.
 - Shkrimi dhe fshirja e shpeshtë e të dhënave e shkurton jetëgjatësinë e kartave SD.
 - Kur futni një kartë SD në pajisje, direktoria e skedarëve të kartës SD shfaqet te dosja **Skedarët e Mi → Kartë SD**.

Heqja e kartës SD

Para se ta hiqni kartën SD, në fillim bëni shkëputjen për ta hequr në mënyrë të sigurt.

1 Hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Kujdesi për pajisjen** → **Magazinë**.

2 Lëvizni majtas për të hapur faqen e **Kartë SD**.

3 Shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Çmonto**.



Mos e hiqni magazinën e jashtme, si për shembull një kartë SD ose magazinë USB, ndërkohë që pajisja është duke transferuar ose përdorur informacion, ose menjëherë pasi keni transferuar të dhëna. Kjo mund të bëjë që të dhënat të dëmtohen ose të humbasin, ose mund t'i shkaktojë dëme magazinës së jashtme ose tabletës. Samsung nuk është përgjegjës për humbjet, duke përfshirë humbjen e të dhënave, që ndodhin për shkak të keqpërdorimit të pajisjeve magazinuese të jashtme.

Formatimi i kartës SD

Një kartë SD e formatuar në kompjuter mund të mos jetë e pajtueshme me pajisjen. Formatoni kartën SD në pajisje.

1 Hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Kujdesi për pajisjen** → **Magazinë**.

2 Lëvizni majtas për të hapur faqen e **Kartë SD**.

3 Shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Formato**.



Para se të formatoni kartën SD, mos harroni të arkivoni kopje të të gjitha të dhënave të rëndësishme të ruajtura në kartën SD. Garancia e prodhuesit nuk mbulon humbjen e të dhënave të shkaktuar nga veprimet e përdoruesit.

Ndezja dhe fikja e pajisjes



Ndiqui të gjitha paralajmërimet dhe udhëzimet e postuara nga personeli i autorizuar në zonat ku është i kufizuar përdorimi i pajisjeve me valë, si në aeroplanë dhe në spitale.

Ndezja e pajisjes

Shtypni dhe mbani shtypur butonin anësor për disa sekonda për ta ndezur pajisjen.

Fikja e pajisjes

- 1 Për ta fikur pajisjen, shtypni dhe mbani shtypur njëkohësisht butonin anësor dhe butonin e uljes së volumit. Ose, hapni panelin e cilësimeve të shpejta dhe prekni ikonën “Fik” (🔌).
- 2 Shtypni **Fik** → **Fik**.
Për ta rindezur pajisjen, shtypni **Rinis** → **Rinis**.



Nëse doni ta vendosni pajisjen të fiket kur shtypni dhe mbani shtypur butonin anësor, shtypni **Cilësimet e Butonit Anësor** → **Shtypje e gjatë** → **Menyja e fikjes**.

Rindezja me detyrim

Nëse pajisja juaj ka ngrirë dhe nuk përgjigjet, shtypni dhe mbani shtypur butonin anësor dhe butonin e uljes së volumit njëkohësisht për më shumë se 7 sekonda për ta rindezur.

Telefonatat e emergjencës dhe informacionet mjekësore (Modelet me rrjet celular të aktivizuar)

Mund të bëni një telefonatë emergjence ose të shikoni informacione mjekësore që keni ruajtur.

Shtypni dhe mbani shtypur njëkohësisht butonin anësor dhe butonin e uljes së volumit, dhe më pas shtypni **Telefonatë urgjence** ose **Informacion mjekësor**. Ose, hapni panelin e cilësimeve të shpejta dhe prekni ikonën “Fik” (🔌) → **Telefonatë urgjence** ose **Informacion mjekësor**.



Për të menaxhuar informacionet tuaja mjekësore dhe kontaktet emergjencës, hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Siguria dhe urgjencat**.

Konfigurimi fillestar

Kur e ndizni pajisjen për herë të parë ose pasi keni bërë një rivendosje të të dhënave, ndiqni udhëzimet në ekran për të konfiguruar pajisjen tuaj.



Nëse nuk lidheni me një rrjet Wi-Fi, mund të mos jeni në gjendje të konfiguroni disa veçori gjatë konfigurimit fillestar.

Përdorimi i rrjeteve

Mund të përdorni rrjete të tilla si, Wi-Fi, Bluetooth, ose rrjet celular.

Hapni **Cilësimet**, shtypni **Lidhjet**, dhe më pas shtypni çelësin e rrjetit që doni për ta aktivizuar.

Për rrjetin celular, shtypni **Përdorimi i të dhënave** dhe shtypni çelësin **Të dhënat celulare** për ta aktivizuar.

Kur nuk e përdorni rrjetin, shtypni çelësin për ta çaktivizuar.



Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të modelit.

Samsung account

Duke përdorur llogarinë Samsung mund të përdorni një sërë shërbimesh të Samsung që ofrohen nëpërmjet pajisjeve celulare, televizorëve dhe faqes së internetit të Samsung.

Për të kontrolluar listën e shërbimeve që mund të përdoren me llogarinë tuaj Samsung, vizitoni account.samsung.com.

- 1 Hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Hyr me sign-in në Galaxy**.
Ose hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Llogaritë dhe rezervimi** → **Menaxho llogaritë** → **Shto llogari** → **Samsung account**.
- 2 Hyni në llogarinë tuaj Samsung. Nëse nuk merrni një llogari Samsung, shtypni **E ke harruar fjalëkalimin apo nuk ke llogari?** → **Krijo llogari**.

Gjetja e ID-së suaj dhe rivendosja e fjalëkalimit

Nëse e harroni ID-në ose fjalëkalimin e llogarisë suaj Samsung, shtypni **E ke harruar fjalëkalimin apo nuk ke llogari?** → **Harrova ID-në ose Harrova fjalëkalimin** në ekranin e hyrjes në llogarinë Samsung. Mund të gjeni ID-në tuaj ose të rivendosni fjalëkalimin tuaj pasi të keni vendosur informacionet e kërkuara.

Dalja nga llogaria juaj Samsung

Kur dilni nga llogaria juaj Samsung, të dhënat tuaja, si për shembull kontaktet ose eventet, do të fshihen gjithashtu nga pajisja juaj.

- 1 Hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Llogaritë dhe rezervimi** → **Menaxho llogaritë**.
- 2 Shtypni **Samsung account** → **Profili im** dhe shtypni **Shkëputu** në fund të ekranit.
- 3 Shtypni **Shkëputu**, vendosni fjalëkalimin e llogarisë Samsung, dhe pastaj shtypni **Ok**.

Transferimi i të dhënave nga pajisja juaj e mëparshme (Smart Switch)

Transferoni të dhënat nga pajisja juaj e mëparshme me kabllon USB ose me valë. Gjithashtu mund të transferoni të dhëna nga magazina e jashtme ose nga kompjuteri.

Hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Llogaritë dhe rezervimi** → **Transfero të dh. për konfigurim**, më pas ndiqni udhëzimet në ekran për të transferuar të dhëna.

Vizitoni www.samsung.com/smartswitch për hollësi dhe kufizime.

- Për të transferuar të dhënat duke përdorur magazinë të jashtme, shtypni ikonën e magazinës së jashtme (📁).
- Për të kontrolluar të dhënat që janë transferuar, shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Rezultari i transferimit**.



- Kjo veçori mund të mos mbështetet në disa pajisje ose kompjuterë.
- Samsung i merr seriozisht të drejtat e autorit. Transferoni vetëm materiale që janë tuajat ose për të cilat keni të drejtë t'i transferoni.

Njohja e ekranit

Kontrollimi i ekranit

- Shtypja: Shtypni në ekran.
- Prekja dhe mbajtja prekur: Prekni dhe mbani prekur ekranin për rreth 2 sekonda.
- Tërheqja: Prekni dhe mbani prekur diçka dhe tërhiqeni në pozicionin që doni.
- Shtypja dy herë: Shtypni dy herë ekranin.
- Rrëshqitja: Rrëshqitni lart, poshtë, majtas ose djathtas.
- Hapja dhe mbyllja e gishtave: Hapini dy gishtat ose mbyllini në ekran.



- Mos lejoni që ekranin të bjerë në kontakt me pajisje të tjera elektrike. Shkarkimet elektrostatike mund të bëjnë që ekranin të mos funksionojë mirë.
- Për të shmangur dëmtimin e ekranit, mos e shtypni me sende të mprehta ose mos ushtroni forcë të tepërt në të me gishta ose me ndonjë objekt tjetër.
- Rekomandohet që të mos përdorni pamje të fiksuara në një pjesë apo në të gjithë ekranin për kohë të gjatë. Kjo mund të shkaktojë mbetje të imazhit më pas (djegie e ekranit) ose hijezim.



Pajisja mund të mos i njohë komandat me prekje pranë skajeve të ekranit, të cilat janë jashtë zonës të komandave me prekje.

Shiriti i navigimit (butonat me prekje)

Kur e ndizni ekranin, butonat me prekje do të shfaqen në shiritin e navigimit në fund të ekranit. Butonat me prekje janë vendosur në butonin Të fundit, butonin Bazë dhe butonin Prapa si standard. Funksionet e butonave mund të ndryshojnë sipas aplikacionit që po përdoret ose ambientit të përdorimit.

Button	Funksioni
Të fundit ()	Shtypni për të hapur listën e aplikacioneve të hapura së fundi.
Bazë (○)	• Shtypni për t'u kthyer në ekranin fillestar. • Prekni dhe mbani prekur Qarko për të kërkuar. Shtypni ose vizatoni një rreth anembanë një imazhi ose teksti.
Prapa (<)	Shtypni për t'u rikthyer në ekranin e mëparshëm.

Fshehja e shiritit të navigimit

Shikoni skedarët ose përdorni aplikacionet në ekran më të gjerë duke fshehur shiritin e navigimit.

Hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Ekrani** → **Shiriti i navigimit** → **Gjestet e rrëshqitjes**.

Ekrani fillestar dhe ekran i aplikacioneve


Ekrani Fillestar është pika e nisjes për të përdorur të gjitha veçoritë e pajisjes. Tregon widget-ët, shkurtoret për aplikacione dhe më shumë.

Ekrani i Aplikacioneve tregon ikonat për të gjitha aplikacionet, përfshirë aplikacionet e sapo instaluar.

Kalimi midis ekranit fillestar dhe ekranit të aplikacioneve.

Në ekranin fillestar, lëvizni lart për të hapur ekranin e aplikacioneve.

Për t'u kthyer në ekranin fillestar, lëvizni lart ose poshtë në ekranin e aplikacioneve. Ose shtypni butonin bazë (○) ose butonin Prapa (<).



Nëse shtoni butonin e aplikacioneve në ekranin fillestar, mund të përdorni ekranin e aplikacioneve duke shtypur butonin. Në ekranin fillestar, prekni dhe mbani prekur një zonë bosh, shtypni **Cilësimet**, dhe pastaj shtypni çelësin **Trego butonin e ekranit App-et në Ekranin bazë** për ta çaktivizuar. Butoni i aplikacioneve (⋮) do të shtohet në fund të ekranit fillestar.

Modifikimi i ekranit fillestar

Në ekranin fillestar, prekni dhe mbani prekur një zonë bosh, ose pickoni gishtat së bashku për të hapur opsionet e modifikimit. Mund të vendosni figurën e murit, të shtoni widget-ë, e të tjera.

- **Letra e murit dhe stili:** Ndryshoni cilësimet e ekranit për Ekranin fillestar dhe ekranin e kyçur.
- **Mini-Programet:** Widget-ët janë aplikacione të vogla që hapin veçori të caktuara për të ofruar informacione të reja dhe akses të lehtë në ekranin fillestar. Zgjidhni një widget dhe shtypni **Shto**. Widget-i do të shtohet në ekranin fillestar.
- **Cilësimet:** Konfiguroni cilësimet për ekranin fillestar, si për shembull pamjen në ekran.

Gjithashtu mund të shtoni, fshini ose riorganizoni panelet e ekranit fillestar.

- Shtimi i paneleve: Rrëshqitni majtas dhe pastaj shtypni e shtimit të faqes (+).
- Lëvizja e paneleve: Tërhiqni një shikim paraprak paneli te një vend i ri.
- Fshirja e paneleve: Shtypni ikonën e heqjes (🗑️) mbi panel.

Shfaqja e të gjitha aplikacioneve në ekranin fillestar

Pa përdorur një ekran të veçantë të aplikacioneve, mund ta vendosni pajisjen që të shfaqë të gjitha aplikacionet në ekranin fillestar. Në ekranin fillestar, prekni dhe mbani prekur një vend bosh dhe pastaj shtypni **Cilësimet** → **Struktura e ekranit bazë** → **Vetëm Ekranin bazë** → **Zbato**.

Hapja e Finder

Kërkoni materiale në pajisje.

- 1 Në ekranin e aplikacioneve, shtypni **Kërko**.
- 2 Formoni një fjalë kyçe.
Do të bëhet kërkimi në aplikacione dhe në pajisjen tuaj.
Nëse shtypni ikonën e kërkimit (🔍) mbi tastierë, mund të kërkoni më shumë materiale.

Lëvizja e artikujve

Tërhiqni një objekt te një vend i ri. Për ta lëvizur artikullin në një panel tjetër, tërhiqeni në anë të ekranit. Nëse e prekni dhe mbani shtypur një artikull dhe shtypni **Përzgjidh**, mund të zgjidhni më shumë artikuj dhe t'i lëvizni së bashku njëherësh.


Për të shtuar një shkurtore në ekranin fillestar, prekni dhe mbani prekur diçka në ekranin e aplikacioneve, dhe pastaj shtypni **Shto te Baza**. Në ekranin fillestar do të shtohet një shkurtore për aplikacionin.

Gjithashtu mund të lëvizni aplikacione të përdorura shpesh në pjesën në fund të ekranit Fillestar.

Krijimi i folderave

Në ekranin fillestar ose në ekranin e aplikacioneve, prekni dhe mbani prekur një aplikacion dhe pastaj tërhiqeni sipër një aplikacioni tjetër.

Do të krijohet një folder i ri që përmban aplikacionet e zgjedhura. Shtypni **Emri i dosjes** dhe vendosni një emër folderi.



- **Shtimi i më shumë aplikacioneve**

Shtypni ikonën e shtimit të aplikacioneve (⊕) mbi dosje. Shënoni aplikacionet që doni të shtoni dhe shtypni **Kryer**. Gjithashtu mund të shtoni një aplikacion duke e tërhequr në folder.

- **Lëvizja e aplikacioneve nga një folder**

Tërhiqni një aplikacion te një vend i ri.

- **Fshirja e një folderi**

Prekni dhe mbani shtypur një folder, dhe pastaj shtypni **Hiq**. Vetëm folderi do të fshihet. Aplikacionet e folderit do të zhvendosen në ekranin e aplikacioneve.

Taskbari

Taskbari shfaqet në fund të ekranit ndërsa përdorni aplikacionin. Butoni i aplikacioneve të preferuara nga fundi i ekranit fillestar, butoni i aplikacioneve të përdorura së fundi dhe butoni i të gjitha aplikacioneve do të shfaqen në taskbar. Mund t'i ndryshoni aplikacionet duke zgjedhur aplikacionin që doni nga taskbari.

Gjithashtu mund të hapni disa aplikacione njëherësh. Ndërsa përdorni një aplikacion, tërhiqeni lart nga taskbari aplikacionin që doni, dhe më pas lëshojeni kudo që doni.




Nëse nuk doni ta përdorni taskbarin, hapni **Cilësimet**, shtypni **Ekrani**, dhe më pas shtypni çelësin **Shiriti i detyrave** për ta fikur.

Paneli Edge

Mund të hapni aplikacionet dhe veçoritë tuaja të preferuara nga panelet e anës.

Tërhiqeni panelin e anës drejt mesit të ekranit.

Nëse doreza e panelit të anës nuk është e dukshme, hapni **Cilësimet**, shtypni **Ekrani**, dhe pastaj shtypni çelësin **Panelet anësore** për ta aktivizuar.



Ekrani i kyçur

Shtypja e butonit anësor e fik ekranin dhe e kyç. Gjithashtu, ekrani fiket automatikisht nëse pajisja nuk përdoret për një periudhë të caktuar.

Për ta zhbllokuar ekranin, lëvizni në cilindo drejtim, përveç poshtë, kur ekranin ndizet.

Nëse ekranin është i fikur, shtypni butonin anësor për ta ndezur ekranin. Ose shtypni dy herë ekranin.

Modifikimi i shkurtoreve

Mund t'i ndryshoni shkurtoret në fund të ekranit të kyçur për të zgjedhur aplikacionet ose veçoritë që doni.

Prekni dhe mbani prekur ekranin e kyçur, shtypni ikonën e shkurttores dhe zgjidhni një aplikacion ose veçori që doni, dhe shtypni **U krye**.

Ndryshimi i metodës të kyçjes së ekranit

Për të ndryshuar metodën e kyçjes, hapni **Cilësimet**, shtypni **Kyç ekranin → Bllokimi i ekranit & biometrika**, dhe më pas zgjidhni një metodë.

Kur vendosni një vizatim, PIN, fjalëkalim ose të dhënat tuaja biometrike për modalitetin e kyçjes së ekranit, mund t'i mbronin informacionet tuaja personale duke mos i lejuar të tjerët të përdorin pajisjen tuaj. Pasi të keni vendosur metodën e kyçjes së ekranit, pajisja do të kërkojë një kod hapjeje sa herë që e zhbllokon.



Mund të bëni që pajisja juaj të bëjë një rivendosje të të dhënave të fabrikës sa herë që vendoset kodi i zhbllokimit disa herë me radhë gabim dhe arrihet limiti i provave. Hapni **Cilësimet**, shtypni **Kyç ekranin → Cilësimet e Bllokimit të sigurt**, zhbllokoni ekranin duke përdorur metodën e caktuar përpara për kyçjen e ekranit, dhe pastaj shtypni çelësin **Resetim auto fabrikë** për ta aktivizuar.

Ikonat treguese

Ikonat treguese shfaqen në shiritin e statusit në krye të ekranit. Ikonat e renditura në tabelë janë më të hasurat.

Ikona	Kuptimi
•	Njoftime të reja
⊘	S'ka sinjal
▬▬▬	Fuqia e sinjalit
▬▬▬	Roaming (jashtë zonës normale të shërbimit)
G ↕	Rrjeti GPRS i lidhur
E ↕	Rrjeti EDGE i lidhur
3G ↕	Rrjeti UMTS i lidhur
H ↕	Rrjeti HSDPA i lidhur
H+ ↕	Rrjeti HSPA+ i lidhur
4G ↕ / LTE ↕	Rrjeti LTE i lidhur

Ikona	Kuptimi
	Rrjeti 5G i lidhur
	Rrjeti LTE i lidhur në rrjetin LTE që përfshin rrjetin 5G
	I lidhur me Wi-Fi
	Veçoria Bluetooth e aktivizuar
	Po përdoren shërbimet e vendndodhjes
	Telefonatë në zhvillim
	Telefonatë e humbur
	Alarmi i aktivizuar
	Regjimi i heshtjes
	Modaliteti i fluturimit i aktivizuar
	Ndodhi një gabim ose kërkohet vëmendje
	Karikimi i baterisë / Niveli i energjisë së baterisë




- Shiriti i statusit mund të mos shfaqet në krye të ekranit në disa aplikacione. Për të shfaqur shiritin e statusit, tërhiqni poshtë nga kreu i ekranit.
- Disa ikona treguesi shfaqen vetëm kur hapni panelin e njoftimeve.
- Disa njoftime do të shfaqen si një pikë.
- Ikonat treguese mund të shfaqen ndryshe në varësi të operatorit ose modelit.

Paneli i njoftimeve

Kur merrni njoftime të reja, ikona treguese shfaqet në shiritin e statusit. Hapni panelin e njoftimeve për të kontrolluar detajet.

Për të hapur panelin e njoftimeve, rrëshqitni poshtë nga kreu i ekranit, përveçse për anën e djathtë. Për të mbyllur panelin e njoftimeve, rrëshqitni lart mbi ekran.




Paneli i cilësimeve të shpejta

Mund të aktivizoni ose çaktivizoni veçori specifike, si për shembull veçorinë Wi-Fi ose Bluetooth, duke shtypur secilin buton.

Për të hapur panelin e cilësimeve të shpejta, rrëshqitni poshtë nga ana e djathtë e sipërme e ekranit. Për të mbyllur panelin e cilësimeve të shpejta, rrëshqitni lart mbi ekran.

Për të parë cilësime më të detajuara, prekni dhe mbani prekur një buton. Për të modifikuar butonat, shtypni ikonën e modifikimit (✎) → **Edito**.



Kjo pamje mund të ndryshojë në varësi të rajonit ose modelit.

Kontrollimi i luajtjes së medias

Kontrolloni median në tabletin tuaj dhe pajisjet e lidhura pranë në panelin e cilësimeve të shpejta.

- 1 Hapni panelin e cilësimeve të shpejta dhe shtypni **Dalja për media**.
- 2 Shtypni ikonat në kontrollor për të kontrolluar luajtjen.

Kontrollimi i pajisjeve pranë

Kontrolloni pajisjet e lidhura pranë ose lidhni pajisjet e tjera pranë në panelin e cilësimeve të shpejta.

- 1 Hapni panelin e cilësimeve të shpejta dhe shtypni **Pajisjet në afërsi**.
Pajisjet e lidhura pranë do të shfaqen me një vijë që i lidh me rrethin rrotull tabletit tuaj.
- 2 Zgjidhni një pajisje pranë për ta kontrolluar.
 - Për të lidhur pajisjet pranë, tërhiqeni pajisjen nga paneli në fund të ekranit për të qarkuar.
 - Për ta mbyllur lidhje, tërhiqeni pajisjen te paneli në fund të ekranit.

Kontrollimi i pajisjeve të përdorura shpesh

Kontrolloni pajisjet e lidhura me aplikacionet e kontrollit të pajisjes, si SmartThings, dhe rutinat manuale në panelin e cilësimeve të shpejta.

- 1 Hapni panelin e cilësimeve të shpejta dhe shtypni **SmartThings**.
- 2 Shtypni çelësin pas aplikacionit që doni të aktivizoni dhe shtypni **Fillo**.
Pajisjet e lidhura dhe rutinat manuale do të shfaqen.
- 3 Zgjidhni një pajisje për ta kontrolluar, ose zgjidhni një rutinë manuale për ta hapur.

Fotografimi i ekranit dhe regjistrimi i ekranit

Kapja e ekranit

Bëni një foto ekrani kur e përdorni pajisjen dhe shkruani sipër, vizatoni sipër, pritni ose ndani ekranin e fotografuar. Mund të fotografoni ekranin aktual dhe pjesën e rrëshqitshme.

Si të bëni një foto ekrani

Përdorni metodat e mëposhtme për të bërë një foto ekrani. Mund të shikoni fotot e bëra të ekranit te **Galeria**.

- Fotografimi me buton

Shtypni njëkohësisht butonin anësor dhe butonin e uljes së volumit.

- Fotografimi me lëvizje

Duke përdorur anën e dorës, lëvizeni dorën majtas ose djathtas në ekran.

Nëse fotografimi i ekranit duke rrëshqitur nuk është i aktivizuar, hapni **Cilësimet**, shtypni

Funksionalitete të avancuara → **Lëvizjet dhe gjestet**, dhe pastaj shtypni çelësin **Rrëshqit me pëllëmbë për të kapur** për ta aktivizuar.



Nuk është e mundur të bëni një foto ekrani ndërkohë që po përdorni disa aplikacione dhe veçori.

Pasi të keni bërë një foto ekrani, përdorni opsionet e mëposhtme në shiritin e veglave në fund të ekranit:

- : Fotografoni përmbajtjen aktuale dhe përmbajtjen e fshehur në një faqe të gjatë, si p.sh. një faqe interneti. Kur shtypni ikonën e fotografimit skroll () ekrani do të zbresë automatikisht poshtë dhe do të fotografohet më shumë përmbajtje.
- : Shkruani ose vizatoni mbi foton e ekranit ose prisni një pjesë nga fotoja e ekranit. Mund ta shikoni pjesën e prerë te **Galeria**.
- **#**: Shtoni etiketa në foton e ekranit. Për të kërkuar foto ekrani sipas etiketës, hapni aplikacionin **Galeria** dhe shtypni ikonën e kërkimit (). Mund të shikoni listën e etiketave dhe të kërkonte foton e ekranit që doni. Nëse lista e etiketave nuk shfaqet, shtypni ikonën e më shumë opsioneve () → **Cilësimet e kërkimit** → **Kategoritë e kërkimit** dhe shtypni çelësin **Etiketat e mia** për ta aktivizuar.

- : Ndani fotot e ekranit me të tjerë.
- : Zgjidhni një zonë dhe për të bërë veprime, si për shembull të ndani ose të ruani. Shtypni ose vizatoni një rreth anembanë materialit që doni të zgjidhni. Zgjidhni një opsion për ta përdorur me zonën e zgjedhur.



Nëse opsionet nuk janë të dukshme në ekranin e fotografuar, hapni **Cilësimet**, shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **Pamjet e çastit dhe regjistrimet e ekranit**, dhe pastaj shtypni çelësin **Shfaq sh. e veglave pas kapjes** për ta aktivizuar.

Regjistrimi i ekranit

Regjistroni ekranin ndërkohë që përdorni pajisjen.

1 Hapni panelin e cilësimeve të shpejta, shtypni ikonën e zgjerimit (—), dhe më pas shtypni **Regj. i ekranit** (.

2 Zgjidhni një konfigurim zëri dhe shtypni **Nis regjistrimin**.

Pas një numërimi mbrapsht, do të fillojë regjistrimi.

- Për të shkruar ose vizatuar mbi ekran, shtypni ikonën e vizatimit (.
- Për të shfaqur treguesin e S Pen mbi ekran, shtypni ikonën e treguesit (.
- Për të regjistruar ekranin me një mbivendosje videoje të vetes suaj, shtypni ikonën e videos selfie (.

3 Kur të keni mbaruar regjistrimin e videos, shtypni ikonën Stop (.

Mund ta shikoni videon te **Galeria**.




Për të ndryshuar cilësimet e regjistruesit të ekranit, hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **Pamjet e çastit dhe regjistrimet e ekranit**.

Formimi i tekstit

Faqosja e tastierës

Shfaqet automatikisht një tastierë kur shkruani tekst.



Formimi i tekstit nuk mbështetet në disa gjuhë. Për të futur tekstin, duhet të ndryshoni gjuhën e shkrimit në një nga gjuhët e mbështetura.

Ndryshimi i gjuhës hyrëse

Shtypni ikonën e cilësimeve (⚙️) → **Gjuhët dhe llojet** → **Menaxho gjuhët e hyrjes** dhe zgjidhni gjuhët për t'i përdorur. Kur zgjidhni dy ose më shumë gjuhë, mund të kaloni mes gjuhëve të shkrimit duke shtypur ikonën e ndryshimit të gjuhës (🔄).

Për të ndryshuar llojin e tastierës, shtypni ikonën e cilësimeve (⚙️) → **Gjuhët dhe llojet**, zgjidhni një gjuhë, dhe pastaj zgjidhni llojin e tastierës që doni.

Përdorimi i butonit të tastierës

Mund ta ndryshoni metodën e shkrimit të tekstit duke shtypur butonin e tastierës te shiriti i navigimit. Për të ndryshuar butonin e tastierës në shiritin e navigimit, prekni dhe mbani prekur butonin e tastierës dhe zgjidhni një opsion që doni.

- 🗨️ : Formoni tekst me zë.
- ⌨️ : Ndryshoni tastierën.



Nëse butoni i tastierës nuk shfaqet në shiritin e navigimit, hapni **Cilësimet**, shtypni **Menaxhimi i përgjithshëm** → **Tastierat dhe parazgjedhja**, dhe pastaj shtypni çelësin **Butoni i tastierës te shiriti i lundrimit** për ta aktivizuar.

Funksionet shtesë të tastierës

- 😊 : Vendosni avatare, ngjitëse etj. Gjithashtu mund të vendosni ngjitëset e avatarit tuaj që duken si ju. Për më shumë informacion, shikoni [Përdorimi i ngjitëseve të avatarit Galaxy](#).
- 🗨️ : Përktheni tekstin dhe vendoseni.
- 📄 : Shto një artikull nga kujtesa e fragmenteve.
- ⌨️ : Ndryshoni modalitetin e tastierës.
- ✍️ : Kaloni në metodën e shkrimit të dorës.
- ⚙️ : Ndrysho cilësimet e tastierës.

Prekni ikonën Zgjero shiritin e mjeteve (●●●) për të përdorur më shumë funksione të tastierës.

- 📄 : Dalo tekstin nga dokumentet ose imazhet dhe fute.
- + : Modifikoni listën e funksioneve të tastierës.



Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të rrjetit ose modelit.

Kopjimi dhe ngjitja

- 1 Prekni dhe mbani prekur mbi tekst.
- 2 Tërhiqni ikonën e zgjedhjes së tekstit majtas (🔵) ose ikonën e zgjedhjes së tekstit djathtas (🔵) për të zgjedhur tekstin që doni, ose shtypni **Përzgjidh të gjitha** për të zgjedhur të gjithë tekstin.
- 3 Shtypni **Kopjo** ose **Prit**.
Teksti i zgjedhur kopjohet në kujtesën e fragmenteve.
- 4 Prekni dhe mbani prekur ku doni të futet teksti dhe shtypni **Ngjit**.

Nxjerrja e tekstit

Kur përdorni disa aplikacione, si për shembull aplikacionin **Galeria**, **Kamera**, mund të nxirrni tekst nga imazhet dhe të përdorni opsionet, si për shembull ta kopjoni ose ta ndani atë. Veprimet e mëposhtme janë një shembull i nxjerrjes së tekstit nga aplikacioni **Galeria**.

- 1 Kur kontrolloni një imazh tek aplikacioni **Galeria**, shtypni ikonën e nxjerrjes së tekstit (📄).
- Ikona e nxjerrjes së tekstit (📄) shfaqet vetëm kur nuk ka tekst për të nxjerrë.
- 2 Zgjidhni një zonë për të nxjerrë tekstin.
- 3 Zgjidhni një opsion që doni.

Aplikacionet dhe veçoritë

Instalimi ose çinstalimi i aplikacioneve

Galaxy Store

Blini dhe shkarkoni aplikacione. Mund të shkarkoni aplikacione që janë të specializuara për pajisjet Samsung Galaxy.

Hapni aplikacionin **Store**. Shfletoni aplikacionet sipas kategorisë ose shtypni ikonën e kërkimit (Q) për të kërkuar me një fjalë kyçe.



- Ky aplikacion mund të mos jetë i disponueshëm në varësi të rrjetit ose modelit.
- Për të ndryshuar cilësimet e pajisjes, shtypni **Menyja** → ikonën e cilësimeve (⚙️) → **Përditëso auto app-et**, dhe më pas zgjidhni një opsion.

Dyqani i Play

Blini dhe shkarkoni aplikacione.

Hapni aplikacionin **Dyqani i Play**. Shfletoni aplikacionet sipas kategorive ose kërkoni aplikacionet me një fjalë kyçe.



- Për të ndryshuar cilësimet e përditësimit automatik, shtypni ikonën e llogarisë suaj, shtypni **Cilësimet** → **Preferencat e rrjetit** → **Përditëso automatikisht aplikacionet**, dhe më pas zgjidhni një opsion.

Menaxhimi i aplikacioneve

Çinstalimi ose çaktivizimi i aplikacioneve

Prekni dhe mbani prekur një aplikacion dhe zgjidhni një opsion.

- **Çinstalo**: Çinstaloni aplikacionet e shkarkuara.
- **Paaftëso**: Çaktivizoni aplikacionet standarde të zgjedhura që nuk mund të çinstalohen nga pajisja.



- Disa aplikacione mund të mos e mbështetin këtë veçori.

Aktivizimi i aplikacioneve

Hapni **Cilësimet**, shtypni **App-et** → ikonën e radhitjes (☰) → **Paaftësuar** → **OK**, zgjidhni një aplikacion, dhe më pas shtypni **Aftëso**.

Vendosja e lejeve të aplikacioneve

Që disa aplikacione të punojnë si duhet, mund të kenë nevojë për leje që të hapin ose përdorin informacionet në pajisjen tuaj.

Për të hapur cilësimet e lejeve të aplikacioneve, hapni **Cilësimet** dhe shtypni **App-et**. Zgjidhni një aplikacion dhe shtypni **Lejet**. Mund të shikoni listën e lejeve të aplikacioneve dhe të ndryshoni lejet e tyre.


Për të kontrolluar ose ndryshuar cilësimet e lejeve të aplikacioneve sipas kategorisë, hapni **Cilësimet** dhe shtypni **App-et** → ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Menaxheri i lejeve**. Zgjidhni një artikull dhe zgjidhni një aplikacion.



Nëse nuk i jepni leje aplikacioneve, veçoritë bazë të aplikacioneve mund të mos funksionojnë si duhet.

S Pen

Përdorimi i S Pen




- Mos e përkulni ose ushtroni presion të tepërt me S Pen kur e përdorni. S Pen mund të dëmtohet ose maja mund të deformohet.
- Mos e shtypni ekranin fort me S Pen. Maja e lapsit mund të deformohet.




- Nëse ka ndonjë magnet pranë pajisjes, disa veprime të S Pen, si për shembull shtypja e ekranit, mund të mos punojnë.
- Nëse përdorni S Pen në anët e mprehta në ekran, pajisja mund të mos e njohë veprimet e S Pen.
- Nëse S Pen nuk punon mirë, çojeni te një qendër shërbimi të Samsung ose te një qendër shërbimi të autorizuar.

Vendosja e S Pen

Kur nuk jeni duke e përdorur S Pen, ruajeni atë në mbajtësen e S Pen në pajisjen tuaj. Vendoseni S Pen duke e pozicionuar majën e S Pen në fundin e mbajtëses së S Pen siç tregohet në figurë.



Nëse e përdorni pajisjen mbi dysheme me S Pen të vendosur në mbajtësen e S Pen, kjo mund të gërvishtë S Pen. Për ta parandaluar këtë, vendoseni lapsin S sipër pajisjes.



Komandë ajrore


(Hapja direkt e veçorive dhe aplikacioneve të S Pen)

Komanda ajrore është një menu që ofron veçori të S Pen dhe akses direkt në aplikacionet e përdorura shpesh.

Mbani S Pen mbi ekran dhe shtypni ikonën e komandës ajrore (🖋️) me S Pen. Zgjidhni një funksion ose aplikacion në panelin e komandave ajrore.



Nëse ikona e komandës ajrore nuk shfaqet në ekran, hapni **Cilësimet**, shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **S Pen** → **Komandë ajrore**, dhe më pas shtypni çelësin **Trego ikonën e Komandave ajrore** për ta aktivizuar. Nëse e aktivizoni çelësin **Hap Komandën ajrore me b. S Pen**, mund ta hapni panelin e komandave në ajër duke mbajtur S Pen mbi ekran dhe duke shtypur butonin e S Pen.



- **AI select:** Përdorni S Pen për të zgjedhur një zonë dhe për të bërë veprime, si për shembull të ndani ose të ruani. Për më shumë informacion, shihni [AI select](#).
- **Krijo shënim:** Krijoni shënime në një dritare kërcyese. Mund ta hapni këtë veçori duke shtypur dy herë ekranin gjatë kohës që shtypni dhe mbani shtypur butonin S Pen. Për më shumë informacion, shihni [Samsung Notes](#).
- **Shkrimi në ekran:** Bëni foto ekrani për të shkruar ose vizatuar mbi to ose prisni një zonë nga figura e fotografuar. Gjithashtu mund të fotografoni përmbajtjen aktuale dhe përmbajtjen e fshehur në një faqe të gjatë, si për shembull në një faqe interneti. Për më shumë informacion, shihni [Shkrimi në ekran](#).
- **Shih gjithë shënimet:** Hapni të gjitha shënimet në aplikacionin **Samsung Notes**.
- **Përktheje:** Mbajeni pezull Lapsi S mbi një fjalë për ta përkthyer. Për më shumë informacion, shihni [Përktheje](#).
- **PENUP:** Postoni punimet tuaja artistike, shikoni punët artistike të të tjerëve dhe merrni këshilla të dobishme vizatimi.
- **Shkruaj në kalendar:** Hapni aplikacionin **Kalendari** dhe shkruani ose vizatoni në ekran. Për më shumë informacion, shihni [Shkruaj në kalendar](#).
- **Shto:** Shtoni shkurtore për aplikacionet e përdorura shpesh në panelin e komandave në ajër.

AI select

Përdorni S Pen për të zgjedhur një zonë dhe për të bërë veprime, si për shembull të ndani ose të ruani. Gjithashtu mund të zgjidhni një zonë nga një video dhe ta fotografoni si GIF.

- 1 Aty ku ka material që doni të kapni, si për shembull një pjesë të një imazhi, hapni panelin e komandave në ajër dhe shtypni **AI select**.
- 2 Shtypni ose vizatoni një rreth anëmbanë materialit që doni të zgjidhni.
- 3 Zgjidhni një opsion për ta përdorur me zonën e zgjedhur.

Shkrimi në ekran

Bëni foto ekrani për të shkruar ose vizatuar mbi to ose prisni një zonë nga figura e fotografuar.

- 1 Aty ku ka materiale që doni të kapni, hapni panelin e komandave në ajër dhe shtypni **Shkrimi në ekran**.
Ekran aktual kapet automatikisht dhe shfaqet shiriti i mjeteve të modifikimit.
- 2 Shkruani një memo në foton e ekranit.
- 3 Ndajeni ose ruajeni foton e ekranit.
Mund të shikoni fotot e bëra të ekranit te **Galeria**.




Nuk është e mundur të bëni një foto ekrani ndërkohë që po përdorni disa aplikacione.

Përktheje

Mbani sipër S Pen mbi tekstin që doni të përktheni. Do të konvertohen gjithashtu edhe njësitë e përfshira në tekst.

- 1 Aty ku ka tekst që doni të përktheni, hapni panelin e Komandave në ajër dhe shtypni **Përktheje**.
- 2 Zgjidhi gjuhët te paneli i përkthyesit në krye të ekranit.
Mund të ndryshoni tekstin midis fjalëve dhe fjalive duke prekur ikonën “Fjali” (📖) ose ikonën “Fjalë” (📚).

- 3 Mbani sipër S Pen mbi tekstin që doni të përktheni ose njësinë që doni të konvertoni. Do të shfaqet teksti i përkthyer. Për të dëgjuar shqiptimin e tekstit origjinal, prekni ikonën “Luaj” (▶). Ikona “Luaj” (▶) mund të mos shfaqet në varësi të gjuhës që zgjidhni.



- Kjo veçori nuk mbështetet disa gjuhë.
- Kjo veçori është e disponueshme vetëm kur teksti i lexueshëm është në ekran.

Shkruaj në kalendar

Shkruajini planet tuaja duke shkruar ose duke vizatuar mbi ekranin e kalendarit.

Hapni panelin e komandave në ajër, shtypni **Shkruaj në kalendar**, dhe pastaj shkruani planet tuaja mbi kalendar. Kur të keni mbaruar, shtypni **Ruaj**. Për ta modifikuar atë, prekni ikonën “Shkruaj” (✎).

Nga S Pen në tekst

Mund ta vendosni pajisjen që të konvertojë në tekst çdo gjë që shkruani me S Pen.

- 1 Hapni **Cilësimet**, shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **S Pen** → **Nga S Pen në tekst**, dhe më pas shtypni çelësin për ta aktivizua.




Për të mësuar se si të modifikoni tekst me S Pen, shtypni **Si të editosh**.

- 2 Shkruani në një fushë shkrimi, si për shembull në një fushë kërkimi ose shirit adrese, duke përdorur S Pen. Shkrimi i dorës do të konvertohet në tekst.

Pamja ajrore

Mbani sipër S Pen mbi një artikull në ekran për të parë përmbajtje ose për të hapur informacionin në një dritare kërcyese.

Në disa aplikacione, butonat Veprim do të shfaqen në dritaren e shikimit.




Nëse kjo veçori nuk është e aktivizuar, hapni **Cilësimet**, shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **S Pen**, dhe më pas shtypni çelësin **Pamja ajrore** për ta aktivizuar.

Përzgjedhje me stilolaps

(Përzgjedhja shpejt e gjërave me S Pen)

Ndërsa shtypni dhe mbani shtypur butonin e S Pen, tërhiqeni S Pen mbi tekst ose lista artikujsh për të zgjedhur shumë artikuj ose tekst. Gjithashtu mund të kopjoni dhe ngjitni artikujt ose tekstin e zgjedhur në një aplikacion tjetër ose ta ndani me të tjerë.




Memo me ekran të fikur

Mund të krijoni përkujtues duke shkruar në ekran pa e ndezur.

Kur ekrani është i fikur, shtypni dy herë ekranin ndërsa shtypni dhe mbani shtypur butonin e S Pen.

Kur shtypni **Ruaj** pasi keni shkruar një shënim, shënimi do të ruhet në **Samsung Notes**.



Nëse kjo veçori nuk është e aktivizuar, hapni **Cilësimet**, shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **S Pen**, dhe më pas shtypni çelësin **Memo me ekran të fikur** për ta aktivizuar.

Telefon

Hyrje

Bëni ose përgjigjuni telefonatave me zë dhe me video.



Mund të përdorni veçoritë e telefonatës dhe të mesazheve në tabletë me numrin tuaj të telefonit duke përdorur veçorinë **Thirrje & tekst në pajisje të tjera**. Në tabletën dhe telefonin tuaj, hapni **Cilësimet**, shtypni **Pajisjet e lidhura** → **Thirrje & tekst në pajisje të tjera** dhe më pas shtypni çelësin për ta aktivizuar. Duhet të regjistroheni dhe të hyni në të njëjtën llogari Samsung në tabletë dhe në telefon. Disa veçori telefonimi dhe mesazhesh mund të mos jenë të disponueshme.

Bërja e telefonatave

- 1 Hapni aplikacionin **Telefon** dhe shtypni **Tastiera**.
- 2 Formoni një numër telefoni.
- 3 Shtypni ikonën e telefonatës zanore () për të bërë një telefonatë zanore, ose shtypni ikonën e videotelefonatës () ose ikonën e videotelefonatës në Meet () për të bërë një videotelefonatë.

Bërja e telefonatave nga regjistrat e thirrjeve ose lista e kontakteve

Hapni aplikacionin **Telefon**, shtypni **Së fundi** ose **Kontaktet**, dhe pastaj rrëshqitni në të djathtë mbi një kontakt ose numër telefoni për të bërë një telefonatë.

Nëse kjo veçori është e çaktivizuar, shtypni ikonën e më shumë opsioneve () → **Cilësimet** → **Cilësime të tjera të thirrjes**, dhe pastaj shtypni çelësin **Rrëshqit për thirrje ose tekst** për ta aktivizuar.

Përdorimi i telefonimit të shpejtë

Për ta vendosur një numër të telefonimi të shpejtë, hapni aplikacionin **Telefon**, shtypni **Tastiera** → ikonën e më shumë opsioneve () → **Numrat e thirrjes shpejtë**, zgjidhni një numër telefonimi të shpejtë dhe pastaj shtoni një numër telefoni.

Për të bërë një telefonatë, prekni dhe mbani prekur një numër telefonimi të shpejtë në tastierë. Për numrat e telefonimit të shpejtë nga 10 e sipër, shtypni shifrën(at) e parë të numrit, dhe pastaj prekni dhe mbani prekur shifrën e fundit.

Për shembull, nëse keni vendosur numrin **123** si numër telefonimi të shpejtë, shtypni **1**, shtypni **2**, dhe pastaj prekni e mbani prekur **3**.

Bërja e një telefonate ndërkombëtare

- 1 Hapni aplikacionin **Telefon** dhe shtypni **Tastiera**.
- 2 Prekni dhe mbani prekur **0** derisa të shfaqet shenja **+**.
- 3 Formoni kodin e shtetit, kodin e zonës, dhe numrin e telefonit dhe pastaj shtypni ikonën e telefonimit ()

Marrja e telefonatave

Përgjigja e një telefonate

Kur vjen një thirrje, tërhiqeni ikonën e përgjigjes () jashtë rethit të madh.

Refuzimi i një telefonate

Kur vjen një thirrje, tërhiqeni ikonën e refuzimit () jashtë rrethit të madh.

Për të dërguar një mesazh kur refuzoni një telefonatë hyrëse, tërhiqeni shiritin **Dërgo mesazh** për lart dhe zgjidhni një mesazh për ta dërguar.

Për të krijuar mesazhe të ndryshme refuzimi, hapni aplikacionin **Telefon**, shtypni ikonën e më shumë opsioneve () → **Cilësimet** → **Refuzo shpejt mesazhet**, formoni një mesazh, dhe më pas shtypni ikonën e shtimit ()

Bllokimi i numrave të telefonit

Bllokoni telefonatat nga numra të caktuar që janë shtuar në listën e bllokimeve.

Hapni aplikacionin **Telefon**, shtypni ikonën e më shumë opsioneve () → **Cilësimet** → **Blloko numrat**, dhe më pas zgjidhni kontaktet ose numrat e telefonit për t'i ruajtur te lista e numrave të bllokuar.

Kur numrat e bllokuar përpiqen t'ju kontaktojnë, nuk do të merrni njoftime. Telefonatat do të regjistrohen në regjistrin e telefonatave.



Gjithashtu mund të bllokoni telefonatat hyrëse nga njerëzit të cilëve nuk u shfaqet identifikimi i numrit. Shtypni çelësin **Blloko thirrje nga numra të panjohur** për ta aktivizuar veçorinë.

Opsionet gjatë telefonatave

-  : Regjistroni një videotelefonatë. Kur regjistroni një bisedë telefonike, skedari do të ruhet te **Skedarët e Mi** → **Magazina e brendshme** → **Recordings** → **Call**.
- **Thirrje tekst**: Komunikoni me palën tjetër duke shkruar tekst. Për ta përdorur këtë veçori, hapni aplikacionin **Telefon**, shtypni ikonën e më shumë opsioneve () → **Cilësimet** → **Thirrje tekst**, dhe më pas shtypni çelësin për ta aktivizuar.
- **Shto thirrje**: Bëni një thirrje të dytë. Telefonata e parë do të vihet në pritje. Kur të mbyllni telefonatën e dytë, do të vazhdohet telefonata e parë.
- **Thirrje video**: Kaloni në një telefonatë me video.
- **Bluetooth**: Kaloni në një kufje Bluetooth nëse është e lidhur me pajisjen.
- **Vëre në pritje**: Vendosni në pritje një telefonatë.
- **Heshto**: Fikni mikrofoni në mënyrë që pala tjetër të mos ju dëgjojë dot.
- **Tastiera / Fshih**: Hapni ose mbyllni tastierën.
-  : Mbyllni telefonatën aktuale.
-  : Gjatë një telefonate me video, kaloni në një telefonatë me zë.
-  : Gjatë një telefonate me video, kyçni ekranin.
- **Efektet**: Gjatë një telefonate me video, aplikoni efekte të ndryshme.
-  : Gjatë një telefonate me video, ndryshoni raportin e ekranit.
- **Kamera**: Gjatë një telefonate me video, fiken kamerën në mënyrë që pala tjetër të mos ju shikojë dot.
- **Këmbej**: Gjatë një telefonate me video, kaloni mes kamerës përpara dhe asaj mbrapa.



Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të rrjetit ose modelit.

Kontaktet

Hyrje

Krijoni kontakte të reja ose menaxhoni kontaktet në pajisje.

Shtimi i kontakteve

Krijimi i një kontakti të ri

- 1 Hapni aplikacionin **Kontaktet** dhe më pa shtypni ikonën e krijimit (+).
- 2 Zgjidhni një vend magazinimi.
- 3 Vendosni informacionet e kontaktit dhe shtypni **Ruaj**.

Importimi i kontakteve

Shtoni kontakte duke i importuar nga magazina të tjera në pajisjen tuaj.

- 1 Hapni aplikacionin **Kontaktet**, prekni ikonën “Më shumë opsione” (⋮) në krye të listës së kontakteve dhe më pas prekni **Cilësimet** → **Importo kontaktet**.
- 2 Ndiqni udhëzimet në ekran për t'i importuar kontaktet.

Sinkronizimi i kontakteve me llogaritë në internet

Sinkronizoni kontaktet e pajisjes suaj me kontaktet online të ruajtura në llogaritë tuaja në internet, si për shembull llogaria Samsung.

- 1 Hapni **Cilësimet**, shtypni **Llogaritë dhe rezervimi** → **Menaxho llogaritë** dhe zgjidhni një llogari me të cilën të sinkronizoheni.
- 2 Shtypni **Sinkronizo llogarinë** dhe shtypni çelësin **Kontaktet** për ta aktivizuar.

Kërkimi për kontakte

Hapni aplikacionin **Kontaktet**. Shtypni ikonën e kërkimit (Q) në krye të listës së kontakteve dhe formoni kriterin e kërkimit.

Shtypni kontaktin. Pastaj bëni një nga veprimet e mëposhtme:

-  : Bëni një telefonatë me zë.
-  : Kompozoni një mesazh.
-  /  : Bëni një telefonatë video.
-  : Kompozoni një email.

Fshirja e kontakteve

- 1 Hapni aplikacionin **Kontaktet**, prekni ikonën “Më shumë opsione” (⋮) në krye të listës së kontakteve dhe pastaj prekni **Përzgjidh**.
- 2 Zgjidhni kontaktet dhe shtypni **Hiq**.

Për t’i fshirë kontaktet një nga një, shtypni një kontakt e kontakteve dhe shtypni **Më tej** → **Hiq**.

Ndarja e kontakteve

Mund t’i ndani kontaktet me të tjerë duke përdorur opsione të ndryshme ndarjeje.

- 1 Hapni aplikacionin **Kontaktet**, prekni ikonën “Më shumë opsione” (⋮) në krye të listës së kontakteve dhe pastaj prekni **Përzgjidh**.
- 2 Zgjidhni kontaktet dhe shtypni **Ndaj**.
- 3 Zgjidhni informacionin e kontaktit për ta ndarë dhe shtypni **U krye**.
- 4 Zgjidhni një mënyrë ndarjeje.

Krijimi i grupeve

Mund të shtoni grupe, si familje ose miq, dhe të menaxhoni kontaktet sipas grupeve.

- 1 Hapni aplikacionin **Kontaktet** dhe shtypni **Grupet** → ikonën e krijimit (+).
- 2 Ndiqni udhëzimet në ekran për të krijuar një grup.

Bashkimi i kontakteve të dyfishta

Nëse lista e kontakteve përmban kontakte të dyfishta, bashkojini në një për ta sistemuar listën e kontakteve.

- 1 Hapni aplikacionin **Kontaktet**, prekni ikonën “Më shumë opsione” (⋮) në krye të listës së kontakteve dhe më pas prekni **Cilësimet** → **Shkri kontaktet e dyzuara**.
- 2 Shënoni kontaktet dhe shtypni **Shkri**.

Konfigurimi i profilit tuaj

Mund të konfiguroni figurën e profilit dhe kartën e profilit tuaj.

- 1 Hapni aplikacionin **Kontaktet** dhe shtypni profilin tuaj.
- 2 Shtypni **Krijo kartë profili**.
- 3 Ndiqni udhëzimet në ekran për të konfiguruar kartën e profilit tuaj. Imazhi që zgjidhni për kartën e profilit do të aplikohet gjithashtu si figura e profilit tuaj.
- 4 Për ta ndryshuar figurën e profilit, shtypni figurën ose kartën e profilit dhe shtypni ikonën e figurës së profilit (🖋️).
- 5 Ndiqni udhëzimet në ekran për të vendosur figurën e profilit tuaj.

Ndarja e profilit tuaj

Njerëzit mund ta shohin profilin tuaj kur i telefononi ose kur ata kontrollojnë informacionet tuaja të kontaktit.

- 1 Hapni aplikacionin **Kontaktet** dhe shtypni profilin tuaj.
- 2 Shtypni **Karta dhe fotoja e profilit** dhe shtypni çelësin **Ndaj kartën dhe foton e profilit** për ta aktivizuar.

Kamera

Hyrje

Bëni foto dhe regjistroni video duke përdorur metodat dhe cilësimet e ndryshme.

Etika e kamerës

- Mos bëni foto ose regjistroni video të njerëzve të tjerë pa lejen e tyre.
- Mos bëni foto ose regjistroni video aty ku është e ndaluar me ligj.
- Mos bëni foto ose regjistroni video në vende ku mund të shkelet privatësia e njerëzve të tjerë.

Bërja e fotove

1 Hapni aplikacionin **Kamera**.

Gjithashtu mund ta hapni aplikacionin duke shtypur dy herë butonin anësor ose duke e tërhequr ikonën e kamerës () në të majtë të ekranit të kyçur.




- Disa veçori të kamerës nuk janë të disponueshme kur hapni aplikacionin **Kamera** nga ekrani i kyçur ose kur ekrani është i fikur ndërkohë që është vendosur metoda e kyçjes së ekranit.
- Kamera mbyllet automatikisht kur nuk përdoret.
- Disa metoda mund të mos jenë të disponueshme në varësi të rrjetit ose modelit.

2 Shtypni në figurën në ekranin e pamjes ku duhet të fokusohet kamera.

Për të rregulluar ndriçimin e figurave, tërhiqeni shiritin e rregullimit që shfaqet sipër ose poshtë kuadros rrethore.

- 3 Shtypni ikonën e bërjes së fotografisë (○) për të bërë një fotografi. Për të ndryshuar metodën e shkrepjes, tërhiqni listën e metodave të shkrepjes majtas ose djathtas, ose lëvizni majtas ose djathtas në ekranin e shikimit.



- Ekrani i shikimit mund të ndryshojë në varësi të metodës së shkrepjes dhe se cila kamerë po përdoret.
- Fokusi mund të mos jetë i qartë nëse subjekti është afër. Bëni foto ose video nga një distancë e mirë.
- Nëse fotot duken të turbullta, pastrojeni lentin e kamerës dhe provoni përsëri.
- Sigurohuni që lentja të mos dëmtohet ose ndotet. Përndryshe, pajisja mund të mos funksionojë mirë në disa regjime që kërkojnë rezolucione të larta.
- Kamera e pajisjes suaj është e pajisur me një lente këndi të gjerë. Mund të ndodhë një turbullim i vogël në fotot ose videot me kënd të gjerë dhe kjo nuk tregon probleme me performancën e pajisjes.
- Kamera mund të vishet me avull ose mund të formojë kondensim nëse pajisja ekspozohet ndaj ndryshimeve të papritura të temperaturës, për shkak të ndryshimit të temperaturës jashtë dhe brenda kapakut të kamerës. Përpikuni të shmangni këto kushte kur planifikoni ta përdorni kamerën. Nëse ndodh veshja me avull, lëreni kamerën të thahet vetë në temperaturë ambiente para se të bëni foto ose të regjistroni video, përndryshe rezultatet mund të dalin të turbullta.

Përdorimi i butonit të kamerës

- Prekni dhe mbani prekur butonin e kamerës për të regjistruar një video.
- Nëse e tërhiqni butonin e kamerës tek ikona e kyçjes (🔒), mund të regjistroni një video pa e mbajtur shtypur butonin.
- Për të bërë foto ekranin, lëvizni butonin e kamerës në anë të ekranit dhe mbajeni aty. Nëse shtypni ikonën e kontrolleve të shpejta (⏏) → ikonën e cilësimeve (⚙️) në ekranin e shikimit paraprak dhe shtypni **Rrëshqit butonin Shkrepës që → Krijo GIF**, mund të krijoni GIF-e.
- Nëse shtoni një buton tjetër kamere, mund ta lëvizni kudo në ekran dhe të bëni foto në mënyrë më praktike. Në ekranin e shikimit paraprak, shtypni ikonën e kontrolleve të shpejta (⏏) → ikonën e cilësimeve (⚙️) → **Mënyrat e shkrepjes** dhe shtypni çelësin **Butoni Shkrepës i pezullt** për ta aktivizuar.

Modifikimi i listës së modaliteteve të shkrepjes


Për të modifikuar listën e modaliteteve të shkrepjes, shtypni **MË TEJ** në listë, shtypni **Edito**, dhe më pas tërhiqni modalitetet te vendi që doni.

Përdorimi i veçorive të zmadhimit

Për të zmadhuar ose zvogëluar ndërsa përdorni kamerën e pasme, zgjidhni ikonën e zmadhimit te ekranin e shikimit.

Gjithashtu mund të zgjidhni nivelin e dëshiruar të zmadhimit nga lista e niveleve të zmadhimit që shfaqet kur shtypni ikonën e zmadhimit.

Për rregulluar zmadhimin më me imtësi, tërhiqni ikonën e zmadhimit, mbyllni gishtat ose hapni dy gishta te ekranin e shikimit.



Kyçja e fokusit (AF) dhe ekspozimit (AE)

Mund ta kyçni fokusin ose ekspozimin në një zonë të zgjedhur për të mos lejuar që kamera të rregullohet automatikisht sipas ndryshimeve në subjektet ose burimet e dritës.

Prekni dhe mbani prekur zonën për ta fokusuar, kuadroja AF/AE do të shfaqet në zonë dhe konfigurimet e fokusit dhe ekspozimit do të kyçen. Ky konfigurim qëndron i kyçur edhe pasi ta keni bërë foton.



Kjo veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të modalitetit të shkrepjes.

Opsionet për metodën aktuale të shkrepjes

Në ekranin e shikimit, përdorni opsionet e mëposhtme. Për të përdorur më shumë opsione, shtypni ikonën e kontrolleve të shpejta (⋮).

- ✂ : Ndizni ose fikni blicin.
- 📷 : Aktivizoni ose çaktivizoni veçorinë e fotografive me lëvizje. Nëse e aktivizoni, do të bëhet gjithashtu një klip videoje nga pak sekonda para, ose si para edhe pas shtypjes së butonit të kamerës.
- 🌫 : Aplikoni një efekt filtri.
- AUTO : Zgjidhni një frame-rate për videot hiperlaps.
- FHD 30 : Zgjidhni një rezolucion për videot.
- 😊 : Aplikoni i efekteve të bukurisë.
- 📍 : Zgjidhni një metodë matjeje. Kjo përcakton mënyrën si llogariten vlerat e dritës. **Metërzim i qendërzuar** (📍) përdor dritën në pjesën e mesit të pozës për të llogaritur ekspozimin e pozës. **Metërzim matricë** (📍) llogarit mesatarisht të gjithë skenën. **Metërzim me fokusim** (📍) përdor dritën në një pjesë qendrore të përqendruar të pozës për të llogaritur ekspozimin e pozës.
- 👉 : Në metodën **USHQIM**, fokusohuni në një subjekt brenda kuadros dhe turbulloni figurën jashtë kuadros.



Opsionet e disponueshme mund të ndryshojnë në varësi të modelit ose metodës së shkrepjes.

Modaliteti Foto

Kamera rregullon automatikisht opsionet e shkrepjes në varësi të ambientit përreth.


Në listën e metodave të shkrepjes, shtypni **FOTO** dhe shtypni ikonën e bërjes së fotografisë (○) për të bërë një foto.

Sugjerimet për foto

Kamera rregullon kompozicionin ideal për foton duke njohur pozicionin dhe këndin e subjektit tuaj.

Në ekranin e shikimit, shtypni ikonën e kontrolleve të shpejta (⋮) → ikonën e cilësimeve (⚙️) dhe shtypni çelësin **Sugjerimet për foto** për ta aktivizuar.

- 1 Në listën e metodave të shkrepjes, shtypni **FOTO**.
Do të shfaqet një udhëzues në ekranin e shikimit.
- 2 Drejtojeni orientuesin te subjekti.
Kamera njeh kompozimin, dhe kompozimi i rekomanduar shfaqet në ekranin e shikimit.
- 3 Lëvizeni pajisjen në mënyrë që udhëzuesi të përputhet me kompozimin e rekomanduar.
Kur arrihet kompozicioni ideal, udhëzuesi do të bëhet i verdhë.
- 4 Shtypni ikonën e bërjes së fotografisë (○) për të bërë një fotografi.



Bërja e fotove selfie

Mund të bëni portrete të vetes me kamerën përpara.

- 1 Në ekranin e shikimit, rrëshqitni lart ose poshtë, ose shtypni çelësin e kalimit te kamera përpara () për të kaluar në kamerën përpara për portrete të vetes.
- 2 Drejtoni lentin e kamerës përpara.
Për të bërë portrete të vetes me pozë këndi të gjerë të peizazhit ose të njerëzve, shtypni ikonën e kalimit në kënd të gjerë ()
- 3 Shtypni ikonën e bërjes së fotografisë () për të bërë një fotografi.

Skanimi i dokumenteve ose i tekstit

Mund të skanoni dokumente ose tekst.

- 1 Në listën e metodave të shkrepjes, shtypni **FOTO**.
- 2 Drejtojeni kamerën tek objekti dhe shtypni ikonën e skanimit të dokumenteve dhe të tekstit ()
Ikona e skanimit të dokumenteve dhe të tekstit () do të shfaqet vetëm kur dallohet një dokument ose tekst.
- 3 Shtypni **Skano**, zgjidhni zonën që doni, dhe më pas shtypni **Ruaj**.

Modaliteti Video

Kamera rregullon automatikisht opsionet e shkrepjes në varësi të ambientit përreth.

- 1 Në listën e metodave të shkrepjes, shtypni **VIDEO** dhe shtypni e fillimit të regjistrimit () për të regjistruar një video.
 - Për të kaluar mes kamerës përpara dhe asaj mbrapa ndërsa regjistroni, lëvizni lart ose poshtë në ekranin e shikimit ose shtypni ikonën e kalimit te kamera përpara ()
 - Për të kapur një figurë nga videoja kur regjistroni, shtypni ikonën e fotografimit ()
- 2 Shtypni ikonën e ndalimit të regjistrimit () për ta ndaluar regjistrimin e videos.

Modaliteti “Shkrepje teke”

Bëni foto dhe video të ndryshme me një shkrepje.

Pajisja zgjedh automatikisht shkrepjen më të mirë dhe krijon foto me filtra ose video me pjesë të caktuara të përsëritura.

- 1 Në listën e modaliteteve të shkrepjes, shtypni **MË TEJ → NJË MARRJE**.
- 2 Shtypni ikonën e fillimit të regjistrimit (○) për të fotografuar skenën që doni.
- 3 Shtypni figurën e shikimit paraprak në ekranin e shikimit paraprak ose hapni aplikacionin **Galeria** dhe zgjidhni skedarin.
Për të kontrolluar rezultatet e tjera, shtypni ikonën e shkrepjes teke (↖). Për t'i ruajtur rezultatet individualisht, prekni dhe mbani prekur një artikull, shënoni artikujt që doni, dhe më pas shtypni ikonën e ruajtjes (↓).

Modaliteti Portret

Bëni foto që fokusojnë fytyrën tuaj duke turbulluar sfondin.

- 1 Në listën e metodave të shkrepjes, shtypni **PORTRET**.
 - 2 Prekni ikonën “Portret” (●) dhe tërhiqeni shiritin e rregullimit të turbullimit të sfondit për të rregulluar nivelin e turbullimit.
 - 3 Kur në ekranin e pamjes paraprake shfaqet mesazhi **Gati**, prekni ikonën “Bëj fotografi” (○) për të bërë një fotografi.
-  • Përdoreni këtë veçori në një vend që ka dritë të mjaftueshme.
- Turbullimi i sfondit mund të mos aplikohet mirë në kushtet e mëposhtme:
- Pajisja ose subjekti lëviz.
 - Subjekti ka ngjyrë të ngjashme me sfondin.

Modaliteti Pro/Modaliteti i videove Pro

Bëni fotografi ose video ndërsa rregulloni manualisht opsionet e ndryshme të shkrepjes, si për shembull vlerën e ekspozimit ose vlerën ISO.

Në listën e metodave të shkrepjes, shtypni **MË TEJ** → **PRO** ose **VIDEO PRO**. Zgjidhni opsionet dhe personalizoni konfigurimet, dhe pastaj shtypni ikonën e bërjes së fotografisë (○) për të bërë një foto ose shtypni ikonën e fillimit të regjistrimit (●) për të regjistruar një video.

Opsionet e disponueshme

Kur shtypni një opsion, shfaqet lista e opsioneve. Në listë, zgjidhni opsionet dhe personalizoni cilësimet.

- **WB:** Zgjidhni një balancim të përshtatshëm bardhësie në mënyrë që figurat të kenë një gamë ngjyrash të jetës reale. Mund të vendosni temperaturën e ngjyrave.
- **EV:** Ndryshoni vlerën e ekspozimit. Kjo përcakton sa dritë merr sensori i dritës i kamerës. Për situatat me ndriçim të ulët, përdorni një ekspozim më të lartë.
- **ISO:** Zgjidhni një vlerë ISO. Kjo kontrollon ndjeshmërinë e kamerës ndaj dritës. Vlerat e ulëta janë për objektet e palëvizshme ose të ndriçuara fort. Vlerat më të larta janë për objektet që lëvizin shpejt ose të ndriçuara dobët. Megjithatë, cilësimet më të larta të ISO mund të shkaktojnë zhurmë te fotot ose videot.
-  : Rivendosni cilësimet.

Ndarja e zonës së fokusit dhe zonës së ekspozimit

Mund të ndani zonën e fokusit dhe zonën e ekspozimit.

Prekni dhe mbani prekur ekranin e shikimit. Kuadroja AF/AE do të shfaqet në ekran. Tërhiqeni kuadron në zonën ku doni të ndani zonën e fokusit dhe zonën e ekspozimit.

Modaliteti i natës

Bëni një foto në kushte ndriçimi të dobët, pa përdorur blicin. Kur përdorni një tripod, mund të merrni rezultate me më shumë dritë dhe më të qëndrueshme.

- 1 Në listën e metodave të shkrepjes, shtypni **MË TEJ** → **NATËN**.
- 2 Shtypni ikonën e bërjes së fotografisë (○) dhe mbajeni pajisjen pa lëvizur derisa të ketë mbaruar shkrepja.

Metoda e ushqimit

Bëni foto të ushqimeve me ngjyra më të gjalla.

- 1 Në listën e metodave të shkrepjes, shtypni **MË TEJ → USHQIM**.
Në ekran do të shfaqet një kuadro dhe zona jashtë kuadros do të jetë e turbullt.
- 2 Për të ndryshuar përmasat e kuadros, tërhiqni një cep të kuadros.
Shtypni zonën që doni ose tërhiqeni kuadron për ta lëvizur.
- 3 Shtypni ikonën e kontrolleve të shpejta (⋮) → ikonën e temperaturës së ngjyrave (🌡️) dhe tërhiqeni shiritin e rregullimit për të rregulluar temperaturën e ngjyrave.
- 4 Shtypni ikonën e bërjes së fotografisë (📷) për të bërë një fotografi.

Metoda e panoramës

Duke përdorur metodën e panoramës, bëni një seri fotosh dhe pastaj qepini së bashku për të krijuar një skenë të gjerë.

- 1 Në listën e metodave të shkrepjes, shtypni **MË TEJ → PANORAMË**.
- 2 Shtypni ikonën e bërjes së fotografisë (📷) dhe lëvizeni pajisjen me ngadalë në një drejtim.
Mbajeni imazhin brenda kuadros në shikuesin e pamjes të kamerës. Nëse imazhi i shikimit është jashtë kuadros ose ju nuk e lëvizni pajisjen, pajisja do të ndalojë automatikisht bërjen e fotove.
- 3 Shtypni ikonën e përfundimit (■) për të ndaluar bërjen e fotografive.



Mos bëni fotografi të sfondeve të largëta, si për shembull qielli bosh ose muri bosh.

Metoda e hiperlapsit

Regjistroni skena, të tilla si njerëz ose makina që kalojnë, dhe shikojini si video me lëvizje të shpejta.

- 1 Në listën e metodave të shkrepjes, shtypni **MË TEJ** → **HYPERLAPSE**.
- 2 Shtypni ikonën e shpejtësisë () dhe zgjidhni një opsion shpejtësisë kuadrosh. Nëse e vendosni frame-rate në **AUTO**, pajisja do të rregullojë automatikisht frame-rate sipas shpejtësisë së ndryshimit të skenave.
- 3 Shtypni ikonën e fillimit të regjistrimit () për të filluar regjistrimin.
- 4 Shtypni ikonën e ndalimit të regjistrimit () për të përfunduar regjistrimin.



Mund të përdorni veçorinë e hiperlapsit natën duke shtypur ikonën e shpejtësisë () → ikonën e natës pesëmbëdhjetë herë më shpejt () ose ikonën e natës dyzet e pesë herë më shpejt () tek opsionet e shkrepjes. Kjo veçori është e mirë për të bërë gjëra të tilla si, fotografimi i makinave në lëvizje, duke e bërë edhe dritën të duket sikur lëviz.

Personalizimi i cilësimeve të kamerës.

Në ekranin e shikimit paraprak, shtypni ikonën e kontrolleve të shpejta () → ikonën e cilësimeve (). Disa opsione mund të mos jenë të disponueshme në varësi të metodës së shkrepjes.

Funksionalitete inteligjente

- **Optimizuesi i skenës:** Vendoseni pajisjen që të rregullojë cilësimet e ngjyrave dhe të aplikojë automatikisht efektin e optimizuar në varësi të subjektit ose skenës.
- **Skano dokumente dhe tekste:** Kur kamera e pasme dallon një dokument ose tekst, do të shfaqet ikona e skanimit të dokumenteve dhe ikona e tekstit ()
- **Skano kodet QR:** Vendoseni pajisjen që të skanojë kodet QR nga ekranin e shikimit.
- **Sugjerimet për foto:** Caktojeni pajisjen të sugjerojë kompozimin ideal për foton duke dalluar pozicionin dhe këndin e subjektit tuaj.
- **Filtrat e personalizuar:** Krijoni filtrin tuaj duke përdorur një imazh me një tonalitet ngjyrash që ju pëlqen nga **Galeria**.

Fotot

- **Rrëshqit butonin Shkrepës që:** Zgjidhni një veprim që doni të kryhet kur e lëvizni butonin e shkrehjes së kamerës në anën e ekranit dhe e mbani aty.
- **Shenja ujore:** Shtoni një shënim në sfond kur bëni fotografi.
- **Foto me eficiencë të lartë:** Shkrepni foto në format “High Efficiency Image Format (HEIF)”.

Selfie-t

- **Ruaj selfiet siç para-afishohen:** Caktojeni pajisjen t'i ruajë fotot ose videot siç duken në ekranin e shqyrtimit kur shkrepën me kamerën e përparme, pa i shfletuar.
- **Rrëshq. lart/poshtë për kamerat:** Aktivizoni këtë veçori për të ndryshuar kamerën duke rrëshqitur lart ose poshtë në ekranin e pamjes paraprake.

Videot

- **Stabilizimi i videos:** Aktivizoni anti-dridhjet për të reduktuar ose eliminuar imazhin e turbullt që vjen nga dridhjet e kamerës ndërsa regjistroni një video.
 - **Opsione të avancuara për videot**
 - **Video me eficiencë të lartë:** Mund të regjistroni video në formatin High Efficiency Video Codec (HEVC). Videot tuaja HEVC do të ruhen si skedarë të kompresuar për të kursyer magazinën e pajisjes.
 - **Regjistrimi audio 360:** Mund të regjistroni video me tingull më magjepsës 3D duke përdorur kufje me Bluetooth që mbështetin veçorinë e regjistrimit 360 të audios.
 - **Rileximi audio:** Mund të luani media pa e ndaluar ndërsa regjistroni video. Media do të ndalojë kur veçoria e regjistrimit të audios 360 aktivizohet.
-  • Mund të mos jeni në gjendje të luani video HEVC në pajisje të tjera ose t'i ndani ato online.
- Nuk mund të regjistroni video në formatin HEVC në disa modalitete regjistrimi.

Të përgjithshme

- **Auto HDR:** Bëni fotografi me ngjyra të pasura dhe riprodhoni detajet edhe në vende të ndriçuara dhe të errëta.
 - **Udhëzuesi i kompozimit:** Trego vijat drejtuese të shikuesit të pamjes për të ndihmuar kompozicionin kur zgjidhni subjektet.
 - **Etiketat e vendndodhjes:** Ngjitni një etiketë vendndodhjeje GPS në foto.
-  • Fuqia e sinjalit GPS mund të bjerë në vende ku ka pengesa të sinjalit si për shembull midis ndërtesave ose në zona të nëndheshme ose në kushte të këqija të motit.
- Vendndodhja juaj mund të shfaqet në fotot tuaja kur i ngarkoni ato në Internet. Për të shmangur këtë, çaktivizoni cilësimin e etiketës të vendndodhjes.

- **Mënyrat e shkrepjes**

- **Shtyp Butonat e Volumit që:** Bëni fotografi ose video, zmadhoni ose zvogëloni, ose kontrolloni volumin duke përdorur butonin e volumit.
- **Butoni Shkrepës i pezullt:** Shtoni një buton tjetër të lëvizshëm kudo në ekran për të bërë fotografi.
- **Trego pëllëmbën:** Tregoni pëllëmbën te kamera përpara për të bërë selfie ose për të filluar të regjistroni video.
- **Cilësimet për t'u mbajtur:** Ruajini cilësimet që keni përdorur për herë të fundit, si për shembull modaliteti i shkrepjes, kur hapni kamerën.
- **Vendi i magazinës:** Zgjidhni një vend magazinimi. Kjo veçori do të shfaqet kur futni një kartë SD.

Privatësia

- **Lejet:** Shikoni lejet që duhen për të përdorur aplikacionin Kamera.
- **Ricilëso cilësimet:** Rivendosni cilësimet e kamerës.
- **Rreth Kamerës:** Shikoni versionin dhe informacione ligjore të aplikacionit Kamera.
- **Na kontakto:** Bëni pyetje ose shikoni pyetjet e bëra shpesh.



Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të modelit.


Galeria

Hyrje

Shikoni imazhet dhe videot e ruajtura në pajisjen tuaj. Gjithashtu mund të menaxhoni imazhet dhe videot sipas albumeve ose të krijoni histori.


Përdorimi i galerisë

Hapni aplikacionin **Galeria**.



Shikimi i figurave

Hapni aplikacionin **Galeria** dhe zgjidhni një imazh. Për të parë skedarët e tjerë, lëvizni majtas ose djathtas në ekran.



Rimasterimi i imazheve

Mund të përmirësoni imazhet e paqarta, të turbullta dhe me rezolucion të ulët.

- 1 Hapni aplikacionin **Galeria** dhe zgjidhni një imazh.
- 2 Lëvizni sipër në ekran dhe shtypni **Rimasterizim**.
Mund të shikoni pamjen para dhe pas.
- 3 Shtypni ikonën e ruajtjes (↓) për ta ruajtur imazhin e masterizuar.

Nxjerrja e objekteve nga imazhet

Ndajeni një objekt nga sfondi dhe nxirreni. Mund ta kopjoni imazhin e nxjerrë ose ta përdorni në mënyra të ndryshme duke e ruajtur si ngjitëse ose si imazh.

- 1 Hapni aplikacionin **Galeria** dhe zgjidhni një imazh ose një video.
- 2 Prekni dhe mbani prekur mbi objektin që doni të nxirrni dhe zgjidhni një opsion.



Për videot, kjo veçori është e disponueshme vetëm kur ato janë ndaluar.


Prerja e imazheve të zmadhuara

- 1 Hapni aplikacionin **Galeria** dhe zgjidhni një imazh.
- 2 Hapni dy gishta mbi zonën që doni ta ruani dhe shtypni ikonën e prerjes së shpejtë (✂).
Pjesa e prerë do të ruhet si skedar.

Shikimi i videove

Hapni aplikacionin **Galeria** dhe zgjidhni një video që doni të luani. Për të parë skedarët e tjerë, lëvizni majtas ose djathtas në ekran.

Për të përdorur më shumë opsione gjatë luajtjes, shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Hap në Lexuesin video**.



Tërhiqni lart ose poshtë në anën e majtë të ekranit të luajtjes për të rregulluar ndriçimin, ose tërhiqni lart ose poshtë në të djathtë të ekranit të luajtjes për të rregulluar volumin.

Për të ecur shpejt mbrapa ose përpara, lëvizni majtas ose djathtas në ekranin e luajtjes.

Albumet

Hapni aplikacionin **Galeria**, prekni ikonën “Sirtari i navigimit” (≡) → **Albumet** → ikonën “Krijo” (+) dhe më pas zgjidhni llojin e albumit.

- **Album:** Krijoni albume të reja dhe shtoni imazhe dhe video manualisht.
- **Album auto-përditësues:** Krijoni albume që grumbullojnë automatikisht imazhe të njerëzve që zgjidhni.
- **Grupi:** Krijoni një grup me albume përkatëse.



Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të rajonit ose modelit.

Historitë

Kur kapni ose ruani imazhet dhe videot, pajisja do të lexojë etiketën e datës dhe vendndodhjes së tyre, do të renditë imazhet dhe videot dhe pastaj do të krijojë histori.

Hapni aplikacionin **Galeria**, prekni ikonën “Sirtari i navigimit” (≡) → **Historitë** dhe më pas zgjidhni një histori. Nëse shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮), mund të përdorni opsione të ndryshme, si ndryshimi i titullit të historisë.

Nëse shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Krijo histori** në listën e historive, mund të krijoni histori manualisht.

Sinkronizimi i imazheve dhe videove

Hapni aplikacionin **Galeria**, shtypni ikonën e sinkronizimit me OneDrive (☁), dhe më pas ndiqni udhëzimet në ekran për të kryer sinkronizimin. Kur aplikacioni **Galeria** dhe cloud janë të sinkronizuar, ikona do të ndryshohet me ikonën e sinkronizimit me OneDrive (☑).

Kur bëni sinkronizim, fotografitë dhe videot që boni do të ruhen gjithashtu në cloud. Mund të shikoni imazhet dhe videot e ruajtura në cloud në aplikacionin tuaj **Galeria** nga pajisje të tjera.



Kur e lidhni llogarinë Samsung dhe llogarinë Microsoft, mund ta vendosni magazinën cloud si Microsoft OneDrive.

Fshirja e imazheve ose videove

Hapni aplikacionin **Galeria**, prekni dhe mbani prekur një imazh, një video ose një album për ta fshirë, dhe pastaj shtypni **Hiq**.

Përdorimi i veçorisë së koshit të plehrave.

Imazhet dhe videot që fshini do të fshihen përfundimisht te koshi i plehrave. Skedarët do të fshihen pas një periudhe të caktuar.

Për të hapur skedarët në koshin e plehrave, hapni aplikacionin **Galeria** dhe prekni ikonën “Sirtari i navigimit” (☰) → **Koshi i mbeturinave**. Për të rivendosur skedarët, shtypni **Përzgjidh**, zgjidhni skedarët dhe më pas shtypni **Restauro**.

Bixby

Bixby është një ndërfaqe përdoruesi që ju ndihmon ta përdorni pajisjen më lehtë. Mund t’i thoni Bixby çfarë doni. Bixby do të hapë një veçori që kërkon ose do t’ju tregojë informacionet që doni.

Vizitoni www.samsung.com/bixby për më shumë informacion.



Bixby është i disponueshëm vetëm në disa gjuhë, ndaj mund të mos jetë i disponueshëm në varësi të rajonit.

Zgjimi i Bixby

Ndërsa shtypni dhe mbani shtypur butonin anësor, thojini Bixby çfarë doni. Për ta përdorur këtë veçori, hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **Butoni Anësor** → **Shtypje e gjatë** → **Bixby**.

Ose thoni shprehjen e zgjimit, si për shembull “Hi, Bixby” ose “Bixby”, dhe më pas thoni çfarë doni.

Vendosja e një shprehjeje zgjimi

1 Hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **Bixby** → **Regjistrimi zanor**.

2 Zgjidhni shprehjen e zgjimit që doni nën **Zgjimi me zë**.



Kur e hapni këtë aplikacion për herë të parë ose e rihapni pasi keni bërë një rivendosje të të dhënave, ndiqni udhëzimet në ekran për të përfunduar konfigurimin fillestar.

Bixby Vision

Bixby Vision është një shërbim që siguron veçori të ndryshme bazuar në njohjen e imazhit. Mund ta përdorni Bixby Vision për të kërkuar informacione duke njohur objekte. Përdorni një sërë veçorish të dobishme të Bixby Vision.



- Kjo veçori mund të mos jetë e disponueshme ose mund të mos merrni rezultate të sakta kërkimi në varësi të madhësisë, formatit ose rezolucionit të imazhit.
- Samsung nuk është përgjegjës për informacionet e produktit të dhëna nga Bixby Vision.

Hapja e Bixby Vision

Hapni Bixby Vision duke përdorur një nga këto metoda.

- Tek aplikacioni **Kamera**, shtypni **MË TEJ** në listën e modaliteteve të shkrepjes dhe shtypni ikonën e Bixby Vision (👁️).
- Tek aplikacioni **Galeria**, zgjidhni një imazh dhe shtypni ikonën e Bixby Vision (👁️).
- Nëse keni shtuar ikonën e aplikacionit Bixby Vision në ekranin fillestar, hapni aplikacionin **Bixby Vision**.

Përdorimi i Bixby Vision

1 Hapni Bixby Vision.

2 Zgjidhni një veçori që doni të përdorni.

- **PËRKTHEJE**: Nxirrni tekst nga dokumentet ose imazhet dhe përkthejeni.
- **TEKST**: Nxirrni tekst nga dokumentet ose imazhet dhe nxirreni.
- **ZBULO**: Kërkoni online imazhe të ngjashme me objektin e njohur dhe informacione përkatëse.
- **PËRSHKRUESI I SKENËS**: Analizoni skenën që keni fotografuar dhe përshkruajeni me zë.
- **IDENTIFIKUESI I OBJEKTIT**: Njihni tekst ose objekte dhe përshkruajini me zë.
- **LEXUESI I TEKSTIT**: Njihni tekstin dhe lexojeni me zë.
- **DETEKTORI I NGJYRËS**: Dalloni ngjyrën e objektin dhe thuajeni me zë.



- Veçoritë e disponueshme dhe rezultatet e kërkimit mund të ndryshojnë në varësi të rajonit ose rrjetit.
- Nëse disa veçori nuk shfaqen, hapni Bixby Vision, shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Cilësimet**, dhe më pas shtypni çelësat pas veçorive që doni të aktivizoni.


Multi window

(Përdorimi i disa aplikacioneve njëherësh)


Përdorini aplikacionet njëkohësisht në pamjen e ekranit të ndarë ose disa aplikacione në pamjen pop-up.



Disa aplikacione mund të mos e mbështetin këtë veçori.



Pamja në ekran të ndarë



Pamja kërcyese

Hapja e Multi window

- Butoni Të Fundit

Shtypni butonin “Të fundit” (|||), shtypni një ikonë aplikacioni dhe më pas shtypni **Hap në pamjen me ekran të ndarë** ose **Hap në pamjen kërcyese**.

- Rrëshqit ekranin

Hapni **Cilësimet**, shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **Multi-Window**, dhe më pas shtypni çelësin **Rrëshqit për ekran të ndarë** ose **Rrëshqit për pamje kërcyese** për ta aktivizuar.

- Taskbari

Ndërsa përdorni një aplikacion, tërhiqeni aplikacionin që doni nga taskbari lart dhe lëshojeni kudo që doni.




- Tërhiqni rrathët (• • •) midis dritareve të aplikacioneve për të ndryshuar madhësinë e dritareve.
- Shtypni rrathët (• • •) midis dritareve të aplikacioneve dhe shtypni ikonën e shtimit të çiftit të aplikacioneve (☆). Aplikacionet që përdorni në pamjen e ekranit të ndarë do të ruhen si çift aplikacionesh.
- Tërhiqni dorezën e multi window (—) në një vend të ri për të zhvendosur dritaren e aplikacionit.
- Kur shtypni dorezën e multi window (—), do të shfaqen menytë e disponueshme.

Interneti Samsung

Shfletoni internetin për të kërkuar informacione dhe shënoni faqet tuaja të preferuara të internetit për t'i hapur ato me lehtësi.

- 1 Hapni aplikacionin **Internet**.
- 2 Formoni adresën e internetit ose fjalën kyçe dhe pastaj shtypni **Shko**.

Nëse shiriti i mjeteve nuk shfaqet, rrëshqitni pak poshtë në ekran.



Përdorim i modalitetit Sekret

Nëse doni të vendosni një fjalëkalim për modalitetin Sekret, mund të mos i lejonit të tjerët të shikojnë historinë e kërkimit, historinë e shfletimit, faqeshënimet dhe faqet e ruajtura.

- 1 Shtypni ikonën e skedave (📑) → **Ndiz Regjimin sekret**.
- 2 Shtypni çelësin **Kyçe Regjimin sekret** për ta aktivizuar, shtypni **Fillo**, dhe pastaj vendosni një fjalëkalim për modalitetin Sekret.
Në modalitetin Sekret, pajisja do të ndryshojë ngjyrën e shiritave të veglave. Për të çaktivizuar modalitetin Sekret, shtypni ikonën e skedave (📑) → **Fik Regjimin sekret**.

Samsung Health

Samsung Health ju ndihmon të kontrolloni mirëqenien dhe paraqitjen tuaj fizike. Vendosni synime fitnesi, kontrolloni progresin dhe ndiqni mirëqenien dhe fitnesin tuaj të përgjithshëm. Gjithashtu mund të krahasoni regjistrimet e numrit të hapave me përdoruesit e tjerë të Samsung Health dhe të shikoni këshilla për shëndetin.

Hapni aplikacionin **Health**. Vizitoni www.samsung.com/samsung-health për më shumë informacion.


Samsung Notes

Hyrje

Krijoni shënime duke formuar tekst nga tastiera ose duke shkruar me dorë ose vizatuar në ekran. Gjithashtu mund të futni imazhe ose regjistrime zëri në shënimet tuaja.

Krijimi i shënimeve

- 1 Hapni aplikacionin **Notes**, shtypni ikonën e krijimit (📝), dhe pastaj krijoni një shënim.



- 2 Kur të keni mbaruar kompozimin e shënimit, shtypni butonin Prapa (<) për ta ruajtur. Nëse doni ta ruani shënimin në një format tjetër skedari, shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Ruaj si sked.**

Fshirja e shënimeve

Prekni dhe mbani prekur një shënim për ta fshirë, dhe shtypni **Hiq**.

Sinkronizimi i shënimeve


Mund të kontrolloni dhe modifikoni shënimet në të gjitha pajisjet tuaja në të cilat jeni identifikuar me të njëjtën llogari Samsung.

Hapni aplikacionin **Notes**, shtypni ikonën e sirtarit të navigimit (☰) → ikonën e cilësimeve (⚙️), dhe më pas shtypni çelësin **Sinkronizo me Samsung Cloud** për ta aktivizuar.

Kompozimi i shënimeve me shkrim dore

Në ekranin e kompozuesit, vizatoni ose shkruani me dorën tuaj.

Mund ta bëni më të madh shkrimin e dorës nëse zmadhoni ekranin duke hapur dy gishtat mbi të.



Nëse komanda me gisht nuk punon, shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Ndiz vizatimin me gisht.**

Përdorimi i fshirëses

Kur doni të fshini shkrimin e dorës nga një shënim, prekni ikonën “Modaliteti i fshirësit” (🧼) dhe zgjidhni një zonë për ta fshirë. Ose ndryshe, zgjidhni një zonë ndërsa shtypni dhe mbani shtypur butonin e S Pen.

Për të ndryshuar llojin e fshirësit, prekni edhe një herë ikonën “Modaliteti i fshirësit” (🧼).

- **Fshirësi i strockave:** Fshini vijën që zgjidhni.
- **Fshirës me zona:** Fshini vetëm zonën e zgjedhur. Mund të rregulloni përmasën e fshirësit duke tërhequr shufrën e rregullimit të madhësisë.



Edhe me fshirësin më të vogël, përsëri mund të mos jeni në gjendje të fshini saktë pjesën që doni.

Modifikimi i shënimeve të shkruara me dorë

Modifikoni shënimet e shkruara me dorë duke përdorur opsione të ndryshme modifikimi, si prerje, lëvizje ose ndryshim përmase.

- 1 Kur ka shkrim dore mbi shënim, prekni ikonën “Modaliteti i përzgjedhjes” ().
Për të ndryshuar formën e përzgjedhjes, prekni edhe një herë ikonën “Modaliteti i përzgjedhjes” ().
- 2 Shtypni ose vizatoni një vijë rreth informacionit për të zgjedhur.
 - Për ta lëvizur në një vend tjetër, zgjidheni informacionin dhe pastaj tërhiqeni në një vend të ri.
 - Për të ndryshuar madhësinë e zgjedhjes, shtypni informacionin dhe tërhiqeni një cep të kuadros që shfaqet.
- 3 Ndryshoni informacionin duke përdorur opsionet e disponueshme.

Rregullimi i shkrimit të dorës ose konvertimi në tekst

Për t'i drejtuar horizontalisht shkrimet e dorës ose vizatimet, prekni ikonën “Rregullo shkrimin e dorës” () → **Drejtvendose shkrimin me dorë.**

Për të zëvendësuar shkrimin e dorës me tekstin e konvertuar, prekni ikonën “Rregullo shkrimin e dorës” () → **Konverto në tekst.** Kur shfaqet ekrani i shikimit, shtypni ekranin dhe shtypni **Shtoje te.**

Nëse dëshironi të zëvendësoni menjëherë shkrimin e dorës me tekst, prekni S Pen në ikonën e tekstit () dhe më pas shkruani në ekran me S Pen.

Ndryshimi i stileve

Mund ta ndryshoni stilin e shkrimit të dorës dhe të vizatimeve.

Pasi të keni shkruar ose vizatuar në ekran, prekni dy herë ikonën “Ndrysho stilin” () dhe zgjidhni ngjyrën ose trashësinë e vijës që dëshironi. Më pas drejtojeni S Pen drejt vendit ku doni të aplikoni stilin. Kur shfaqet ikona “Shigjetë” (), prekni vendin ku dëshironi ta ndryshoni stilin.

Përdorimi i padit për shkrim me lehtësi

Në ekranin e krijimit të shënimit, prekni ikonën “Pad për shkrim me lehtësi” (). Fusha e hyrjes do të zmadhohet dhe do të shfaqet si pad për të shkruar me lehtësi.

Rregullimi automatikisht i formave

Prekni ikonën “Rregullo automatikisht format” () dhe vizatoni një formë. Forma do të rregullohet.

Regjistrimi i zërave te shënimet

Bëni një regjistrim të zërit tuaj ndërsa krijoni një shënim, dhe më pas materiali do të sinkronizohet me regjistrimin.

Në ekranin e krijimit të shënimit, prekni ikonën “Vendos” (✚) → **Regjistrimi zanor** dhe krijoni një shënim.

Zgjidhni një shënim nga lista dhe prekni ikonën “Hap regjistruesin e zërit” (🗨️) → ikonën “Luaj” (▶) për të luajtur regjistrimin. Më pas, materiali që keni krijuar gjatë regjistrimit, do të shfaqet në ekran së bashku me regjistrimin.

Shtimi i shënimeve në skedarët PDF

Hapni aplikacionin **Notes**, prekni ikonën “Importo PDF-të” (📎) dhe më pas zgjidhni një skedar PDF. Mund të shtoni shënime në skedarin PDF.

Ngulja e një shënimi në ekranin fillestar

Nguleni një shënim në ekranin fillestar për ta parë dhe ndryshuar atë.

- 1 Hapni aplikacionin **Notes**.
- 2 Zgjidhni një shënim dhe prekni ikonën “Më shumë opsione” (⋮) → **Shtoje te** → **Ekrani bazë** → **Shto**. Shënimi do të shtohet në ekranin fillestar.

Kapja e materialeve

Mund të shtoni materiale te një shënim, si për shembull një link faqeje interneti ose një imazh.

- 1 Kur ka materiale që doni t'i kapni ndërsa përdorni aplikacionin **Interneti Samsung** ose **Galeria**, hapni aplikacionin **Notes** në pamjen e ekranit të ndarë ose në pamjen pop-up. Për më shumë informacion rreth pamjes së ekranit të ndarë ose pamjes pop-up, shikoni [Multi window](#).
Ose shtypni dy herë ekranin ndërsa mbani shtypur butonin e S Pen, ose hapni panelin e Komandës ajrore dhe shtypni **Krijo shënim**.
Opsionet që mund të përdorni do të shfaqen në fund të ekranit të kompozuesit.
- 2 Zgjidhni një opsion që doni.

Samsung Members

Samsung Members ofron shërbime mbështetjeje për klientët, si për shembull diagnostikim të problemeve të pajisjes dhe i lejon përdoruesit të paraqesin pyetje dhe raporte gabimesh. Gjithashtu mund të ndani informacione me të tjerë në komunitetin e përdoruesve të Galaxy ose të shikoni lajmet dhe këshillat më të fundit. **Samsung Members** mund t'ju ndihmojë të zgjidhni çfarëdo problemi që mund të hasni ndërsa përdorni pajisjen tuaj.

Samsung Kids

Mund t'u ndaloni fëmijëve përdorimin e disa aplikacioneve të caktuara, të caktoni kohën e përdorimit të tyre, dhe të konfiguroni cilësimet për të siguruar një mjedis argëtues dhe të sigurt për fëmijët kur përdorin pajisjen.

Hapni **Cilësimet** dhe shtypni **App-et** → **Samsung Kids** → **Hap**. Kur hapni "Samsung Kids" për herë të parë ose pasi keni kryer një rivendosjeje të të dhënave, ndiqni udhëzimet në ekran për të përfunduar konfigurimin.

Në ekranin e Samsung Kids, zgjidhni aplikacionin që doni të përdorni.



Metoda e kyçjes së ekranit që keni vendosur ose PIN-i i krijuar do të përdoret kur aktivizoni veçorinë **Kontrollet Prindërore** ose kur mbyllni Samsung Kids.

Përdorimi i veçorive të kontrollit prindëror

Mund të konfiguroni cilësimet për Samsung Kids dhe të shihni historinë e përdorimit.

Në ekranin e Samsung Kids, shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Kontrollet Prindërore** dhe formoni kodin e zhbllokimit.

Mbyllja e Samsung Kids

Për ta mbyllur Samsung Kids, shtypni butonin Prapa (<) ose shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Mbylle Samsung Kids**, dhe më pas vendosni kodin e zhbllokimit.

Samsung Global Goals

Synimet Botërore, të cilat janë vendosur nga Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2015, përmban synime që kanë për qëllim krijimin e një shoqërie të qëndrueshme. Këto synime kanë fuqinë t'i japin fund varfërisë, të luftojnë pabarazinë, dhe të ndalojnë ndryshimin e klimës.

Me Samsung Global Goals, mësoni më shumë rreth synimeve globale dhe bashkohuni me lëvizjen për një të ardhme më të mirë.

Samsung TV Plus

Zgjidhni kanalet që doni të përdorni duke përdorur një televizor, dhe kënaquni me video të ndryshme falas.

Hapni aplikacionin **TV**.



Ky aplikacion mund të mos jetë i disponueshëm në varësi të rrjetit ose modelit.

Samsung Find

Mund ta gjeni pajisjen edhe nëse nuk është e lidhur në rrjet. Mund të ndani vendndodhjen tuaj me njerëzit që caktoni paraprakisht.

Hapni aplikacionin **Find**.

Samsung Shop

Samsung Shop është shërbimi i blerjes së celularëve i ofruar nga Samsung. Në të jepen informacione lidhur me produktet dhe shërbimet e Samsung dhe të partnerëve të tij.

Hapni aplikacionin **Samsung Shop**.



Ky aplikacion mund të mos jetë i disponueshëm në varësi të rrjetit ose modelit.

PENUP

PENUP është një shërbim rrjeti social për të ndarë punë artistike të vizatuara me S Pen. Postoni punimet tuaja artistike, shikoni punët artistike të të tjerëve dhe merrni këshilla të dobishme vizatimi. Hapni aplikacionin **PENUP**.

Kalendari

Menaxhoni programin tuaj duke vendosur ngjarjet e ardhshme në agjendën tuaj.

Hapni aplikacionin **Kalendari** dhe shtypni ikonën e shtimit të ngjarjes (+) ose shtypni dy herë një datë. Nëse data i ka ruajtur tashmë ngjarjet ose detyrat në të, shtypni datën dhe shtypni ikonën e shtimit të ngjarjes (+).

Sinkronizimi i ngjarjeve me llogaritë tuaja

- 1 Hapni **Cilësimet**, shtypni **Llogaritë dhe rezervimi** → **Menaxho llogaritë**, dhe më pas zgjidhni një llogari me të cilën të sinkronizoheni.
- 2 Shtypni **Sinkronizo llogarinë** dhe shtypni çelësin **Kalendari** për ta aktivizuar.

Për të shtuar llogari me të cilat të bëni sinkronizim, hapni aplikacionin **Kalendari** dhe prekni ikonën "Cilësimet" (⚙️) → **Menaxho kalendarët** → ikonën "Më shumë opsione" (⋮) → **Shto llogari**. Më pas zgjidhni një llogari për të sinkronizuar dhe identifikohuni.

Reminder

Regjistrojini si përkujtues gjërat që keni për të bërë, dhe merrni njoftime sipas kushtit që keni vendosur.

Hapni aplikacionin **Kalendari** dhe prekni **Përkujtesat** (🔔) → ikonën "Shto përkujtesë" (🔔+). Do të shfaqet ekrani Reminder dhe ikona e aplikacionit Reminder (✅) do të shtohet në ekranin e aplikacioneve.



- Për të marrë njoftime më të sakta, lidhuni me një rrjet Wi-Fi ose celular.
- Për të përdorur përkujtuesit e vendndodhjeve, duhet të aktivizohet veçoria GPS. Përkujtuesit e vendndodhjes mund të mos jenë të disponueshëm në varësi të modelit.

Përdorimi i Reminder

Hapni aplikacionin **Reminder**.

- Për të krijuar përkujtues, shtypni ikonën e shtimit të përkujtuesit (⊕).
- Për t'i përfunduar përkujtuesit, shtypni ikonën e shënimit të kutisë (◯) ose zgjidhni një përkujtues dhe shtypni **U krye**.
- Për t'i rivendosur përkujtesat, prekni **Përfundoi**, zgjidhni një përkujtesë për ta rivendosur dhe më pas prekni **Restauro**.
- Për ta fshirë një përkujtues, zgjidhni përkujtues dhe shtypni **Hiq**.

Regjist. Zanor

Regjistroni ose luani regjistrimet me zë.

- 1 Hapni aplikacionin **Regjist. Zanor**.
 - 2 Shtypni ikonën e regjistrimit () për të filluar regjistrimin. Flisni në mikrofon.
 - Shtypni ikonën e pauzës () për ta ndaluar për kohësisht regjistrimin.
 - Kur bëni një regjistrim me zë, shtypni ikonën e shtimit të faqeshënimit () për të futur një faqeshënim.
 - 3 Shtypni ikonën e ndalimit () për ta përfunduar regjistrimin.
 - 4 Vendosni një emër skede dhe shtypni **Ruaj**.
-  Për të regjistruar zërin tuaj dhe për ta konvertuar njëkohësisht në tekst në ekran, prekni **Fjalë-në-tekst** para se të filloni regjistrimin dhe zgjidhni gjuhën që dëshironi.

Transkriptimi i regjistrimeve me zë

Konvertoni regjistrimet me zë në tekst në ekran dhe modifikojeni atë.

- 1 Zgjidhni një regjistrim zanor.
- 2 Shtypni ikonën e më shumë opsioneve () → **Transkripto në tekst**.
- 3 Zgjidhni një buton për të nisur transkriptimin e regjistrimit zanor.
Nëse dëshironi të transkriptoni regjistrimin zanor në një gjuhë tjetër, prekni **Transkripto në një gjuhë tjetër** dhe zgjidhni gjuhën që dëshironi.
- 4 Shtypni butonin Prapa () → **Ruaj** për ta ruajtur tekstin e konvertuar.
 - Për të modifikuar tekstin e konvertuar, shtypni ikonën e më shumë opsioneve () → **Edito tekstin e transkriptimit**.
 - Për të hequr tekstin e konvertuar nga regjistrimi zanor, prekni ikonën “Më shumë opsione” () → **Hiqe transkriptimin**.

Skedarët e Mi

(Shikimi dhe menaxhimi i skedarëve)

Hapni dhe menaxhoni skedarët e ndryshëm të ruajtur në pajisje.

Hapni aplikacionin **Skedarët e Mi**.

Për të kontrolluar nëse ka të dhëna të panevojshme dhe për të liruar magazinën e pajisjes, shtypni **Menaxho magazinën**.

Për të kërkuar skedarë ose folderë të tjerë, shtypni ikonën e kërkimit (Q).

Ora

Vendosni alarmet, kontrolloni orën në shumë qytete rreth botës, matni kohën e një ngjarjeje ose caktoni një kohëzgjatje specifike.

Hapni aplikacionin **Ora**.

Kalkulatori

Bëni llogaritje bazë aritmetike ose shkencore.

Hapni aplikacionin **Kalkulatori**.

- 🕒 : Shikoni historinë e llogaritjeve. Për të pastruar historinë, shtypni **Pastro historinë**. Për të mbyllur panelin e historikut të llogaritjeve, prekni ikonën “Historiku i llogaritjeve” (🕒).
- 🌡️ : Përdorni mjetin e konvertimit të njësive. Mund të konvertoni vlera të ndryshme si sipërfaqen, gjatësinë ose temperaturën në njësi të tjera.

Gaming Hub

Qendra e lojërave mbledh lojërat e shkarkuara nga **Dyqani i Play** dhe **Galaxy Store** në një vend të vetëm.

Hapni aplikacionin **Gaming Hub** dhe zgjidhni lojën që doni.



Lojërat e shkarkuara nga **Dyqani i Play** dhe **Galaxy Store** do të shfaqen automatikisht në ekranin Qendra e lojërave. Nëse lojërat tuaja nuk janë atje, shtypni ikonën e zgjerimit (≡) → ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Shto lojëra**.

Heqja e një loje nga Qendra e lojërave.

Shtypni ikonën e zgjerimit (≡), prekni dhe mbani prekur një lojë, dhe më pas shtypni **Hiqe nga Gaming Hub**.

Game Booster

(Konfigurim i mjedisit të lojës)

Mund të luani lojëra në një mjedis më të mirë me Game Booster. Mund ta përdorni Game Booster ndërsa luani.

Për të hapur panelin e Game Booster ndërsa luani lojëra, shtypni ikonën e Game Booster (+) në fund të ekranit. Nëse ikona është e fshehur, tërhiqeni lart drejt fundit të ekranit për ta shfaqur.

- : Konfiguroni cilësimet për çdo lojë, si për shembull ndryshimin e modalitetit të performancës.
- ⚙ : Konfiguroni cilësimet për Game Booster.
- Mbrojtja ndaj prekjes:** Kyçni ekranin ndërkohë që luani lojëra. Për ta zhblokuar ekranin, tërhiqeni ikonën e kyçit në çfarëdo drejtimi.
- Pamje e çastit:** Kapni foto ekrani.
- Regjistri:** Regjistroni seancat e lojërave tuaja. Për të ndaluar regjistrimin, shtypni ikonën e ndalimit (■).
- Blloko butonat e navigimit:** Fshihni butonat në shiritin e navigimit. Për të shfaqur butonat, shtypni butonin e ikonës së kyçjes së butonit të navigimit (🔒) në shiritin e navigimit.
- Blloko panelin anësor:** Fshihni dorezën e panelit anësor ndërsa luani.
- Blloko ndriçimin auto:** Çaktivizoni rregullimet automatike të ndriçimit të ekranit ndërsa luani.
- Blloko Bixby-in:** Çaktivizoni Bixby ndërsa luani.

- **Edito:** Modifikoni listën e opsioneve.
- **Optimizimi i lojës:** Kontrolloni modalitetin aktual të performancës.
- **RAM:** Kontrolloni memorien e disponueshme.



- Opsionet e disponueshme mund të ndryshojnë në varësi të lojës.
- Performanca e lojërave mund të kufizohet për të kontrolluar temperaturën e pajisjes nëse temperatura ngrihet mbi një nivel të caktuar.

Ndryshimi i metodës së performancës

Mund të ndryshoni metodën e performancës së lojës.

Shtypni ikonën e Game Booster (+) → ikonën e cilësimeve (⚙️) → **Optimizimi i lojës** dhe zgjidhni modalitetin që doni.

- **Performanca:** Kjo fokusohet për t'ju dhënë performancën të lartë ndërsa luani lojëra. Nëse përdorni këtë modalitet, pajisja mund të nxehet për shkak të rritjes së konsumit të baterisë.
- **E balancuar:** Kjo balancon performancën dhe kohën e përdorimit të baterisë.
- **Kursyesi i baterisë:** Kjo kursen energjinë e baterisë ndërsa luani lojëra.



Efikasiteti i energjisë së baterisë mund të ndryshojë sipas lojës.

Hapja e aplikacioneve në dritare kërcyese gjatë luajtjes së lojërave


Mund t'i hapni aplikacionet në dritare kërcyese ndërsa luani një lojë.

Shtypni ikonën Game Booster (+) → **App-e kërcyese** dhe zgjidhni një aplikacion nga lista e aplikacioneve.

SmartThings

Kontrolloni dhe menaxhoni pajisjet inteligjente dhe produktet Internet of Things (IoT).

Hapni aplikacionin **SmartThings**. Për më shumë informacion, shtypni **Menyja** → **Si përdoret**.



- **Bazë:** Shtoni dhe menaxhoni pajisjet, rutinat ose shërbimet e përdorura shpesh.
- **Pajisjet:** Shtoni ose menaxhoni pajisjet.
- **Jetësore:** Përdorni shërbime të ndryshme, si për shembull kontrollimi i statusit të pajisjes ose përdorimi i energjisë, dhe kursimi i energjisë duke përdorur modalitetin e energjisë AI.
- **Rutinat:** Shtoni ose menaxhoni rutina.
- **Menyja:** Kontrolloni informacione të dobishme, pajisjet që mbështeten, si të përdorni veçori të caktuara etj.
- **Planimetria:** Kontrolloni dhe menaxhoni pajisjet e lidhura në pamjen e hartës.
- **Njoftimet:** Kontrolloni njoftimet për pajisjet e lidhura dhe shërbimet.



- Pajisjet që mund të lidhni mund të ndryshojnë në varësi të rajonit. Veçoritë e disponueshme mund të ndryshojnë në varësi të pajisjes së lidhur.
- Problemet ose defektet e pajisjeve të lidhura nuk mbulohen nga garancia e Samsung. Kur ndodhin probleme ose defekte në pajisjet e lidhura, kontaktoni prodhuesin e pajisjes.

Ndarja e materialeve

Ndani materiale duke përdorur opsione të ndryshme ndarjeje. Veprimet e mëposhtme janë një shembull i ndarjes së imazheve.

- 1 Hapni aplikacionin **Galeria** dhe zgjidhni një imazh.
 - 2 Shtypni ikonën e ndarjes (↗) dhe zgjidhni një metodë ndarjeje që doni.
-  Mund të hasni tarifa shtesë kur ndani skedat përmes rrjetit celular.

Quick Share

Ndani materiale me pajisjet pranë ose me njerëzit që keni te kontaktet.

- 1 Hapni aplikacionin **Galeria** dhe zgjidhni një imazh.
- 2 Në pajisjen tjetër, hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Pajisjet e lidhura** → **Quick Share** → **Kush mund të bashkëndajë me ty** → **Vetëm kontakte** ose **Kushdo** → **Kryer**.
- 3 Shtypni ikonën e ndarjes (↗) → **Quick Share** dhe zgjidhni një pajisje ku do të transferoni imazhin.
 - Për ta ndarë linkun me një kod QR, shtypni **Kodi QR ose linku** dhe skanoni kodin QR.
 - Për të ndarë me kontaktet, shtypni **Shih kontaktin**. (Modelet me rrjet celular të aktivizuar)
 - Për të ndarë materiale të enkriptuara, shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Ndize Bashkëndarjen private**. Materialet e ndara nuk mund të ruhen, kopjohen ose ridërgohen nga marrësi.
- 4 Pranoni kërkesën e transferimit të skedarëve në pajisjen tjetër.

Caktimi se kush mund ta gjejë tabletën tuaj

Caktoni se kush lejohet të gjejë dhe të dërgojë përmbajtje në tabletën tuaj.

- 1 Hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Pajisjet e lidhura** → **Quick Share** → **Kush mund të bashkëndajë me ty**.
- 2 Zgjidhni një opsion.
 - **Asnjë**: Mos i lejoni të tjerët që të gjejnë tabletën tuaj. Vetëm pajisjet e identifikuara në të njëjtën llogari Samsung mund ta gjejnë tabletin tuaj.
 - **Vetëm kontakte**: Ndani me njerëzit që keni të ruajtur te kontaktet.
 - **Kushdo**: Lejoni të gjitha pajisjet në afërsi që të ndajnë me tabletën tuaj.

Music Share

Duke përdorur veçorinë e ndarjes së muzikës, mund të ndani me një person tjetër altoparlantin me Bluetooth që është lidhur tashmë me tabletën tuaj. Gjithashtu mund të dëgjoni të njëjtën muzikë në Galaxy Buds dhe në Galaxy Buds të një personi tjetër.

Kjo veçori është e disponueshme vetëm në pajisjet që kanë veçorinë e ndarjes së muzikës.

Ndarja e një altoparlanti me Bluetooth

Në tabletën tuaj, hapni **Cilësimet**, shtypni **Pajisjet e lidhura** → **Music Share** dhe më pas shtypni çelësin për ta aktivizuar.

Ndiqui udhëzimet në ekran për të ndarë altoparlantin e Bluetooth-it tuaj.

Dëgjimi i muzikës së bashku me Galaxy Buds

Mund të dëgjoni muzikën që keni në tabletën tuaj nëpërmjet kufjeve Buds tuaja dhe kufjeve Buds të shokut tuaj.

Kjo veçori mbështetet vetëm në serinë Galaxy Buds.

- 1 Sigurohuni që tableta juaj, telefoni i mikut tuaj dhe një çift kufjesh të jenë të lidhura me njëra-tjetrën.
Shikoni [Çiftimi me pajisje të tjera Bluetooth](#) për mënyrën se si ta bëni lidhjen.
- 2 Në telefonin te mikut tuaj, hapni **Cilësimet**, shtypni **Pajisjet e lidhura**, dhe më pas shtypni çelësin **Music Share** për ta aktivizuar.
Mund të përdorni veçoritë shtesë, si për shembull mund të vendosni se me kë doni ta ndani pajisjen, duke shtypur **Music Share**.
- 3 Në tabletën tuaj, hapni panelin e cilësimeve të shpejta dhe shtypni **Dalja për media**.
- 4 Zgjidhni kufjet Buds të mikut tuaj nga lista e pajisjeve të gjetura.
- 5 Në telefonin e shokut tuaj, pranoni kërkesën për lidhje.
Kur luani muzikë nëpërmjet tabletës suaj, mund të dëgjoni muzikë së bashku nëpërmjet të dyja kufjeve Buds.

Smart View

(Pasqyrim në një ekran televizori)

Shikoni përmbajtjen e tabletës suaj të shfaqur në një ekran të madh duke e lidhur tabletën me një televizor ose monitor të pajisur me veçorinë e pasqyrimit të ekranit.

1 Hapni panelin e cilësimeve të shpejta dhe shtypni **Smart View**.

2 Zgjidhni një pajisje për të pasqyruar ekranin e tabletës suaj.



Kur luani një video me Smart View, rezolucioni mund të ndryshojë në varësi të modelit të televizorit.

Transmetimi i aplikacioneve në ekran

Shfaqni videon vetëm në ekranin e lidhur ndërsa kontrolloni mesazhet private ose ndërsa përdorni veçori të tjera në tabletin tuaj njëkohësisht.

Hapni aplikacionin për të transmetuar një video në ekranin e lidhur dhe shtypni ikonën Smart View (📺) → ikonën e transmetimit të aplikacionit (📡).



Disa aplikacione mund të mos e mbështetin këtë veçori.

Samsung Flow

Lidhni tabletën tuaj me një telefon ose me një kompjuter dhe përdorini së bashku duke bërë gjëra, të tilla si kontrollimi i njoftimeve dhe ndarja e përmbajtjes.

Samsung Flow duhet të instalohet në të dyja pajisjet që doni të lidhni. Nëse Samsung Flow nuk është instaluar, shkarkojeni nga **Galaxy Store** ose **Dyqani i Play**. Për kompjuterë, ju mund ta shkarkoni atë nga Microsoft Store.



Kjo veçori ofrohet vetëm në disa pajisje Android Samsung dhe në kompjuterë që funksionojnë me versionin Windows 10 e lartë.

Lidhja me një telefon

- 1 Në telefonin tuaj, hapni aplikacionin Samsung Flow.
- 2 Në tabletën tuaj, hapni aplikacionin **Flow** dhe prekni **Lidhe me telefonin**.
Nëse tableti juaj është i lidhur me një kompjuter, prekni ikonën “Më shumë opsione” (⋮) → **Lidhe me telefonin**.
- 3 Zgjidhni telefonin tuaj nga lista e pajisjeve të gjetura.
Nëse shfaqet dritarja kërcyese për zgjedhjen e metodës së lidhjes, zgjidhni metodën që dëshironi.
- 4 Pranoni fjalëkalimin në të dyja pajisjet.
Pajisjet do të lidhen.

Lidhja me një kompjuter

- 1 Në tabletën tuaj, hapni aplikacionin **Flow** dhe prekni **Lidhe me kompjuterin**.
Nëse tableta juaj është e lidhur me një telefon, shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Lidhe me kompjuterin**.
- 2 Në kompjuterin tuaj, hapni aplikacionin Samsung Flow dhe prekni **Fillo**.
- 3 Zgjidhni tabletin nga lista e pajisjeve të gjetura.
Nëse shfaqet dritarja kërcyese për zgjedhjen e metodës së lidhjes, zgjidhni metodën që dëshironi.
- 4 Pranoni fjalëkalimin në të dyja pajisjet.
Pajisjet do të lidhen.

Paneli ditor

Hyrje

Përdorni tabletën si kornizë fotografie ose tabelë buletini kur është duke u karikuar me një kabllo USB ose stacion karikimi. Mund të shijoni një fotoseri me imazhet tuaja të preferuara dhe të kontrolloni informacione, të tilla si ora, moti ose kalendari. Gjithashtu, mund të krijoni një shënim dhe të kontrolloni muzikën ndërsa e përdorni.

Nisja e Panelit ditor

- 1 Karikoni pajisjen me një kabllo USB ose stacion karikimi.
 Për ta lidhur pajisjen me një stacion karikimi, rrëshqiteni atë në stacionin e karikimit për të takuar lidhjet e pajisjes me terminalët e karikimit të stacionit.
- 2 Shtypni butonin e Panelit ditor () në shiritin e navigimit. Ekranin kryesor të Panelit ditor do të shfaqet dhe ju mund të kontrolloni orën, motin ose kalendarin.

Përdorimi i Panelit ditor

Luajtja e fotoserisë

Mund ta përdorni pajisjen si kornizë fotografie. Shijoni fotoseri të imazheve tuaja të preferuara në Panelin ditor.

Në ekranin kryesor të Panelit ditor, rrëshqitni djathtas për të luajtur një fotoseri.

-  Për të shtuar imazhet tuaja të preferuara që të shfaqen në fotoseri, hapni **Cilësimet**, prekni **Funksionalitete të avancuara** → **Paneli ditor** → **Fotoseri** → ikona "Cilësimet" () ngjitur me **Albumet** dhe më pas zgjidhni albumin.

Krijimi i një shënimi në Panelin ditor

Mund të përdorni pajisjen si tabelë buletini për të krijuar një shënim në Panelin ditor.

- 1 Rrëshqitni majtas në ekranin kryesor të "Panelit ditor" dhe prekni ikonën "Vizato" (.
- 2 Zgjidhni një laps dhe shkruani ose vizatoni në ekran.
- 3 Shtypni **U krye**.
Shënimi që do të krijoni do të ngulet në Panelin ditor.

Kontrollimi i muzikës

Mund të kontrolloni luajtjen e muzikës në Panelin ditor.

Prekni ikonën “Luajtja e muzikës” (🎵) dhe zgjidhni një aplikacion për të kontrolluar luajtjen.

Konfigurimi i cilësimeve për Panelin ditor

Konfiguroni cilësime të ndryshme për Panelin ditor dhe bëjeni atë më të personalizuar.

Hapni **Cilësimet** dhe prekni **Funksionalitete të avancuara** → **Paneli ditor**.

- **Ora, moti dhe kalendari:** Ndryshoni cilësimet për ekranin kryesor të Panelit ditor.
- **Memo:** Aktivizoni ose çaktivizoni veçorinë e përkujtuesit në Panelin ditor.
- **SmartThings:** Caktojeni pajisjen që të shfaqë pajisjet dhe skenat e SmartThings te Paneli ditor.
- **Fotoseri:** Zgjidhni imazhet për t'i shtuar në fotoseri dhe ndryshoni cilësimet e saj, si për shembull rendin e imazheve, shpejtësinë e kalimit dhe stilin. Gjithashtu, mund të caktoni informacionet e orës ose motit që shfaqen në fotoseri.
- **Muzikë:** Aktivizoni ose çaktivizoni veçorinë e kontrolluesit të muzikës në Panelin ditor.
- **Kariko baterinë ose trokit mbi ikonën:** Gjatë karikimit, butoni i Panelit ditor (🔌) do të shtohet te shiriti i navigimit.
 - **Shto Panelin ditor tek App-et:** Ikona e aplikacionit “Paneli ditor” (📱) do të shtohet tek ekrani “Aplikacionet”.
 - **Nise automatikisht kur të lidhet me karikuesin USB:** Paneli ditor do të hapet automatikisht kur pajisja të jetë duke u karikuar me një kabllo USB.
- **Njëlloj si ekran-ruajtësi:** Përdorni Panelin ditor si një mbrojtës ekrani.
- **Regjimi i errët:** Ekzekutoni modalitetin e errët për Panelin ditor. Mund edhe të caktoni programin që të ekzekutojë modalitetin e errët.
- **Fik sipas planit:** Caktoni programin për të mbyllur Panelin ditor. Kur aktivizoni këtë veçori, shtypni **Vër orën** për të caktuar orën e mbylljes së Panelit ditor.
- **Rreth Panelit ditor:** Kontrolloni versionin dhe informacionet ligjore të Panelit ditor.
- **Na kontakto:** Bëni pyetje ose shikoni pyetjet e bëra shpesh.

Mbyllja e Tabelës ditore

Për të mbyllur Panelin ditor, shtypni butonin Bazë (○) ose butonin Prapa (◀).


Samsung DeX

Përdorni veçoritë e pajisjes celulare në një mjedis ndërfaqeje të ngjashëm me një kompjuter.

Hapni panelin e cilësimeve të shpejta, shtypni ikonën e zgjerimit (—), dhe më pas shtypni **DeX** (DeX). Në të kundërt, hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Pajisjet e lidhura** → **Samsung DeX** → **Nise DeX**.

Për të ndryshuar modalitetin Samsung DeX, prekni dhe mbani shtypur **DeX** (DeX) në panelin e cilësimeve të shpejta, ose hapni **Cilësimet**, prekni **Pajisjet e lidhura** → **Samsung DeX**, dhe më pas zgjidhni modalitetin që dëshironi.

- **E reja:** Përdorni të njëjtën strukturë të ekranit bazë, të njëjtat miniaplikacione dhe ikona të tabletit.
- **Klasikja:** Përdorni funksionet e tabletës në një mjedis ndërfaqeje të ngjashëm me një kompjuter.



Modaliteti **E reja**



Modaliteti **Klasikja**



- Kur hapni ose mbyllni Samsung DeX, aplikacionet e hapura mund të mbyllen.
- Disa aplikacione ose veçori mund të mos jenë të disponueshme kur përdorni Samsung DeX.

Përdorimi i Samsung DeX me tastierën kopertinë

Mund ta caktoni pajisjen që të kalojë automatikisht në Samsung DeX kur lidhni tastierën kopertinë, e cila shitet veçmas.

Hapni **Cilësimet**, prekni **Pajisjet e lidhura** → **Samsung DeX** dhe më pas prekni çelësin **Nis automatikisht kur të lidhet Tastiera Kopertinë** për ta aktivizuar.

Mbyllja e Samsung DeX

Për të mbyllur Samsung DeX në modalitetin **E reja**, prekni **DeX** (DeX) në panelin e cilësimeve të shpejta. Në modalitetin **Klasikja**, zgjidhni butonin App-et (App) në fund të anës së majtë të ekranit dhe zgjidhni **Dil nga DeX**.

Aplikacionet Google

Google ofron aplikacione për argëtim, rrjete sociale dhe biznesi. Mund t'ju duhet një llogari Google për të përdorur disa aplikacione.

Për të parë më shumë informacion të aplikacionit, hapni menunë e ndihmës të secilit aplikacion.

- **Chrome:** Kërkoni informacione dhe shfletoni faqe interneti.
- **Gmail:** Dërgoni ose merrni email-në nëpërmjet shërbimit Google Mail.
- **Maps:** Gjeni vendndodhjen tuaj në hartë, kërkoni hartën e botës dhe shikoni informacionet e vendndodhjes për vendet e ndryshme pranë jush.
- **YT Music:** Kënaquni me muzikë dhe video të ndryshme që mundësohen nga YouTube Music. Gjithashtu mund të shikoni koleksione muzike që janë ruajtur në pajisjen tuaj dhe t'i luani ato.
- **Google TV:** Blini ose merrni me qira video, si për shembull filma dhe programe televizive, nga **Dyqani i Play**.
- **Drive:** Ruani materialet tuaja në cloud, përdorini nga kudo dhe ndajini me të tjerë.
- **YouTube:** Shikoni ose krijoni video dhe ndajini ato me të tjerë.
- **Google:** Kërkoni artikuj në internet ose në pajisjen tuaj.
- **Meet:** Bëni telefonata me video, krijoni mbledhje me video ose merrni pjesë në to.
- **Mesazhet:** Dërgoni dhe merrni mesazhe në pajisje ose kompjuter dhe ndani përmbajtje të ndryshme, si për shembull imazhe dhe video.
- **Gemini:** Bisedoni me Gemini për të përdorur veçori të ndryshme, si për shembull kërkimi për informacion, krijimi i imazheve të personalizuar ose shkrimi i përmbajtjeve.



Disa aplikacione mund të mos jenë të disponueshme në varësi të rrjetit ose modelit.

Cilësimet

Hyrje

Personalizoni cilësimet e pajisjes.

Në ekranin e aplikacioneve, shtypni **Cilësimet**. Ose hapni panelin e cilësimeve të shpejta dhe shtypni ikonën e cilësimeve (⚙️).

Për të kërkuar cilësime duke formuar fjalë kyçe, shtypni ikonën e kërkimit (🔍). Gjithashtu mund të kërkonit cilësime duke zgjedhur një temë.

Hyr me sign-in në Galaxy

Hyni në llogarinë tuaj Samsung dhe menaxhoheni.

Tek ekrani i cilësimeve, shtypni **Hyr me sign-in në Galaxy**.

Lidhjet

Opsionet

Ndryshoni cilësimet për lidhje të ndryshme, të tilla si veçoria Wi-Fi dhe Bluetooth.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Lidhjet**.

- **Wi-Fi:** Aktivizoni veçorinë Wi-Fi për t'u lidhur me një rrjet Wi-Fi dhe hapur internetin ose pajisje të tjera në rrjet. Për më shumë informacion, shihni [Wi-Fi](#).
- **Bluetooth:** Përdorni Bluetooth për të shkëmbyer të dhëna ose skedarë media me pajisje të tjera me Bluetooth. Për më shumë informacion, shikoni [Bluetooth](#).
- **Regjimi Avion:** Vendoseni pajisjen që të çaktivizojë të gjitha funksionet me valë në pajisjen tuaj. Mund të përdorni vetëm shërbimet pa-rrjet.



Ndiqui rregullat e dhëna nga kompania e fluturimit dhe udhëzimet e personelit të avionit. Në rastet ku nuk lejohet ta përdorni pajisjen, gjithmonë përdoreni në modalitetin Fluturim.

- **Menaxheri SIM:** Aktivizoni kartat tuaja SIM ose USIM dhe personalizoni cilësimet e kartës SIM. Për më shumë informacion, shikoni [Menaxheri SIM](#).
- **Rrjetet celulare:** Konfiguroni cilësimet e rrjetit tuaj celular.
- **Përdorimi i të dhënave:** Mbani shënim sasinë e përdorimit të të dhënave dhe personalizoni cilësimet për kufizimin. Vendoseni pajisjen që të çaktivizojë automatikisht lidhjen e internetit celular kur sasia e internetit celular ka arritur limitin e caktuar.

Mund të aktivizoni veçorinë e kursyesit të internetit për të mos lejuar që disa aplikacione të hapura në sfond të dërgojnë ose të marrin të dhëna. Për më shumë informacion, shihni [Kursyesi i të dhënave \(Modelet me rrjet celular të aktivizuar\)](#).

Po ashtu mund t'i caktoni aplikacionet që të përdorin vetëm Wi-Fi, internet celular ose të dyja. Për më shumë informacion, shihni [Rrjetet e lejuara për app-et \(Modelet me rrjet celular të aktivizuar\)](#).

- **Shpërndarësja dhe Tetherimi:** Përdoreni tabletën si shpërndarëse celulare për të ndarë lidhjen me internetin celular të tabletës me pajisje të tjera. Për më shumë informacion rreth hotspotit celular, shikoni [Shpërndarësja celulare \(Modelet me rrjet celular të aktivizuar\)](#).



Mund të tarifohehi më shumë kur përdorni këtë veçori.

- **Tetherimi:** Përdorni tethering për të ndarë lidhjen e internetit të pajisjes me pajisje të tjera.
- **Cilësime të tjera të lidhjes:** Personalizoni cilësimet për të kontrolluar veçori të tjera. Për më shumë informacion, shihni [Cilësime të tjera të lidhjes](#).



Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të modelit.

Wi-Fi

Aktivizoni veçorinë Wi-Fi për t'u lidhur me një rrjet Wi-Fi dhe hapur internetin ose pajisje të tjera në rrjet.

Lidhja me një rrjet Wi-Fi

1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Lidhjet** → **Wi-Fi**, dhe shtypni çelësin për ta aktivizuar.

2 Zgjidhni një rrjet nga lista e rrjeteve Wi-Fi.

Rrjetet që kanë ikonën e kyçit kanë nevojë për fjalëkalim.



- Pasi pajisja të lidhet me një rrjet Wi-Fi, pajisja do të rilidhet me atë rrjet çdo herë që është i disponueshëm pa kërkuar një fjalëkalim. Për të mos lejuar që pajisja të lidhet automatikisht me rrjetin, shtypni ikonën e cilësimeve (⚙️) pas rrjetit dhe shtypni çelësin **Rilidhje auto** për ta çaktivizuar.
- Nëse nuk mund të lidheni si duhet me një rrjet Wi-Fi, riaktivizojeni veçorinë Wi-Fi të pajisjes suaj ose routerin me valë.

Ndarja e fjalëkalimeve të rrjetit Wi-Fi

Nëse bëni një kërkesë një personi i cili është i lidhur me një rrjet Wi-Fi të sigurt, që të japë fjalëkalimin e tij të rrjetit, mund të lidheni me rrjetin pa formuar fjalëkalimin. Kjo veçori është e disponueshme mes pajisjeve që kanë kontakte me njëri-tjetrin, dhe ekranin e pajisjes tjetër duhet të jetë i ndezur.

1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Lidhjet** → **Wi-Fi**, dhe shtypni çelësin për ta aktivizuar.

2 Zgjidhni një rrjet nga lista e rrjeteve Wi-Fi.

3 Shtypni **Kërko fjalëkalimin**.

4 Pranoni kërkesën për ndarje në pajisjen tjetër.

Fjalëkalimi i Wi-Fi është formuar në pajisjen tuaj dhe ajo është e lidhur me rrjetin.

Wi-Fi Direct

Wi-Fi Direct lidh pajisjet direkt përmes një rrjeti Wi-Fi pa kërkuar një pikë akses.

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Lidhjet** → **Wi-Fi**, dhe shtypni çelësin për ta aktivizuar.
- 2 Shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Wi-Fi Direct**.
Pajisjet e zbuluara janë të renditura.
Nëse pajisja që doni të lidhni nuk është në listë, kërkon që pajisja të aktivizojë veçorinë e saj Wi-Fi Direct.
- 3 Zgjidhni një pajisje me të cilën do të lidheni.
Pajisjet do të lidhen kur pajisja tjetër pranon kërkesën për lidhjen Wi-Fi Direct.
Për ta mbyllur lidhjen e pajisjes, zgjidhni në listë pajisjen që doni të shkëputni.

Bluetooth

Përdorni Bluetooth për të shkëmbyer të dhëna ose skedarë media me pajisje të tjera me Bluetooth.

⚠ Masa paraprake për përdorimin e Bluetooth

- Samsung nuk është përgjegjës për humbjen, ndërprerjen ose keqpërdorimin e të dhënave të dërguara ose të marra me Bluetooth.
- Gjithmonë sigurohuni që po ndani dhe merrni të dhënat me pajisjet që janë të besuara dhe të siguruara mirë. Nëse ka pengesa mes pajisjeve, mund të ulet distanca e operimit.
- Disa pajisje, veçanërisht ato që nuk janë të provuara ose të aprovuara nga Bluetooth SIG, mund të mos jenë të përputhshme me pajisjen tuaj.
- Mos e përdorni veçorinë Bluetooth për qëllime të jashtëligjshme (për shembull, për kopje pirate të dosjeve ose përdorim i jashtëligjshëm i komunikimeve për qëllime tregtie). Samsung nuk është përgjegjës për përdorimin e jashtëligjshëm të veçorisë Bluetooth.

Çiftimi me pajisje të tjera Bluetooth

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Lidhjet** → **Bluetooth**, dhe shtypni çelësin për ta aktivizuar.
Do të renditen pajisjet e gjetura.
 - 2 Zgjidhni një pajisje me të cilën ta çiftoni.
Nëse pajisja me të cilin doni të lidheni nuk ndodhet në listë, vendoseni që pajisja të hyjë në metodën lidhjes me Bluetooth. Shikoni udhëzuesit e përdorimit të pajisjeve të tjera.
-  Tableta juaj është e dukshme për pajisjet e tjera kur ekrani i cilësimeve të Bluetooth është i hapur.
- 3 Pranoni kërkesën e lidhjes me Bluetooth në tabletën tuaj për të konfirmuar.
Pajisjet do të lidhen kur pajisja tjetër të pranojë kërkesën për lidhjen Bluetooth.
Për t'i shkëputur pajisjet, shtypni ikonën e cilësimeve (⚙️) pas emrit të pajisjes që doni të shkëputni dhe shtypni **Shpërçifto**.

Dërgimi dhe marrja e të dhënave

Shumë aplikacione mbështesin transferim të dhënash me anë të Bluetooth. Mund të ndani të dhëna, si kontakte ose dosje mediatike, me pajisje të tjera Bluetooth. Veprimet e mëposhtme janë një shembull i dërgimit të një figure te një pajisje tjetër.

- 1 Hapni aplikacionin **Galeria** dhe zgjidhni një imazh.
- 2 Shtypni ikonën e ndarjes (🔗) → **Bluetooth** dhe zgjidhni një pajisje ku ta transferoni imazhin.
Nëse pajisja me të cilën doni ta çiftoni nuk është në listë, kërkoni që pajisja të aktivizojë opsionin e saj të shikueshmërisë.
- 3 Pranoni kërkesën e lidhjes Bluetooth në pajisjen tjetër.

Kursyesi i të dhënave (Modelet me rrjet celular të aktivizuar)

Pakësoni përdorimin e internetit duke mos lejuar që disa aplikacione që janë të hapura në sfond të dërgojnë ose marrin të dhëna.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Lidhjet** → **Përdorimi i të dhënave** → **Kursyesi i të dhënave** dhe shtypni çelësin për ta aktivizuar.

Kur veçoria e kursimit të të dhënave është e aktivizuar, ikona e kursimit të të dhënave (🔒) do të shfaqet në shiritin e statusit.



Për të zgjedhur aplikacionet që përdorin kufizim, shtypni **App-e që mund të përdorin të dh.** dhe zgjidhni aplikacionet.

Rrjetet e lejuara për app-et (Modelet me rrjet celular të aktivizuar)

Caktoni aplikacionet që të përdorin vetëm Wi-Fi ose internet celular, ose të dyja.

Për shembull, mund ta vendosni pajisjen të përdorë vetëm internetin celular për aplikacionet që doni t'i mbani të sigurt ose për të transmetuar aplikacione që mund të shkëputen. Edhe nëse nuk e çaktivizoni veçorinë Wi-Fi, aplikacionet do të hapen duke përdorur internetin celular.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Lidhjet** → **Përdorimi i të dhënave** → **Rrjetet e lejuara për app-et**. Shtypni një aplikacion që doni nga lista e aplikacioneve dhe zgjidhni një opsion rrjeti.



Mund të tarifoheni më shumë kur përdorni internetin celular.

Shpërndarësja celulare (Modelet me rrjet celular të aktivizuar)

Përdoreni tabletën tuaj si shpërndarëse celulare për të ndarë lidhjen me internetin celular të tabletës suaj me pajisje të tjera.

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Lidhjet** → **Shpërndarësja dhe Tetherimi** → **Shpërndarësja celulare**.
 - 2 Shtypni çelësin për ta aktivizuar.
Mund të ndryshoni emrin e rrjetit, fjalëkalimin etj.
Ikona e hotspotit () shfaqet në shiritin e statusit.
 - 3 Në ekranin e pajisjes tjetër kërkoni për tabletën tuaj dhe zgjidheni atë nga lista e rrjeteve Wi-Fi.
Ose shtypni **Kodi QR** në ekranin e hotspotit celular dhe skanoni kodin QR me pajisjen tjetër.
-  • Nëse shpërndarësja celulare nuk gjendet në tabletë, caktoni **Banda** në **2.4 GHz**, prekni **Të avancuara** dhe më pas prekni çelësin **Rrjet i fshehur** për ta çaktivizuar.
 - Nëse e aktivizoni veçorinë **Shpërndarësja auto**, mund ta ndani lidhjen me internetin celular të tabletës suaj me pajisje të tjera të identifikuara në Samsung account tuaj.

Cilësime të tjera të lidhjes

Personalizoni cilësimet për të kontrolluar veçori të tjera lidhjeje.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Lidhjet** → **Cilësime të tjera të lidhjes**.

- **Skanim për pajisje të afërta:** Caktoni tabletën që të skanojë pajisjet në afërsi për t'u lidhur me to.
- **Printimi:** Konfiguroni cilësimet për shtesat e printerit të instaluar në pajisje. Mund të kërkoni printerë në dispozicion ose të shtoni një manualisht për të printuar dokumente. Për më shumë informacion, shikoni [Printimi](#).
- **VPN:** Konfiguroni rrjetet private virtuale (VPN) në pajisjen tuaj për t'u lidhur me rrjetin privat të një shkolle apo kompanie.
- **DNS privat:** Vendoseni pajisjen që të përdorë DNS private me siguri të lartë.
- **Ethernet:** Kur lidhni një adaptor Ethernet, mund të përdorni një rrjet me kabëll dhe të konfiguroni cilësimet e rrjetit.
- **Përditësoji automatikisht konfigurimet e sistemit:** Lejoni ndryshimet automatike të konfigurimit për t'u siguruar që veçoritë e lidhjes së rrjetit funksionojnë siç duhet.

Printimi

Konfiguroni cilësimet për shtesat e printerit të instaluar në pajisje. Mund ta lidhni pajisjen me një printer me anë të Wi-Fi ose Wi-Fi Direct, dhe të printoni figura ose dokumente.



Disa printerë mund të mos jenë të pajtueshëm me pajisjen.

Shtimi i plugin-ëve të printerit

Shtoni plugin-ë printeri për printerët me të cilët doni ta lidhni pajisjen.

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Lidhjet** → **Cilësime të tjera të lidhjes** → **Printimi** → **Shkarko plugin-in**.
- 2 Zgjidhni një plugin printeri dhe instalojeni.
- 3 Zgjidhni plugin-in e instaluar të printerit.
Pajisja do të kërkojë automatikisht printerat që janë të lidhur me të njëjtin rrjet Wi-Fi si pajisja juaj.
- 4 Zgjidhni një printer për ta shtuar.



Për të shtuar manualisht printerë, shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Shto printer**.

Printimi i materialeve

Ndërsa aksesoni përmbajtje, si për shembull imazhe ose dokumente, hapni listën e opsioneve, shtypni **Printo** → ikonën e listës zbritëse (▼) → **Të gjithë printerët...**, dhe më pas zgjidhni një printer.



Metodat e printimit mund të ndryshojnë sipas llojit të materialit.

Pajisjet e lidhura

Ndryshoni cilësimet për lidhjet e pajisjes.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Pajisjet e lidhura**.

- **Quick Share:** Ndryshoni cilësimet e Quick Share. Shihni [Quick Share](#) për më shumë informacion.
- **Music Share:** Ndryshoni cilësimet e opsionit Ndarja e muzikës. Shihni [Music Share](#) për më shumë informacion.
- **Këmbeji automatikisht Buds:** Vendosni që Galaxy Buds të kalojnë nga një pajisje tjetër te tableta juaj kur bëni ose i përgjigjeni një telefonate, kur luani media etj. Mund ta përdorni këtë veçori vetëm kur jeni identifikuar në të njëjtën llogari Samsung në pajisjen tjetër dhe jeni duke mbajtur Galaxy Buds tuaja.
- **Thirrje & tekst në pajisje të tjera:** Lidhni tabletën dhe telefonin për të përdorur veçoritë e telefonimit dhe të dërgimit të mesazheve në tabletë me numrin e telefonit tuaj. Duhet të regjistroheni dhe të hyni në të njëjtën llogari Samsung në tabletë dhe në telefon. Disa veçori telefonimi dhe mesazhesh mund të mos jenë të disponueshme.
- **Vazhdo në pajisje të tjera:** Përdorni aplikacionet dhe veçoritë e tabletit në pajisje të tjera, te të cilat keni hyrë në llogarinë tuaj Samsung.
- **Bashkëndarja e kamerës:** Përdorni kamerën e telefonit si uebkamerë për tabletin tuaj. Për ta përdorur këtë veçori, të dyja pajisjet duhet të jenë identifikuar në të njëjtën llogari Samsung dhe të kenë veçoritë Wi-Fi, Bluetooth dhe Ndarja e kamerës të aktivizuar.
- **Bashkëndarja e magazinës:** Ndani skedarët e tabletit me Samsung TV ose Galaxy Book. Për ta përdorur këtë veçori, të dyja pajisjet duhet të jenë identifikuar në të njëjtën llogari Samsung dhe të kenë veçoritë Wi-Fi, Bluetooth dhe Ndarja e magazinës të aktivizuar.
- **Link te Windows:** Hapni dhe përdorni të dhënat e pajisjes celulare, si aplikacionet ose figurat, në një kompjuter Windows. Nevojitet një llogari Microsoft për të përdorur këtë veçori. Vizitoni <https://aka.ms/setuptw> për hollësi.
- **Multi-kontroll:** Përdorni një maus dhe tastierë të lidhur me një kompjuter Samsung që mbështet këtë veçori në tabletën tuaj.
- **Ekrani i dytë:** Lidhni tabletën dhe kompjuterin për të përdorur tabletën si një ekran shtesë për kompjuterin. Kompjuteri duhet të punojë me Windows 10 ose më lart.
- **Samsung DeX:** Përdorni veçoritë e pajisjes celulare në një mjedis ndërfaqeje të ngjashëm me një kompjuter. Për më shumë informacion, shihni [Samsung DeX](#).
- **Smart View:** Shikoni përmbajtjen e tabletës suaj të shfaqur në një ekran të madh duke e lidhur tabletën me një televizor ose monitor të pajisur me veçorinë e pasqyrit të ekranit. Për më shumë informacion, shihni [Smart View](#).

- **SmartThings:** Kontrolloni dhe menaxhoni pajisjet inteligjente dhe produktet Internet of Things (IoT). Për më shumë informacion, shihni [SmartThings](#).
- **Android Auto:** Lidheni pajisjen tuaj me një automjet dhe kontrolloni disa prej veçorive të pajisjes suaj në ekranin e automjetit.



Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të modelit.

Regjimet dhe Rutinat

Përdorimi i modaliteteve

Shtoni një modalitet në bazë të aktivitetit ose vendndodhjes suaj aktuale. Cilësimet e pajisjes do të ndryshojnë për t'iu përshtatur aktivitetit ose situatës suaj. Mund ta aktivizoni ose çaktivizoni modalitetin nga paneli i cilësimeve të shpejta.

Shtimi i modaliteteve

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Regjimet dhe Rutinat** → **Regjimet**.
- 2 Zgjidhni një modalitet që doni ose shtypni **Shto regjim** për të shtuar modalitetet tuaja.

Hapja e modaliteteve

Modalitetet do të hapen automatikisht kur zbulohen kushtet e tyre. Gjithashtu mund t'i hapni manualisht duke shtypur butonin kurdoherë që doni.

Për t'i hapur modalitetet manualisht, zgjidhni modalitetin që doni dhe shtypni **Ndiz**.

Për të çaktivizuar një modalitet të hapur, shtypni modalitetin që doni dhe shtypni **Fik**.

Ose hapni panelin e cilësimeve të shpejta, shtypni **Regjimet**, dhe më pas zgjidhni një modalitet për ta aktivizuar. Për ta çaktivizuar modalitetin, shtypni butonin e modalitetit në panelin e cilësimeve të shpejta.

Përdorimi i rutinave

Automatizoni punët tuaja që përsëriten çdo ditë. Për shembull, mund të ndryshoni cilësimin e tingujve në varësi të vendit ku jeni, të optimizoni cilësimet e pajisjes për lojëra etj.

Shtimi i rutinave

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Regjimet dhe Rutinat** → **Rutinat**.
- 2 Shtypni ikonën e krijimit (+) dhe shtoni rutinat tuaja ose shtypni **Zbulo** dhe zgjidhni një rutinë që doni.
Nëse doni të vendosni kushtet e punimit të rutinës në manuale, shtypni **Nis manualisht**. Ky opsion do të shfaqet vetëm kur nuk ka kushte të caktuara në punë.

Hapja e rutinave

Rutinat automatike do të punojnë automatikisht kur dallohen kushtet e tyre. Për rutinat për të cilat ua vendosni kushtin e punimit si **Nis manualisht**, mund t'i vini ato në punë manualisht duke shtypur butonin kurdoherë që doni.

Për t'i hapur rutinat manualisht, shtypni ikonën e fillimit (▶) pas rutinës që doni të hapni. Nëse doni të përdorni një widget, shtypni një rutinë nën **Rutinat manuale** dhe shtypni **Më** → **Cilëso si widget** → **Shto**. Rutina do të shtohet si widget tek ekrani fillestar dhe ju mund ta vini në punë rutinën duke shtypur widget-in.

Për t'i ndaluar rutinat, shtypni ikonën e listës së rutinave (⏏), shtypni rutinën nën **Duke punuar**, dhe më pas shtypni **Ndal**, ose shtypni widget-in e rutinës në ekranin fillestar.

Tingull

Opsionet

Ndryshoni cilësimet për tinguj të ndryshëm në pajisje.

Në ekranin Cilësimet, shtypni **Tingull**.

- **Tingull / Heshtje:** Vendoseni pajisjen për të përdorur metodën me zë ose me pa zë.
- **Përkohësisht heshtuar:** Caktojeni pajisjen në modalitet pa zë për një periudhë të caktuar.
- **Toni i ziles:** Ndryshoni ringtonin e telefonatës.
- **Tingulli i njoftimit:** Ndryshoni tingullin e njoftimit.
- **Tingulli i sistemit:** Ndryshoni tingullin për të përdorur disa veprime të caktuara, si për shembull karikimin e pajisjes.
- **Volumi:** Rregulloni nivelin e volumit të pajisjes.
- **Cilësia & efektet zanore:** Vendosni cilësinë dhe efektet e tingujve të pajisjes. Për më shumë informacion, shihni [Cilësia & efektet zanore](#).
- **Audio më vete për app-in:** Caktojeni pajisjen që të luajë tinguj multimedia nga një aplikacion specifik veçmas nga pajisja tjetër audio. Për më shumë informacion, shihni [Audio më vete për app-in](#).



Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të modelit.

Cilësia & efektet zanore

Vendosni cilësinë dhe efektet e tingujve të pajisjes.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Tingull** → **Cilësia & efektet zanore**.

- **Dolby Atmos:** Zgjidhni metodën e tingullit rrethues të optimizuar për lloje të ndryshme audioje, si filma, muzikë dhe zë. Me Dolby Atmos, mund të përjetoni tinguj të lëvizshëm audioje që qarkullojnë rreth jush.
- **Barazuesi:** Ndryshoni profilin e tingullit dhe shijoni tingull të optimizuar.
- **Normalizimi i zërit të lartë:** Reduktoni diferencat në volum mes materialeve të ndryshme. Pajisja do të rritë automatikisht volumin e materialit me volum të ulët.
- **Cilësimet audio të app-it:** Kontrolloni dhe menaxhoni cilësimet e optimizuara të tingujve që keni ruajtur për secilin aplikacion të medias. Për të rregulluar cilësimet e tingujve për secilin aplikacion, hapni panelin e cilësimeve të shpejta ndërsa luani materiale në aplikacion, prekni dhe mbani prekur shiritin e rregullimit të volumit, dhe më pas ndryshoni cilësimet. Të njëjtat cilësime do të aplikohen herës tjetër që hapni aplikacionin.
- **Adapt sound:** Vendosni tingullin më të mirë për ju.
- **Rritësi UHQ:** Përmirësoni rezolucionin e muzikës dhe videove kur përdorni kufjet me kabllo ose kufje me Bluetooth që mbështetin UHQ.



Në varësi të modelit, duhet të lidhni kufjet për të përdorur disa veçori.

Audio më vete për app-in

Vendoseni pajisjen të luajë tinguj mediatikë nga një aplikacion specifik në altoparlantin ose kufjen Bluetooth.

Për shembull, mund të dëgjoni aplikacionin navigimi me anë të altoparlantit të pajisjes ndërsa dëgjoni muzikë nga aplikacionin Muzikë me anë të altoparlantit Bluetooth të makinës.

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Tingull** → **Audio më vete për app-in** dhe shtypni çelësin për ta aktivizuar.
- 2 Zgjidhni një aplikacion për t'i luajtur tingujt veçmas dhe shtypni butonin Prapa (<).
- 3 Zgjidhni një pajisje për të luajtur tingullin e medias të aplikacionit të zgjedhur.

Njoftimet

Ndryshoni konfigurimet e njoftimeve.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Njoftimet**.

- **Njoftime të app-eve:** Zgjidhni aplikacionet nga të cilat doni të merrni njoftime.
- **Njoftimet në Ekranin e bllokimit:** Vendosni si të shfaqen njoftimet në ekranin e kyçur.
- **Shiriti i gjendjes:** Vendosni se si doni të shfaqen ikonat e njoftimeve dhe nëse doni të shfaqet përqindja e mbetur e baterisë në shiritin e statusit.
- **Stili i njoftimit kërcyes:** Zgjidhni një stil pop-up njoftimesh dhe ndryshoni cilësimet.
- **Mos shqetësoni:** Caktojeni pajisjen që të çaktivizojë të gjithë tingujt, përveç përjashtimeve të lejuara.
- **Cilësime të avancuara:** Konfiguroni cilësimet e avancuara për njoftimet.

Ekran

Opsionet

Ndryshoni cilësimet e ekranit dhe të ekranit fillestar.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Ekran**.

- **E lehtë / E errët:** Aktivizoni ose çaktivizoni modalitetin e ndriçuar ose të errët.
- **Cilësimet e Regjimit të errët:** Pakësoni lodhjen e syrit duke aplikuar temën e errët kur e përdorni pajisjen natën ose në një vend të errët. Mund të vendosni një program për aplikimin e modalitetit të errët.
 Tema e errët mund të mos aplikohet në disa aplikacione.
- **Ndriçimi:** Rregulloni ndriçimin e ekranit.
- **Ndriçimi përshtatës:** Vendoseni pajisjen që të ndjekë rregullimet e ndriçimit dhe t'i aplikojë ato automatikisht në kushte ndriçimi të ngjashme.
- **Rrjedhshmëria e lëvizjes:** Ndryshoni shpejtësinë e rifreskimit të ekranit. Kur vendoset një shpejtësi e lartë rifreskimi, ekrani do të lëvizë më me qetësi. Për më shumë informacion, shikoni [Rrjedhshmëria e lëvizjes](#).
- **Mbrojtësja e syve:** Pakësoni lodhjen në sy duke pakësuar dritën blu të nxjerrë nga ekran. Mund të vendosni një program për aplikimin e kësaj veçorie.

- **Regjimi i ekranit:** Ndryshoni metodën e ekranit për të rregulluar ngjyrat dhe kontrastin e ekranit. Për më shumë informacion, shikoni [Ndryshimi i metodës së ekranit ose rregullimi i ngjyrave të ekranit](#).
- **Madhësia dhe stili i fontit:** Ndryshoni madhësinë dhe stilin e shkrimit.
- **Zoom-i në ekran:** Bëjini më të mëdha ose më të vogla gjërat në ekran.
- **Përpjesëtimi i kuadrit:** Zgjidhni një raport pamjeje për çdo aplikacion kur hapet.
- **Mbarim i kohës së ekranit:** Vendosni kohën që pret pajisja para se të fikë dritën e ekranit.
- **Panelet anësore:** Ndryshoni cilësimet për panelin anësor.
- **Shiriti i detyrave:** Ndryshoni cilësimet për taskbarin. Për më shumë informacion, shihni [Taskbari](#).
- **Shiriti i navigimit:** Ndryshoni cilësimet e shiritit të navigimit. Për më shumë informacion, shihni [Shiriti i navigimit \(butonat me prekje\)](#).
- **Ndjeshmëria në prekje:** Rritni ndjeshmërinë e prekjes së ekranit për përdorim me mbrojtëse ekрани.
- **Ekran-ruajtësja:** Vendoseni pajisjen që të hapë mbrojtësin e ekranit kur karikohet pajisja.



Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të modelit.

Rrjedhshmëria e lëvizjes

Shpejtësia e rifreskimit është numri se sa herë ekrani rifreskohet çdo sekondë. Përdorni një shpejtësi të lartë rifreskimi për të mos lejuar që ekrani të dridhet kur ndryshon pamjen. Ekrani do të lëvizë më ëmbël. Kur zgjidhni një shpejtësi rifreskimi standarde, bateria do të zgjatë më shumë.

1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Ekran** → **Rrjedhshmëria e lëvizjes**.

2 Zgjidhni një shpejtësi rifreskimi.

- **Përshtatëse:** Bëni që animacionet dhe lëvizjet lart e poshtë të jenë më të lirshme duke rritur shpejtësinë e rifreskimit të ekranit.
- **Standard:** Përdorni një shpejtësi standarde rifreskimi në situatat normale për të kursyer baterinë.

Ndryshimi i metodës së ekranit ose rregullimi i ngjyrave të ekranit

Ndryshoni modalitetin e ekranit ose rregulloni ngjyrat e ekranit sipas preferencës suaj.

Ndryshimi i metodës së ekranit

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Ekrani** → **Regjimi i ekranit** dhe zgjidhni metodën që dëshironi.

- **Gjallëri:** Kjo optimizon gamën e ngjyrave, saturimin dhe mprehtësinë e ekranit tuaj.
- **Natyrore:** Kjo rregullon ekranin në një ton më natyral.



- Mund të rregulloni ngjyrat e ekranit vetëm në modalitetin **Gjallëri**.
- Modaliteti **Gjallëri** mund të mos jetë i pajtueshëm me aplikacionet e palëve të treta.

Optimizimi i balancës së ngjyrave në ekran të plotë

Optimizoni ngjyrat e ekranit duke rregulluar tonet e ngjyrave sipas preferencës suaj.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Ekrani** → **Regjimi i ekranit** → **Gjallëri** dhe rregulloni shiritin e rregullimit të ngjyrave nën **Balanca e dritës**.

Kur tërhiqni shiritin e rregullimit të ngjyrave drejt **E ftohtë**, toni i ngjyrës blu do të rritet. Kur tërhiqni shiritin drejt **E ngrohtë**, toni i ngjyrës së kuqe do të rritet.

Bateria

Kontrolloni energjinë e mbetur të baterisë dhe kohën për ta përdorur pajisjen. Për pajisjet me nivele të ulëta të baterisë, kurseni baterinë duke aktivizuar veçoritë e kursimit të energjisë.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Bateria**.

- **Kursim energjie:** Aktivizoni metodën e kursimit të energjisë për të rritur kohën e përdorimit të baterisë.
- **Caqet e përdorimit në sfond:** Kufizoni përdorimin e baterisë për aplikacionet që nuk i përdorni shpesh.
- **Mbrojtja e baterisë:** Vendosni që të ndalohet karikimi kur bateria është e karikuar plotësisht ose kufizoni karikimin maksimal në një nivel të caktuar.
- **Sot:** Kontrolloni nivelin e baterisë dhe historinë e përdorimit.
- **Cilësimet e karikimit:** Konfiguroni cilësimet e karikimit.
- **Errëso automatikisht ekranin:** Errësoni ekranin kur energjia e mbetur e baterisë bie nën një nivel të caktuar.
- **Trego % e baterisë:** Shfaqni përqindjen e mbetur të baterisë në shiritin e statusit.
- **Informacioni për baterinë:** Shikoni statusin dhe informacione të baterisë.



- Koha e mbetur e përdorimit tregon kohën e mbetur para se të mbarojë bateria. Koha e mbetur e përdorimit mund të ndryshojë sipas konfigurimeve të pajisjes dhe kushteve të përdorimit.
- Mund të mos merrni njoftime nga disa aplikacione që përdorin metodën e kursimit të energjisë.
- Mund të kontrolloni informacionin e mëposhtëm të baterisë këtu. Informacioni i disponueshëm mund të ndryshojë në varësi të rajonit ose ofruesit të shërbimit.
 - Data e prodhimit të baterisë
 - Data e përdorimit të parë
 - Numri i cikleve të karikimit/shkarkimit të plotë (në bazë të kapacitetit nominal)
 - Gjendja e përlllogaritur e shëndetit

Letra e murit dhe stili

Ndryshoni cilësimet e ekranit për Ekranin fillestar dhe ekranin e kyçur.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Letra e murit dhe stili**.

Faqja bazë

Konfiguroni cilësimet për ekranin fillestar, si për shembull pamjen në ekran.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Faqja bazë**.

Kyç ekranin

Opsionet

Ndryshoni cilësimet për ekranin e kyçur.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Kyç ekranin**.

- **Bllokimi i ekranit & biometrika:** Ndryshoni metodën e kyçjes të ekranit.
- **Zhbllokimi i zgjatur:** Caktoni pajisjen që të zhbllokohet vetë kur gjenden pajisje ose vendndodhje të besuara. Për më shumë informacion, shihni [Zhbllokimi i zgjatur](#).
- **Cilësimet e Bllokimit të sigurt:** Ndryshoni cilësimet e kyçjes së ekranit për metodën e kyçjes së zgjedhur.
- **Now bar:** Zgjidhni artikujt për t'i shfaqur në ekranin e kyçur.
- **Prek dhe mbaj për të edituar:** Vendoseni pajisjen që të shfaqë opsionet e modifikimit kur prekni dhe mbani prekur ekranin e kyçur.
- **Ora në bredhje:** Ndryshoni orën që të shfaqë zonën e orës lokale si dhe të shtëpisë në ekranin e kyçur kur jeni jashtë zonës së mbulimit.
- **Informacion i kontaktit:** Caktoni pajisjen që të shfaqë informacionin e kontakteve, si p.sh. adresën tuaj të emailit, në ekrani ne kyçur.
- **Trego efektin kalesë në zhbl.**: Vendosni ekranin që të shfaqë efektin e kalimit të zhbllokimit kur e zhbllokoni ekranin duke përdorur të dhënat tuaja biometrike.
- **Rreth Ekranit të bllokimit:** Shikoni versionin dhe informacione ligjore të ekranit të kyçur.



- Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të rrjetit ose modelit.
- Opsionet e disponueshme mund të ndryshojnë në varësi të metodës të zgjedhur për kyçjen e ekranit.

Zhbllokimi i zgjatur

Mund të vendosni që pajisja të zhbllokohet vetë dhe të qëndrojë e pabllokuar kur dallohen vende ose pajisje të besuara.

Për shembull, nëse e keni vendosur shtëpinë si vend të besuar, kur shkoni në shtëpi pajisja do të dallojë vendin ku ndodhet dhe do të zhbllokohet vetë.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Kyç ekranin** → **Zhbllokimi i zgjatur** dhe ndiqni udhëzimet në ekran për të bërë konfigurimin.



- Kjo veçori do të jetë e disponueshme për t'u përdorur pasi vendosni një metodë për kyçjen e ekranit.
- Nëse nuk e përdorni pajisjen për katër orë ose kur e ndizni pajisjen, duhet ta zhbllokoni ekranin duke përdorur vizatimin, PIN-in ose fjalëkalimin që keni vendosur.

Siguria dhe privatësia

Opsionet

Shikoni statusin e sigurisë dhe privatësisë së pajisjes dhe ndryshoni cilësimet.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe privatësia**.

- **Ekrani i bllokimit:** Ndryshoni cilësimet për ekranin e kyçur.
- **Siguria e llogarisë:** Ndryshoni cilësimet për llogaritë tuaja.
- **Mbrojtja për pajisjen e humbur:** Aktivizoni ose çaktivizoni veçorinë Gjej celularin. Hapni smartthingsfind.samsung.com për të gjurmuar dhe kontrolluar tabletën që ju ka humbur ose që jua kanë vjedhur. Gjithashtu mund të kontrolloni vendndodhjen e pajisjeve që mbahen në trup, të cilat janë të lidhura me këtë tabletë.
- **Siguria e app-eve:** Skanoni aplikacionet dhe mbrojeni pajisjen nga softuerët e këqij.
- **Përditësime:** Shikoni versionin e softuerit të pajisjes suaj dhe kontrolloni për përditësime.
- **Bllokimi i ekranit & biometrika:** Ndryshoni cilësimet për ekranin e kyçur dhe të dhënat biometrike. Për më shumë informacion, shihni [Njohja e fytyrës](#) dhe [Njohja e shenjës të gishtit](#).
- **Bllokuesi auto:** Mbajeni pajisjen tuaj të sigurt duke bllokuar kërcënimet ose aktivitete të tjera të dyshimta.
- **Statusi i sigurisë i pajisjeve:** Kontrolloni statusin e sigurisë së pajisjeve tuaja që janë të identifikuara në llogarinë tuaj Samsung.
- **Cilësime të tjera të sigurisë:** Konfiguroni cilësime të tjera sigurie. Për më shumë informacion, shihni [Wi-Fi e sigurt](#), [Dosja e sigurt](#) dhe [Samsung Pass](#).
- **Lejet e përdorura gjatë 24 orëve të fundit:** Kontrolloni historinë e përdorimit të lejeve të aplikacionit ose veçorisë.

- **Mbrojtja e privatës. në Internet:** Kontrolloni historinë e mbrojtjes së privatësisë në internet dhe ndryshoni cilësimet. Kjo veçori do të shtohet kur përdorni aplikacionin **Interneti Samsung**.
- **Kontrollet dhe sinjalizimet:** Kontrolloni aksesin te veçori të tilla si mikrofoni dhe kujtesa e fragmenteve.
- **Cilësime të tjera të privatësisë:** Konfiguroni cilësime të tjera të privatësisë.



Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të rrjetit ose modelit.

Njohja e fytyrës

Mund ta vendosni pajisjen që të hapë ekranin duke njohur fytyrën tuaj.



- Nëse përdorni fytyrën si metodë për zhbllokimin e ekranit, fytyra juaj nuk mund të përdoret për të zhbllokuar ekranin për herë të parë pasi keni ndezur pajisjen. Për ta përdorur pajisjen, duhet të zhbllokoni ekranin duke përdorur vizatimin, PIN ose fjalëkalimin që vendosët kur regjistruat fytyrën. Bëni kujdes të mos e harroni strukturën, PIN-in ose fjalëkalimin.
- Nëse ndryshoni metodën e kyçjes së ekranit në **Godit** ose **Asnjë**, të cilat nuk janë të sigurta, të gjitha të dhënat tuaja biometrike do të fshihen.



Masat paraprake për përdorimin e njohjes së fytyrës

Para se të përdorni njohjen e fytyrës për të zhbllokuar pajisjen, mbani parasysh masat paraprake të mëposhtme.

- Pajisja juaj mund të zhbllokohet nga dikush ose diçka që ngjan me pamjen tuaj.
- Njohja e fytyrës është më pak e sigurt se struktura, PIN-i ose fjalëkalimi.

Për njohje më të mirë të fytyrës

Merreni parasysh kur përdorni njohjen e fytyrës:

- Merrni parasysh kushtet kur bëni regjistrimin, si për shembull mbajtjen e syzeve, kapeleve, maskave, mjekrave ose tualetit të rëndë.
- Sigurohuni që të ndodheni në një vend të ndriçuar mirë dhe që lentja e kamerës të jetë e pastër kur bëni regjistrimin.
- Sigurohuni që imazhi të mos jetë i turbullt për rezultate më të sakta.

Regjistrimi i fytyrës suaj

Për regjistrim më të mirë të fytyrës, regjistroni fytyrën tuaj brenda dhe larg dritës së diellit.

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe privatësia** → **Blokimi i ekranit & biometrika** → **Njohja me fytyrë**.
 - 2 Vendosni një metodë kyçjeje.
 - 3 Lexoni udhëzimet në ekran dhe shtypni **Vazhdo**.
 - 4 Shtypni **Regjistro** dhe poziciononi fytyrën tuaj brenda kuadros në ekran.
Kamera do të skanojë fytyrën tuaj.
-  • Nëse hapja e ekranit me fytyrë nuk punon mirë, shtypni **Hiqi të dhënat e fytyrës** për ta hequr fytyrën e regjistruar dhe regjistroni fytyrën tuaj përsëri.
 - Për të përmirësuar njohjen e fytyrës, shtypni **Shto një pamje alternative për ta përmirësuar njohjen** dhe shtoni një paraqitje alternative.

Zhblokimi i ekranit me fytyrë

Mund ta zhblokonti ekranin me fytyrë në vend se të përdorni një strukturë, PIN ose fjalëkalim.

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe privatësia** → **Blokimi i ekranit & biometrika**.
- 2 Zhblokojeni ekranin duke përdorur metodën e zhblokimit të ekranit të caktuar më parë.
- 3 Shtypni **Njohja me fytyrë** dhe shtypni çelësin **Zhblokimi me fytyrë** për ta aktivizuar.
- 4 Në ekranin e kyçur, shikoni në ekran.
Kur të njihet fytyra juaj, mund ta zhblokonti ekranin pa përdorur metodë shtesë për kyçjen e ekranit.
Nëse fytyra juaj nuk njihet, përdorni metodën e kyçjes së ekranit me kod.

Fshirja e të dhënave të regjistruara të fytyrës

Mund t'i fshini të dhënat e fytyrës që keni regjistruar.

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe privatësia** → **Blokimi i ekranit & biometrika**.
- 2 Zhblokojeni ekranin duke përdorur metodën e zhblokimit të ekranit të caktuar më parë.
- 3 Shtypni **Njohja me fytyrë** → **Hiqi të dhënat e fytyrës** → **Largo**.
Pasi të fshihet fytyra e regjistruar, të gjitha veçoritë përkatëse do të çaktivizohen gjithashtu.

Njohja e shenjës të gishtit

Në mënyrë që njohja e shenjës së gishtit të funksionojë, informacionet e shenjave të gishtave duhet të jenë të regjistruara dhe të ruajtura në pajisjen tuaj.



- Kjo veçori mund të mos jetë e disponueshme në varësi të rrjetit ose modelit.
- Njohja e shenjave të gishtave përdor karakteristikat unike të secilit gisht për të rritur sigurinë e pajisjes suaj. Ngjashmëria që sensori i gishtave të ngatërrojë dy shenja gishtash të ndryshëm është shumë e ulët. Sidoqoftë, në raste të rralla ku shenjat e ndryshme të gishtave janë shumë të ngjashme, sensori mund t'i njohë si të njëjta.
- Nëse përdorni shenjën e gishtit si metodë për kyçjen e ekranit, shenja e gishtit nuk mund të përdoret për të zhbllokuar ekranin për herë të parë pasi keni ndezur pajisjen. Për ta përdorur pajisjen, duhet të zhbllokoni ekranin duke përdorur vizatimin, PIN ose fjalëkalimin që vendosët kur regjistruat shenjën e gishtit. Bëni kujdes të mos e harroni strukturën, PIN-in ose fjalëkalimin.
- Nëse shenja e gishtit nuk njihet, zhbllokojeni pajisjen duke përdorur strukturën, PIN-in ose fjalëkalimin që vendosët kur regjistruat shenjën e gishtit, dhe pastaj regjistroni përsëri shenjat e gishtave. Nëse harroni strukturën, PIN-in ose fjalëkalimin, nuk do të jeni në gjendje ta përdorni pajisjen nëse nuk e rivendosni. Samsung nuk është përgjegjës për çdo humbje të dhënash ose bezdi të shkaktuar nga kodet e zhbllokimit të harruar.
- Nëse ndryshoni metodën e kyçjes së ekranit në **Godit** ose **Asnjë**, të cilat nuk janë të sigurta, të gjitha të dhënat tuaja biometrike do të fshihen.

Për njohje më të mirë të shenjave të gishtave

Kur skanoni shenjat e gishtave tuaj në pajisje, jini në dijeni të kushteve të mëposhtme që mund të ndikojnë në performancën e pajisjes:

- Pajisja mund të mos i njohë shenjat e gishtave të rrudhosur ose me shenja.
- Pajisja mund të mos i njohë shenjat e gishtave nga gishtat e vegjël ose të hollë.
- Për të përmirësuar performancën e njohjes, regjistroni shenjat e gishtave që përdorni më shpesh për të kryer punë në pajisje.
- Butoni anësor ka një sensor për njohjen e shenjës së gishtit. Sigurohuni që sensori i njohjes së shenjës së gishtit të mos gërvishtet ose dëmtohet nga objektet metalike, si monedhat, çelësat dhe varëset.
- Mbulimi i sensorit të njohjes së shenjës së gishtit me aksesore, si ngjitëse, mund të ulë shpejtësinë e njohjes të shenjës së gishtit.

- Sigurohuni që sensori i njohjes së shenjës së gishtit dhe gishtat tuaja janë të pastër e të thatë.
- Nëse e përkulni gishtin ose përdorni majën e gishtit, pajisja mund të mos i njohë shenjat tuaj të gishtave. Sigurohuni që ta mbuloni të gjithë sensorin e njohjes të shenjës së gishtit me gishtin tuaj.
- Në ambiente të thata, në pajisje mund të grumbullohet elektricitet statik. Mos e përdorni këtë veçori në ambiente të thata ose para se ta përdorni veçorinë, shkarkoni elektricitetin statik duke prekur një objekt metalik.

Regjistrimi i shenjës së gishtave

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe privatësia → Bllokimi i ekranit & biometrika → Shenjat e gishtave** dhe ndiqni udhëzimet në ekran për të regjistruar gjurmën e gishtit. Pasi të keni bërë regjistrimin, mund të kontrolloni nëse shenja juaj e gishtit është regjistruar, si dhe emrin e saj, duke shtypur **Verifiko shenjat e shtuara**.

Zhbllokimi i ekranit me shenjat e gishtave

Mund ta zhbllokoni ekranin me shenjën e gishtit në vend se të përdorni një strukturë, PIN ose fjalëkalim.

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe privatësia → Bllokimi i ekranit & biometrika**.
- 2 Zhbllokojeni ekranin duke përdorur metodën e zhbllokimit të ekranit të caktuar më parë.
- 3 Shtypni **Shenjat e gishtave** dhe shtypni **Zhbllokim me sh. gishtash** për ta aktivizuar.
- 4 Në ekranin e kyçur, vendoseni gishtin mbi sensorin e njohjes së shenjës së gishtit dhe skanoni shenjën e gishtit tuaj.

Njohja e shenjave të gishtave me ekranin të fikur

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe privatësia → Bllokimi i ekranit & biometrika**.
- 2 Zhbllokojeni ekranin duke përdorur metodën e zhbllokimit të ekranit të caktuar më parë.
- 3 Shtypni **Shenjat e gishtave** dhe shtypni çelësin **Shenja e gishtit gjithnjë ndezur** për ta aktivizuar.

Fshirja e shenjave të gishtave të regjistruar

Mund t'i fshini shenjat e regjistruara të gishtave.

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe privatësia** → **Blokimi i ekranit & biometrika**.
- 2 Zhblokoheni ekranin duke përdorur metodën e zhblokimit të ekranit të caktuar më parë.
- 3 Shtypni **Shenjat e gishtave**, zgjidhni një shenjë gishti për ta fshirë, dhe më pas shtypni **Largo**.

Wi-Fi e sigurt

Secure Wi-Fi është një shërbim që e bën lidhjen e rrjetit Wi-Fi të sigurt. Enkripton të dhënat duke përdorur rrjetet Wi-Fi dhe çaktivizon aplikacionet dhe faqet e internetit gjurmuese në mënyrë që t'i përdorni rrjetet Wi-Fi në mënyrë të sigurt. Për shembull, kur përdorni një rrjet Wi-Fi jo të sigurt në vende publike, si në lokale ose aeroporte, Secure Wi-Fi aktivizohet automatikisht në mënyrë që askush të mos vjedhë informacionet e identifikimit tuaj ose të monitorojë aktivitetin tuaj në aplikacione dhe faqe interneti.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe privatësia** → **Cilësime të tjera të sigurisë** → **Wi-Fi e sigurt** dhe ndiqni udhëzimet në ekran për të përfunduar parametrizimin. Nëse shtypni **Aktiviteti mbrojtës**, mund të kontrolloni historinë se si dhe kur rrjeti juaj është mbrojtur me Wi-Fi të sigurt.

Kur Secure Wi-Fi është i aktivizuar, ikona e VPN (🔒) do të shfaqet në shiritin e statusit.



- Përdorimi i kësaj veçorie mund të shkaktojë rrjet Wi-Fi më të ngadaltë.
- Kjo veçori mund të mos jetë e disponueshme në varësi të rrjetit Wi-Fi, operatorit ose modelit.

Zgjedhja e aplikacioneve për të mbrojtur me Secure Wi-Fi

Zgjidhni aplikacionet për të mbrojtur me Secure Wi-Fi në mënyrë që t'i mbron të dhënat në mënyrë të sigurt, si për shembull fjalëkalimin ose aktivitetin tuaj në aplikacione, në mënyrë që të mos hapen nga të tjerët.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe privatësia** → **Cilësime të tjera të sigurisë** → **Wi-Fi e sigurt** → ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Cilësimet** → **App-et e mbrojtura** dhe shtypni çelësat pas aplikacioneve që doni të mbron duke përdorur Secure Wi-Fi.



- Disa aplikacione mund të mos e mbështetin këtë veçori.

Blerja e planit të mbrojtjes

Ju ofrohet një plan mbrojtjeje falas për rrjetet Wi-Fi çdo muaj. Mund të blini gjithashtu plane mbrojtjeje me pagesë dhe të keni mbrojtje të pakufizuar të bandwidth-it për një kohë të kufizuar.

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe privatësia** → **Cilësime të tjera të sigurisë** → **Wi-Fi e sigurt**.
- 2 Shtypni **Plani i mbrojtjes** → **Grado** dhe zgjidhni planin që doni.
-  Për disa plane të caktuara mbrojtjeje, mund ta transferoni planin e mbrojtjes te një pajisje tjetër, në të cilën keni hyrë me llogarinë tuaj Samsung.
- 3 Ndiqni udhëzimet në ekran për të përfunduar blerjen.

Dosja e sigurt

Folderi i sigurt mbron materialet dhe aplikacionet tuaja private si fotot dhe kontaktet që të mos hapen nga të tjerë. Mund t'i mbani materialet dhe aplikacionet tuaja private të sigurta edhe kur pajisja është e hapur.

-  Folderi i sigurt është një vend magazinimi i veçantë, i sigurt. Të dhënat në folderin e sigurt nuk mund të transferohen në pajisje të tjera përmes metodave të paaprovuara të ndarjes, si USB ose Wi-Fi Direct. Përpjekja për të personalizuar sistemin operativ ose modifikimin e softuerëve do të bëjë që folderi i sigurt të bllokohet automatikisht dhe të bëhet i pahapshëm. Para se të ruani të dhënat në folderin e sigurt, sigurohuni që të arkivoni një kopje të të dhënave në një vend tjetër të sigurt.

Konfigurimi i folderit të sigurt

- 1 Hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Siguria dhe privatësia** → **Cilësime të tjera të sigurisë** → **Dosja e sigurt**.

2 Ndiqni udhëzimet në ekran për të përfunduar parametrizimin.

Kur shfaqet një dritare që ju kërkon nëse doni të rivendosni apo jo llojin e kyçjes së Folderit të sigurt me llogarinë tuaj Samsung, shtypni **Lejo**. Nëse keni harruar llojin e kyçjes, mund ta rivendosni duke përdorur llogarinë tuaj Samsung. Nëse nuk e aktivizoni këtë veçori, nuk mund ta rivendosni llojin e kyçjes kur e keni harruar.

Kur konfigurimi të ketë përfunduar, do të shfaqet ekran i Dosjes së sigurt dhe ikona e Dosjes së sigurt (🔒) do të shtohet tek ekran i aplikacioneve.



- Kur aplikacioni **Dosja e sigurt** është i kyçur, duhet ta hapni duke përdorur metodën e caktuar për hapjen.
- Për të ndryshuar emrin ose ikonën e folderit të sigurt, shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Personalizo**.

Vendosja e një kushti të kyçjes automatike për folderin e sigurt

1 Hapni aplikacionin **Dosja e sigurt** dhe shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Cilësimet** → **Bllokoje auto Dosjen e sigurt**.

2 Zgjidhni një opsion kyçjeje.



Për të kyçur manualisht folderin e sigurt, shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Kyç dhe dil**.

Lëvizja e materialeve në folderin e sigurt

Lëvizni materiale, të tilla si foto dhe video, në folderin e sigurt. Veprimet e mëposhtme janë një shembull i lëvizjes së një imazhi nga magazina standarde në folderin e sigurt.

1 Hapni aplikacionin **Dosja e sigurt** dhe më pas shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Shto skedarë**.

2 Shtypni **Imazhe**, shënoni figurat që doni të lëvizni dhe pastaj shtypni **U krye**.

3 Shtypni **Zhvendos**.

Artikujt e zgjedhur do të fshihen nga folderi origjinal dhe do të çohen në folderin e sigurt. Për t'i kopjuar artikujt, shtypni **Kopjo**.



Metoda për lëvizjen e materialeve mund të ndryshojë në varësi të llojit të materialit.

Lëvizja e materialeve nga folderi i sigurt

Lëvizni materiale nga folderi i sigurt në aplikacionin përkatës në magazinën standarde. Veprimet e mëposhtme janë një shembull i lëvizjes së një imazhi nga folderi i sigurt në magazinën standarde.

- 1 Hapni aplikacionin **Dosja e sigurt** dhe shtypni **Galeria**.
- 2 Zgjidhni një imazh dhe shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Nxirr nga Dosja e sigurt**. Gjërat e zgjedhura do të lëvizen në **Galeria** në magazinën standarde.

Shtimi i aplikacioneve

Shtoni një aplikacion në folderin e sigurt.

- 1 Hapni aplikacionin **Dosja e sigurt** dhe shtypni ikonën e shtimit të aplikacioneve (+).
- 2 Shënoni një ose më shumë aplikacione të instaluar në pajisje dhe shtypni **Shto**.

Heqja e aplikacioneve nga folderi i sigurt

Prekni dhe mbani prekur një aplikacion për ta fshirë, dhe shtypni **Çinstalo**.

Shtimi i llogarive

Shtoni llogaritë tuaja Samsung dhe Google, ose llogaritë e tjera që të sinkronizohen me aplikacionet në folderin e sigurt.

- 1 Hapni aplikacionin **Dosja e sigurt** dhe shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Cilësimet** → **Menaxho llogaritë** → **Shto llogari**.
- 2 Zgjidhni një shërbim llogarie.
- 3 Ndiqni udhëzimet në ekran për të përfunduar konfigurimin e llogarisë.

Fshehja e folderit të sigurt

Mund ta fshihni shkurtoren e folderit të sigurt nga ekrani i aplikacioneve.

Hapni aplikacionin **Dosja e sigurt**, shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Cilësimet**, dhe më pas shtypni çelësin **Shtoje Dosja e sigurt tek ekrani App-et** për ta çaktivizuar.

Nëse doni të shfaqni përsëri Folderin e sigurt, hapni **Cilësimet**, shtypni **Siguria dhe privatësia** → **Cilësime të tjera të sigurisë** → **Dosja e sigurt**, hapni ekranin duke përdorur metodën e konfiguruar paraprakisht të kyçjes së ekranit, dhe më pas shtypni çelësin **Shtoje Dosja e sigurt tek ekrani App-et** për ta aktivizuar.

Çinstalimi i folderit të sigurt

Mund ta çinstaloni Folderin e sigurt, përfshirë materialet dhe aplikacionet në të.

Hapni aplikacionin **Dosja e sigurt** dhe më pas shtypni ikonën e më shumë opsioneve (⋮) → **Cilësimet** → **Cilësime të tjera** → **Çinstalo**.

Për të magazinuar materiale para se të çinstaloni folderin e sigurt, shënoni **Nxirri skedarët media nga Dosja e sigurt** dhe shtypni **Çinstalo**. Për të hapur të dhënat e arkivuara nga folderi i sigurt, hapni aplikacionin **Skedarët e Mi** dhe shtypni **Magazina e brendshme** → **Download** → **Secure Folder**.



Shënimet e ruajtura në **Samsung Notes** nuk do të arkivohen.

Samsung Pass

Verifikoni identitetin tuaj me Samsung Pass kur përdorni shërbimet që kërkojnë identifikimin ose informacionet tuaja personale.

Regjistrimi i Samsung Pass

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe privatësia** → **Cilësime të tjera të sigurisë** → **Fjalëkalimet, kyçkalimet dhe vetë-plotësimi** → **Samsung Pass**. Ndiqni udhëzimet në ekran për të përfunduar parametrizimin.

Ruajtja e informacioneve tuaja në Samsung Pass

Kur ruani informacionet e identifikimit në aplikacione ose në faqe interneti ose informacionet personale në Samsung Pass, mund t'i vendosni informacionet automatikisht.



Mund t'i ruani informacionet tuaja manualisht ose mund të kontrolloni dhe të menaxhoni informacionet e ruajtura në Samsung Pass.

Ruajtja e informacioneve të identifikimit

Në faqen e identifikimit të aplikacionit ose të faqes së internetit, vendosni ID-në dhe fjalëkalimin tuaj, dhe më pas shtypni butonin e identifikimit. Kur shfaqet një dritare kërcyese që ju kërkon nëse doni të ruani informacionet e identifikimit, shtypni **Ruaj**.

Ruajtja e informacioneve tuaja personale

Në ekranin kryesor të Samsung Pass, zgjidhni një opsion nën **Informacion privat**, vendosni informacionin, dhe më pas shtypni **Ruaj**.

Vendosja automatikisht e informacionit tuaj

Mund të vendosni automatikisht informacionet e identifikimit ose informacionet personale, si adresën ose informacionet e kartës së pagesave, të ruajtura në Samsung Pass.



- Kjo veçori mund të mos jetë e disponueshme në disa aplikacione ose faqe interneti.
- Veçoria e mbushjes automatike është e disponueshme vetëm për faqet e internetit që aksesoni nëpërmjet aplikacionit **Interneti Samsung**.

Hyrja duke përdorur çelës aksesit

Në aplikacionet ose faqet e internetit që mbështetin identifikimin me çelës aksesit, mund të identifikoheni me një çelës aksesit të ruajtur në Samsung Pass në vend se të përdorni informacionin e identifikimit.

- 1 Tek aplikacioni ose faqja e internetit që po përdorni, krijoni një çelës aksesit.
Metoda për krijimin e një çelësi aksesit mund të ndryshojë në varësi të aplikacionit ose faqes së internetit.
- 2 Kur shfaqet një dritare kërcyese që pyet nëse dëshironi të ruani kodin e kalimit, zgjidhni Samsung Pass dhe ndiqni udhëzimet në ekran për të ruajtur kodin e kalimit.
Tani mund të hyni me kodin e aksesit të ruajtur në Samsung Pass.

Vendi

Ndryshoni cilësimet për lejet e informacioneve të vendndodhjes.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Vendi**.

- **Lejet e app-it:** Shikoni listën e aplikacioneve që kanë leje për të parë vendndodhjen e pajisjes dhe për të modifikuar cilësimet e lejeve.
- **Shërbimet e vendndodhjes:** Vendosni që pajisja të përdorë veçorinë Wi-Fi ose Bluetooth për të rritur saktësinë e informacionit të vendndodhjes suaj, edhe kur veçoritë janë të çaktivizuara. Gjithashtu mund të shikoni shërbimet e vendndodhjes që po përdor pajisja juaj.
- **Aksesi së fundi:** Shikoni cilat aplikacione kanë kërkuar informacionet e vendndodhjes suaj aktuale të fundit.

Siguria dhe urgjencat

Menaxhoni informacionet tuaja mjekësore dhe kontaktet e emergjencës. Gjithashtu mund të ndryshoni cilësimet për veçoritë e emergjencës, si lajmërimet e emergjencave nëpërmjet lidhjes me valë.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Siguria dhe urgjencat**.

- **Informacion mjekësor:** Vendosni informacionet tuaja mjekësore.
- **Kontaktet e urgjencës:** Shtoni kontaktet tuaja të emergjencës.
- **SOS e urgjencës:** Bëni një telefonatë emergjence te numri i caktuar paraprakisht kur shtypni butonin Anësor disa herë siç specifikohet në ekranin e cilësimeve të kësaj veçorie.
- **Bashkëndarja në urgjenca:** Vendoseni pajisjen që të dërgojë informacion, si vendndodhjen tuaj ose njoftime për baterinë e ulët të pajisjes, te kontaktet e emergjencës për një periudhë kohe të caktuar.
- **Shërbimi i vendndodhjes për urgjenca:** Aktivizoni veçorinë e vendndodhjes së emergjencave (ELS).
- **Sinjalizime urgjencash në radio:** Ndryshoni cilësimet për lajmërimet e emergjencave nëpërmjet valëve.
- **Sinjalizimet për tërmetet:** Aktivizoni veçorinë e lajmërimit për tërmete.



Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të rajonit ose modelit.

Llogaritë dhe rezervimi

Opsionet

Sinkronizoni, arkivoni ose rivendosni të dhënat e pajisjes suaj duke përdorur Samsung Cloud. Gjithashtu mund të hyni në llogari, si për shembull në llogarinë tuaj Samsung ose llogarinë tuaj Google, ose të transferoni të dhëna nga pajisje të tjera ose drejt tyre me anë të Smart Switch.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Llogaritë dhe rezervimi**.

- **Menaxho llogaritë:** Shtoni llogaritë tuaja Samsung dhe Google, ose llogaritë e tjera me të cilat do të sinkronizoheni.
- **Përdoruesit:** Konfiguroni llogaritë e përdoruesve për persona të tjerë që ta përdorin pajisjen me cilësime të personalizuar, si p.sh. llogari emaili, preferenca për sfondet dhe shumë të tjera. Për më shumë informacion, shihni [Përdoruesit](#).
- **Samsung Cloud:** Arkivoni të dhënat dhe cilësimet tuaja, dhe rivendosni të dhënat dhe cilësimet e pajisjes së mëparshme edhe kur nuk e keni atë. Për më shumë informacion, shihni [Samsung Cloud](#).
- **Njësia Google:** Mbajini informacionet tuaja personale, të dhënat e aplikacioneve dhe cilësimet të sigurta në pajisjen tuaj. Mund t'i arkivoni informacionet tuaja sensitive. Duhet të hyni në llogarinë tuaj Google për të arkivuar të dhënat.
- **Smart Switch:** Hapni Smart Switch dhe transferoni të dhënat tuaja nga pajisja juaj e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni [Transferimi i të dhënave nga pajisja juaj e mëparshme \(Smart Switch\)](#).



Arkivoni rregullisht të dhënat tuaja në një vend të sigurt, si Samsung Cloud ose në një kompjuter, kështu mund t'i rivendosni nëse të dhënat dëmtohen ose humbasin për shkak të një rivendosjeje të padashur të të dhënave të fabrikës.

Përdoruesit

Konfiguroni llogaritë e përdoruesve për persona të tjerë që ta përdorin pajisjen me cilësime të personalizuar, si p.sh. llogari emaili, preferenca për sfondet dhe shumë të tjera.

Ofrohen llogaritë e mëposhtme për përdoruesi.

- **Zotëruesi:** Llogaria e zotëruesit krijohet vetëm kur pajisja konfigurohet për herë të parë dhe nuk krijohet dot më shumë se një. Kjo llogari ka kontroll të plotë të pajisjes, duke përfshirë dhe administrimin e llogarive të përdoruesve. Llogaritë e përdoruesve mund t'i shtosh apo fshish vetëm kur përdor këtë llogari.
- **Mysafir:** Një llogari vizitori mund të aksesojë pajisjen, por informacioni dhe të dhënat e përdorura gjatë seancës së vizitorit ruhen përkohësisht. Çdo herë që përdorni llogarinë, ju kërkohet nëse duhet të vijoni me seancën e mëparshme si vizitor apo me seancë të re.
- **Përdorues i ri:** Një llogari përdoruesi mund të aksesojë aplikacionet e veta dhe përmbajtjen, si edhe të personalizojë cilësimet e pajisjes që prekin të gjitha llogaritë.
- **Llogari e re e kufizuar:** Llogaria e kufizuar mund të hapë vetëm aplikacionet dhe përmbajtjen e lejuar nga llogaria e zotëruesit, dhe nuk përdor dot shërbime që kërkojnë identifikim. (Modelet Wi-Fi)

Shtimi i përdoruesve

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Llogaritë dhe rezervimi** → **Përdoruesit**.
- 2 Shtypni **Shto përdorues** / **Shto përdorues ose profil** dhe ndiqni udhëzimet në ekran për të konfiguruar një llogari përdoruesi.

Shtimi i profileve të kufizuara (modelet Wi-Fi)

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Llogaritë dhe rezervimi** → **Përdoruesit**.
- 2 Shtypni **Shto përdorues ose profil** → **Përdoruesi (pr. bllokuar)** dhe ndiqni udhëzimet në ekran për të konfiguruar një llogari përdoruesi.

Ndërrimi i përdoruesve

Shtypni ikonën e përdoruesit në krye të ekranit të kyçur dhe zgjidhni një llogari për të kaluar tek ajo.

Administrimi i përdoruesve

Kur përdorni llogarinë e zotëruesit, mund të fshini llogari ose të ndryshoni cilësimet e llogarisë.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Llogaritë dhe rezervimi** → **Përdoruesit**.

Për ta fshirë një llogari përdoruesi, shtypni llogarinë e përdoruesit që doni të fshini dhe shtypni **Fshij përdoruesin**.

Për t'i ndryshuar cilësimet e një llogarie, shtypni llogarinë e përdoruesit dhe ndryshoni cilësimet.

Samsung Cloud

Arkivoni të dhënat e pajisjes suaj në Samsung Cloud dhe t'i rivendosni ato më vonë.

Arkivimi i të dhënave

Mund të arkivoni të dhënat e pajisjes suaj në Samsung Cloud.

1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Llogaritë dhe rezervimi** dhe shtypni **Rezervo të dhëna** nën **Samsung Cloud**.

2 Shtypni çelësat pas artikujve që doni të arkivoni dhe pastaj shtypni **Rezervo tani**.

3 Shtypni **Kryer**.



- Disa të dhëna nuk do të magazinohen. Për të kontrolluar se cilat të dhëna do të arkivohen, në ekranin e cilësimeve, shtypni **Llogaritë dhe rezervimi** dhe shtypni **Rezervo të dhëna** nën **Samsung Cloud**.
- Për të parë të dhënat e arkivimit për pajisje të tjera në Samsung Cloud tuaj, në ekranin e cilësimeve, shtypni **Llogaritë dhe rezervimi** → **Restauro të dhënat**, dhe më pas zgjidhni një pajisje që doni.

Rivendosja e të dhënave

Mund t'i rivendosni të dhënat e arkivimit tuaj nga Samsung Cloud në pajisjen tuaj.

1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Llogaritë dhe rezervimi**.

2 Shtypni **Restauro të dhënat** dhe zgjidhni një pajisje që doni.

3 Shënoni gjërat që doni t'i rivendosni dhe shtypni **Rivendos**.

Google

Konfiguroni cilësimet për disa veçori të mundësuar nga Google.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Google**.

Funksionalitete të avancuara

Opsionet

Aktivizoni veçoritë e avancuara dhe ndryshoni cilësimet që i kontrollojnë ato.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Funksionalitete të avancuara**.

- **Funksionalitete inteligjente:** Përdorni veçoritë AI për t'ju ndihmuar ta përdorni pajisjen.
- **Bixby:** Bixby është një ndërfaqe përdoruesi që ju ndihmon ta përdorni pajisjen më lehtë. Për më shumë informacion, shikoni [Bixby](#).
- **Labs:** Përdorni veçori të reja të pajisjes.
- **S Pen:** Ndryshoni cilësimet për përdorimin e Lapsi S. Shihni [S Pen](#) për më shumë informacion.
- **Butoni Anësor:** Zgjidhni një aplikacion ose veçori për ta hapur duke përdorur butonin anësor. Për më shumë informacion, shihni [Caktimi i butonit anësor](#).
- **Multi-Window:** Caktoni mënyrën e hapjes së veçorisë Multi-Window. Gjithashtu mund të konfiguroni cilësimet për Multi window. Për më shumë informacion, shihni [Multi window](#).
- **Lëvizjet dhe gjestet:** Aktivizoni veçorinë e lëvizjeve dhe konfiguroni cilësimet. Për më shumë informacion, shikoni [Lëvizjet dhe gjestet](#).
- **Pamjet e çastit dhe regjistrimet e ekranit:** Ndryshoni cilësimet për fotot e ekranit dhe regjistruesin e ekranit.
- **Paneli ditor:** Caktojeni pajisjen që të shfaqë një fotoseri me veçoritë e zgjedhura ndërkohë që karikohet. Për më shumë informacion, shihni [Paneli ditor](#).
- **Aksesorët:** Ndryshoni cilësimet e aksesoreve.
- **Efektet video:** Vendosni të përdorni efekte të ndryshme, si për shembull ndryshimin e sfondit ndërsa përdorni kamerën në aplikacione të caktuara. Për më shumë informacion, shihni [Efektet video](#).



Kjo veçori është e disponueshme në disa aplikacione.

- **Cilësimet e Game Booster:** Konfiguroni cilësimet për Game Booster.
- **Avatari Galaxy:** Krijoni avatare në çfarëdo mënyre që doni dhe argëtohuni duke i përdorur në veçoritë e ndryshme. Për më shumë informacion, shikoni [Avatari Galaxy](#).
- **Lajmëtari Dual:** Instaloni aplikacionin e dytë për të përdorur dy llogari të veçanta për të njëjtin aplikacion mesazhesh. Për më shumë informacion, shihni [Lajmëtari Dual](#).



Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të rrjetit ose modelit.

Lëvizjet dhe gjestet

Aktivizoni veçorinë e lëvizjeve dhe konfiguroni cilësimet.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **Lëvizjet dhe gjestet**.

- **Dy-trokit për ta ndezur ekranin:** Caktojeni pajisjen që të ndezë ekranin duke shtypur dy herë në një vend çfarëdo në ekran ndërsa ekrani është fikur.
- **Dy-trokit për ta fikur ekranin:** Vendoseni pajisjen që të fikë ekranin duke shtypur dy herë një pjesë bosh në ekranin fillestar ose në ekranin e kyçur.
- **Mbulo ekranin për të heshtuar:** Vendoseni pajisjen që të heshtë disa tinguj të caktuar duke përdorur lëvizje ose gjeeste.
- **Rrëshqit me pëllëmbë për të kapur:** Vendoseni pajisjen që të kapë një foto ekrani kur rrëshqitni dorën majtas ose djathtas në ekran. Mund t'i shikoni imazhet e kapura në **Galeria**. Nuk është e mundur të bëni një foto ekrani ndërkohë që po përdorni disa aplikacione dhe veçori.



Dridhjet e tepërta ose një goditje në pajisje mund të shkaktojë një komandë të padashur për disa veçori duke përdorur sensorët.

Efektet video

Mund të përdorni veçori të ndryshme, si për shembull ndryshimin e sfondit ndërsa përdorni kamerën në aplikacione të caktuara.

Ndërsa përdorni kamerën në aplikacione që mbështetin këtë veçori, hapni panelin e cilësimeve të shpejta dhe shtypni **Efektet video**.

-  : Rivendosni cilësimet.
-  : Zgjidhni ose shtoni ngjyra sfondi ose imazhe për t'i përdorur.
- **Sfondi**: Ndryshoni ose turbulloni sfondin.
- **Fytyrë**: Aplikoni efekte bukurie në fytyrë.
- **Tonaliteti i ngjyrës**: Rregulloni tonin e ngjyrave dhe ndriçimin e ekranit.



- Disa veçori mund të mos jenë të disponueshme në varësi të modelit.
- Disa veçori janë të disponueshme vetëm kur përdorni kamerën përpara.

Avatari Galaxy

Krijoni avatare në çfarëdo mënyre që doni dhe argëtohuni duke i përdorur në veçoritë e ndryshme.

Në ekranin e cilësimeve shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **Avatari Galaxy**. Nëse keni shtuar ikonën e aplikacionit tek ekrani i aplikacioneve, hapni aplikacionin **Avatari Galaxy**.

Krijimi i një avatari Galaxy

Hapni avatarin Galaxy, shtypni ikonën e krijimit () dhe ndiqni udhëzimet në ekran për të krijuar një avatar.

Përdorimi i ngjitëseve të avatari Galaxy

Kur krijoni avatare, ngjitëset me shprehje dhe veprime avatari do të krijohen automatikisht. Mund t'i përdorni ngjitëset e avatari tuaj kur dërgoni mesazhe ose në një rrjet social.

Hapni avatarin Galaxy dhe shtypni **Adezivë Avatar**. Për të krijuar ngjitëset tuaja, shtypni ikonën e krijimit të ngjitëseve të personalizuar () në krye të listës së ngjitëseve.

Përdorimi i kamerës së avatarit Galaxy

Krijoni figura ose video argëtuese me avatare duke përdorur modalitetet e ndryshme të regjistrimit. Hapni avatarin Galaxy dhe shtypni **Kamera Avatar**. Zgjidhni avatarin dhe modalitetin që doni të përdorni, më pas bëni një fotografi ose regjistroni një video.

Lajmëtari Dual

Instaloni aplikacionin e dytë për të përdorur dy llogari të veçanta për të njëjtin aplikacion mesazhesh.

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **Lajmëtari Dual**.

Do të shfaqen aplikacionet e mbështetura.

- 2 Shtypni çelësin e një aplikacioni për të instaluar aplikacionin e dytë.

Do të instalohet aplikacioni i dytë. Ikona e aplikacionit të dytë do të shfaqet me ikonën e aplikacionit të dytë (🗨️).



- Veçoria e mesazhierit të dyfishtë mund të mos jetë e disponueshme në varësi të aplikacionit.
- Disa veçori të aplikacionit mund të jenë të kufizuara për aplikacionin e dytë.

Çinstalimi i një aplikacioni të dytë

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Funksionalitete të avancuara** → **Lajmëtari Dual**.

- 2 Shtypni çelësin e aplikacionit që doni të çinstaloni dhe shtypni **Çinstalo**.

Të gjitha të dhënat në lidhje me aplikacionin e dytë do të fshihen.



Nëse e çinstaloni aplikacionin e parë, aplikacioni i dytë do të fshihet gjithashtu.

Mirëqenia Dixhitale dhe kontrollet prindërore

Shikoni historinë e përdorimit të pajisjes dhe përdorni veçoritë për të mos lejuar që pajisja të pengojë jetën tuaj. Gjithashtu mund të konfiguroni kontrolle prindërore për fëmijët tuaj dhe të mbikëqyrni përdorimin e tyre dixhital.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Mirëqenia Dixhitale dhe kontrollet prindërore**.

- **Kategoritë më të përdorura të app-eve:** Kontrolloni listën e kategorive të aplikacioneve më të përdorura për një ditë.
- **Synimi për kohën në ekran:** Vendosni synime në lidhje me sa kohë në ditë doni ta përdorni pajisjen.
- **Kohëmatësit e app-eve:** Kufizoni kohën e përdorimit ditë për çdo aplikacion duke vendosur një kohëmatës. Kur arrini limitin, aplikacioni do të çaktivizohet dhe ju nuk mundeni ta përdorni.
- **Monitori i drejtimit:** Aktivizoni monitorin e drejtimit për të monitoruar sasinë e kohës që e përdorni pajisjen ndërsa drejtoni automjetin.
- **Monitori i ecjes:** Aktivizoni monitorin e ecjes për të monitoruar sasinë e kohës që e përdorni pajisjen ndërsa ecni.
- **Monitori i volumit:** Aktivizoni monitorin e volumit për të mbrojtur dëgjimin tuaj.
- **Kontrollet Prindërore:** Menaxhoni përvojën dixhitale të fëmijëve.

Kujdesi për pajisjen

Kujdesi për pajisjen jep një përmbledhje të statusit të baterisë, magazinës, memories virtuale, dhe sigurisë të sistemit të pajisjes suaj. Gjithashtu mund ta optimizoni pajisjen.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Kujdesi për pajisjen**.

- **Optimizo tani:** Mbyllni aplikacionet e hapura në sfond ose ato që përdorin një sasi jonormale baterie dhe skanoni për aplikacione që përplasen ose malware për ta optimizuar pajisjen.
- **Bateria:** Kontrolloni energjinë e mbetur të baterisë dhe kohën për ta përdorur pajisjen. Për pajisjet me nivele të ulëta të baterisë, kurseni baterinë duke aktivizuar veçoritë e kursimit të energjisë. Për më shumë informacion, shihni [Bateria](#).

- **Magazinë:** Kontrolloni statusin e magazinës së përdorur dhe asaj të disponueshme duke fshirë skedarët e panevojshëm, si skedarët në koshin e plehrave, skedarët e papërdorur ose skedarët e dyfishtë, pasi t'i keni kontrolluar.
- 
 - Kapaciteti aktual i disponueshëm i magazinës së brendshme është më pak se kapaciteti i përcaktuar, pasi sistemi operativ dhe aplikacionet e paravendosura zënë një pjesë të magazinës. Kapaciteti i disponueshëm mund të ndryshojë kur e përditësoni pajisjen.
 - Mund të shikoni kapacitetin e disponueshëm të magazinës së brendshme në pjesën Specifikimet për pajisjen tuaj në faqen e internetit të Samsung.
- **Memoria:** Kontrolloni përdorimin e memories ose shtypni **Pastro** për të liruar memorie duke ndaluar aplikacionet në sfond.
- **Mbrojtja e app-eve:** Skanoni pajisjen për malware dhe aktivitete të tjera të dyshimta, që të jeni të mbrojtur.
- **Optimizimi automatik:** Kryeni optimizimin automatik duke mbyllur aplikacionet në sfond ose duke pastruar memorien në mënyrë që pajisja të punojë në gjendjen e saj më të mirë.
Shtypni **Rinisje auto** për ta bërë pajisjen të rindizet automatikisht kur dallohen probleme me performancën, ose në një orar që e caktoni ju.
- **Përditësimi i softuerit:** Përditësoni softuerin e pajisjes përmes shërbimit firmware over-the-air (FOTA). Gjithashtu mund të programoni përditësime softueri.
- **Diagnostikimi:** Testojeni pajisjen duke përdorur Samsung Members.
- **Regjimi Mirëmbajtje:** Aktivizoni modalitetin e mirëmbajtjes për të mbrojtur privatësinë tuaj kur dikush tjetër përdor pajisjen tuaj, si për shembull kur e dërgoni për riparime.

App-et

Menaxhoni aplikacionet e pajisjes dhe ndryshoni cilësimet e tyre. Mund të shikoni informacionet e përdorimit të aplikacioneve, të ndryshoni cilësimet e njoftimeve ose lejeve të tyre, ose të çinstaloni ose çaktivizoni aplikacionet e panevojshme.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **App-et**.

Menaxhimi i përgjithshëm

Personalizoni cilësimet e sistemit të pajisjes suaj ose rivendoseni pajisjen.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Menaxhimi i përgjithshëm**.

- **Gjuha:** Zgjidhni gjuhët e pajisjes. Për më shumë informacion, shihni [Shtimi i gjuhëve të pajisjes](#).
- **Gjuhët e app-eve:** Zgjidhni gjuhën që doni të përdorni për secilin aplikacion.
- **Futja e zërit:** Shkarkoni paketa gjuhësh për të përdorur veçorinë e hyrjes së zërit offline.
- **Data dhe ora:** Hapni dhe ndryshoni cilësimet për të kontrolluar mënyrën se si pajisja shfaq orën dhe datën.



Nëse bateria është plotësisht e shkarkuar, ora dhe data rivendosen.

- **Cilësimet e Tastierës Samsung:** Ndryshoni cilësimet për tastierën Samsung.
- **Tastierat dhe parazgjedhja:** Zgjidhni një tastierë për ta përdorur si standard dhe ndryshoni cilësimet e tastierës.
- **Tastiera fizike:** Ndryshoni cilësimet për një tastierë të jashtme.
- **Miu dhe fusha me prekje:** Ndryshoni cilësimet për një maus ose trekpas të jashtëm.
- **Reseto:** Rivendosni cilësimet e pajisjes suaj ose bëni një rivendosje të të dhënave të fabrikës.
- **Na kontakto:** Bëni pyetje ose shikoni pyetjet e bëra shpesh.

Shtimi i gjuhëve të pajisjes

Mund të shtoni gjuhët për t'i përdorur në pajisjen tuaj.

- 1 Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Menaxhimi i përgjithshëm** → **Gjuha** → **Shto gjuhë**.
- 2 Zgjidhni një gjuhë për ta shtuar.
- 3 Për ta vendosur gjuhën e zgjedhur si gjuhë standarde, shtypni **Si parazgjedhje**. Për të mbajtur cilësimin aktual të gjuhës, shtypni **Mbaj këtë**.
Gjuha e zgjedhur do të shtohet në listën e gjuhëve tuaja. Nëse e ndryshuat gjuhën standarde, gjuha e zgjedhur do të shtohet në krye të listës.

Për të ndryshuar gjuhën standarde nga lista e gjuhëve, zgjidhni gjuhën që doni dhe shtypni **Zbato**. Nëse një aplikacion nuk mbështet gjuhën standarde, do të përdoret gjuha tjetër e mbështetur në listë.

Mundësi hyrje

Konfiguroni cilësimet të ndryshme për të përmirësuar aksesibilitetin në pajisje.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Mundësi hyrje**.

- **Rekomanduar për ty:** Kontrolloni veçoritë e aksesibilitetit që po përdorni aktualisht dhe më pas kontrolloni veçoritë e tjera të rekomanduara.
- **Fuqizimet e shikimit:** Personalizoni cilësimet për të përmirësuar asistencën për përdoruesit me vështirësi shikimi.
- **TalkBack:** Aktivizoni TalkBack, e cila ofron reagim me zë. Për të parë informacione ndihmëse se si ta përdorni këtë veçori, prekni **Cilësimet** → **Udhëzuesi i TalkBack**.
- **Përmirësime të dëgjimit:** Personalizoni cilësimet për të përmirësuar asistencën për përdoruesit me vështirësi dëgjimi.
- **Ndërveprimi & shkathtësia:** Personalizoni cilësimet për të përmirësuar asistencën për përdoruesit me nivel të ulët shkathtësie të duarve.
- **Cilësime të avancuara:** Konfiguroni cilësimet për akses të drejtpërdrejtë dhe funksionet e njoftimit.
- **App-et e instaluara:** Shikoni shërbimet e aksesueshmërisë të instaluara në pajisje.
- **Rreth Aksesibilitetit:** Kontrolloni informacionet e aksesibilitetit.
- **Na kontakto:** Bëni pyetje ose shikoni pyetjet e bëra shpesh.

Përditësimi i softuerit

Përditësoni softuerin e pajisjes përmes shërbimit firmware over-the-air (FOTA). Gjithashtu mund të programoni përditësimet e softuerit.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Përditësimi i softuerit**.

- **Shkarko dhe instalo:** Kontrolloni dhe instaloni përditësimet manualisht.
- **Shkarkim automatik / Shkarko auto përmes Wi-Fi:** Caktoni pajisjen që të shkarkojë përditësimet automatikisht.
- **Përditësimi së fundi:** Shikoni informacione rreth përditësimit të fundit të softuerit.



Nëse dalin përditësimet emergjente të softuerit për sigurinë e pajisjes tuaj dhe për të bllokuar llojet e reja të kërcënimeve për sigurinë, ato do të instalohen automatikisht pa aprovimin tuaj.

Informacione të përditësimeve për sigurinë

Përditësimet për sigurinë ofrohen për të forcuar sigurinë e pajisjes suaj dhe për të mbrojtur informacionet tuaja personale. Për përditësimet e sigurisë për modelin tuaj, vizitoni security.samsungmobile.com.



Faqja e internetit mbështet vetëm disa gjuhë.

Rreth tabletës

Hapni informacionet e pajisjes suaj.

Në ekranin e cilësimeve, shtypni **Rreth tabletës**.

Për të ndryshuar emrin e pajisjes suaj, shtypni **Riemërto**.

- **Info për statusin:** Kontrolloni informacionet e pajisjeve të ndryshme, si p.sh. adresa MAC e Wi-Fi dhe numri i serisë.
- **Informacioni juridik:** Shikoni informacionet ligjore në lidhje me pajisjen, të tilla si informacionet e sigurisë dhe licenca e burimit të hapur.
- **Informacion për softuerin:** Shikoni informacionet e softuerit të pajisjes, të tilla si versioni i sistemit operativ dhe versioni i firmuerit.
- **Informacioni për baterinë:** Shikoni statusin dhe informacione të baterisë.



Mund të kontrolloni informacionin e mëposhtëm të baterisë këtu. Informacioni i disponueshëm mund të ndryshojë në varësi të rajonit ose ofruesit të shërbimit.

- Data e prodhimit të baterisë
- Data e përdorimit të parë
- Numri i cikleve të karikimit/shkarkimit të plotë (në bazë të kapacitetit nominal)
- Gjendja e përllogaritur e shëndetit

Njoftimet e përdorimit

Masa paraprake për përdorimin e pajisjes

Ju lutem lexoni këtë udhëzues kur ta përdorni pajisjen për të garantuar përdorim të sigurt dhe të përshtatshëm.

- Përshkrimet bazohen në cilësimet e fabrikës të pajisjes.
- Disa materiale mund të ndryshojnë nga pajisja juaj në varësi të rajonit, operatorit të shërbimit, specifikimeve të modelit ose softuerit të pajisjes.
- Pajisja mund të ketë nevojë për lidhje me Wi-Fi ose me një rrjet celular kur përdorni disa aplikacione ose veçori.
- Përmbajtja (përmbajtja e cilësisë të lartë) e cila kërkon përdorim të lartë të CPU-së dhe memories do të ndikojë në performancën e përgjithshme të pajisjes. Aplikacionet që lidhen me përmbajtjen mund të mos funksionojnë si duhet në varësi të të dhënave të pajisjes dhe ambientit në të cilin përdoret.
- Samsung nuk është përgjegjës për problemet e performancës që shkaktohen nga operatorët e tjerë përveç Samsung.
- Samsung nuk është përgjegjës për problemet e performancës ose papajtueshmërive të shkaktuara nga ndryshimet e cilësimeve të regjistrimit ose modifikimi i softuerit të sistemit operativ. Përpjekja për të personalizuar sistemin operativ mund të shkaktojë që pajisja ose aplikacionet e tjera të mos funksionojnë mirë.
- Softueri, burimet e zërit, figurat e sfondit, imazhet dhe mediat e tjera të dhëna me këtë pajisje janë të licencuara për përdorim të limituar. Nxjerrja dhe përdorimi i këtyre materialeve për qëllime komerciale ose për qëllime të tjera përbën shkelje të ligjeve për të drejtat e autorit. Përdoruesit janë plotësisht përgjegjës për përdorimin e jashtëligjshëm të medias.
- Mund të keni tarifim shtesë për shërbimet e të dhënave, si dërgimi i mesazheve, ngarkimet dhe shkarkimet, sinkronizimi automatik ose përdorimi i shërbimeve për vendndodhjen në varësi të planit tuaj tarifar. Për transferime të mëdha të të dhënave rekomandohet të përdoret veçoria Wi-Fi.
- Aplikacionet e parazgjedhura që vijnë së bashku me pajisjen janë subjekt ndryshimi ndaj përditësimeve dhe mund të mos mbështeten më pa njoftim paraprak.
- Modifikimi i sistemit operativ të pajisjes ose instalimi i softuerëve nga burime jozyrtare mund të shkaktojë keqfunksionime të pajisjes dhe dëmtim apo humbje të të dhënave. Këto veprime janë shkelje të marrëveshjes tuaj të licencës me Samsung dhe do të anulojnë garancinë.

- Mund ta shikoni ekranin qartë edhe nën dritën e fortë të diellit duke rregulluar automatikisht rrezin e kontrastit në bazë të ambientit përreth. Për shkak të natyrës së produktit, shfaqja e pamjeve të fiksuara për periudha të gjata mund të rezultojë në shfaqje të mëpasshme të figurave (djegie e ekranit) ose hijezim.
 - Rekomandohet që të mos përdorni pamje të fiksuara për kohë të gjatë në një pjesë të ekranit ose në të gjithë ekranin dhe duhet ta fikni ekranin kur nuk e përdorni pajisjen.
 - Mund të bëni që ekranin të fiket automatikisht kur nuk e përdorni. Hapni **Cilësimet**, shtypni **Ekran** → **Mbarim i kohës së ekranit**, dhe pastaj zgjidhni se sa doni që pajisja të presë para se të fiket ekranin.
 - Për të bërë që ekranin të rregullojë automatikisht ndriçimin e tij duke u bazuar në ambientin përreth, hapni **Cilësimet**, shtypni **Ekranin**, dhe pastaj shtypni çelësin **Ndriçimi përshtatës** për ta aktivizuar.
- Në varësi të rajonit ose të modelit, disa pajisje kërkojnë të marrin miratim nga Komisioni Federal i Komunikimit (FCC).

Nëse pajisja juaj është e miratuar nga FCC-ja, mund të shikoni FCC ID të pajisjes. Për të parë FCC ID, hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Rreth tabletës** → **Info për statusin**. Nëse pajisja juaj nuk e ka një FCC ID, kjo do të thotë se pajisja nuk është autorizuar për t'u shitur në SHBA ose në territoret e saj dhe mund të sillet në SHBA vetëm për përdorim personal.

- Bandwidth-i që mbështet nga pajisja mund të ndryshojë në varësi të rajonit ose operatorit.
- Rrjeti 5G mund të ndryshojë në varësi të modelit, shtetit, ofruesit të shërbimit dhe mjedisit të përdoruesit.
- Pajisja juaj përmban magnete. Mbajeni larg nga kartat e kreditit, pajisjet mjekësore të implantuara dhe pajisje të tjera që mund të ndikohen nga magnetet. Në rastin e pajisjeve mjekësore, mbajeni pajisjen më larg se 15 cm. Mos e përdorni më pajisjen nëse dyshoni për ndonjë interferencë me pajisjen tuaj mjekësore dhe konsultohuni me mjekun ose prodhuesin e pajisjes mjekësore.

Ikonat udhëzuese



Paralajmërim: Situata që mund t'ju shkaktojnë lëndim juve ose të tjerëve



Kujdes: Situata që mund t'i shkaktojnë dëme pajisjes tuaj ose pajisjeve të tjera



Njoftim: Shënime, këshilla përdorimi, ose informacione shtesë

Shënime për përmbajtjen e paketimit dhe aksesorët

Shikoni manualin e përdorimit për përmbajtjen e paketimit.

- Artikujt e dhënë bashkë me pajisjen dhe çdo aksesor tjetër mund të ndryshojë në varësi të rajonit ose operatorit.
- Artikujt e dhënë janë projektuar vetëm për këtë pajisje dhe mund të mos jenë të pajtueshëm me pajisje të tjera.
- Pamjet dhe specifikimet mund të ndryshohen pa njoftim paraprak.
- Mund të blini aksesore të tjerë nga shitësi juaj më i afërt i Samsung. Sigurohuni që ato të jenë të pajtueshme me pajisjen para se t'i blini.
- Rekomandohet përdorimi i karikuesve të miratuar nga Samsung. Përdorimi i aksesorëve të pamiratuar mund të shkaktojë probleme me performancën ose defekte, të cilat mund të mos mbulohen nga garancia.
- Disponueshmëria e të gjithë aksesorëve është subjekt ndryshimi në varësi të plotë nga kompanitë që i prodhojnë ato. Për më shumë informacione rreth aksesorëve të mundshëm, shikoni faqen e internetit të Samsung.
- Kufjet (USB Type-C) që mbështetin dalje dixhitale mund të përdoren me pajisjen. Megjithatë, pajisja mund të mos jetë e pajtueshme me kufje që përdorin metodë të ndryshme audioje ose që janë bërë nga një prodhues tjetër.
- Kablloja USB e përfshirë mbështet karikim deri në 3 A. Karikuesi nuk është i përfshirë. Për performancë optimale të karikimit, rekomandohet përdorimi i një karikuesi zyrtar 45 W Samsung dhe i një kablloje USB të pajtueshëm, të cilët shiten veçmas.
- Për arsye mjedisore, në këtë paketim nuk është përfshirë karikues. Kjo pajisje mund të ndizet me shumicën e karikuesve USB dhe me një kablo me spinë USB Type-C.

Ruajtja e rezistencës ndaj ujit dhe pluhurit

Pajisja është rezistente ndaj ujit dhe pluhurit, gjithashtu ajo përmbush standardet e mëposhtme.

- Certifikim IP68 për rezistencën ndaj ujit: Sipas kërkesave të standardit IEC 60529, është testuar në 15–35 °C, 86–106 kPa, 1,5 m ujë pa kripë për 30 minuta pa lëvizur.

Duhet të ndiqni udhëzimet për të ruajtur rezistencën ndaj ujit dhe pluhurit të pajisjes suaj.

- Mos e ekspozoni pajisjen ndaj ujit të pishinës ose ujit të detit.
- Nëse pajisja ekspozohet ndaj ujit të papastër ose lëngjeve të tjera, si për shembull ujë me detergjent, vaj, parfum, krem dielli, dezinfektues duarsh, produkte kimike, si kozmetikë, ose lëngje që përmbajnë alkool, pastrojeni pajisjen me pak ujë të pastër, fshijeni me leckë të butë e të pastër, dhe më pas thajeni mirë para se ta përdorni me qëllim që të ruani rezistencën ndaj ujit.
- Mos e ekspozoni pajisjen në ujë që lëviz me forcë. Rritja e papritur e presionit të ujit mund të tejkalojë nivelin e garantuar të rezistencës ndaj ujit.
- Në vende të tilla si, sauna ose dhoma me avull, performanca e rezistencës ndaj ujit mund të dëmtohet për shkak të ndryshimeve të papritura të temperaturës.
- Nëse pajisja pëson ndonjë goditje të jashtme ose dëmtohet, rezistenca ndaj ujit mund të bjerë.

Nëse pajisja ekspozohet ndaj ujit ose ndotësve, ndiqni udhëzimet:

- Fshijeni pajisjen me një leckë të butë e të pastër, më pas thajeni komplet.
- Nëse mikrofoni ose altoparlanti nuk është komplet i thatë, kjo mund të bëjë që tingulli të mos jetë i qartë gjatë një telefonate.
- Ekрани dhe veçoritë e tjera mund të mos punojnë mirë nëse pajisja përdoret në ujë.
- Mos e lidhni karikuesin ose asnjë aksesori tjetër derisa pajisja të jetë tharë komplet. Pajisja mund të dëmtohet nëse lidhet një aksesori ose karikues kur xheku multifunksional nuk është ende i thatë.

Rezistenca ndaj ujit dhe pluhurit e pajisjes Samsung Galaxy nuk është e përhershme dhe mund të dobësohet me kalimin e kohës për shkak të konsumimit të zakonshëm.

Situatat e mbinxehjes së pajisjes dhe zgjidhjet

Kur pajisja nxehet ndërsa është duke u karikuar bateria

Ndërsa karikohet, pajisja dhe karikuesi mund të nxehen. Gjatë karikimit me valë ose karikimit të shpejtë, pajisja mund të nxehet. Kjo nuk ndikon në jetëgjatësinë ose performancën e pajisjes dhe është brenda kufijve të punimit normal të pajisjes. Nëse bateria nxehet shumë, shpejtësia e karikimit mund të bjerë ose karikuesi mund të mos karikojë më.

Kur pajisja nxehet shumë, veproni si më poshtë:

- Shkëputeni karikuesin nga pajisja dhe mbyllni çdo aplikacion të hapur. Prisni që pajisja të ftohet dhe filloni ta karikoni përsëri.
- Nëse pjesa e poshtme e pajisjes nxehet tepër, arsyeja mund të jetë kablloja USB e dëmtuar. Ndërrojeni kabllon USB me një të ri. Rekomandohet përdorimi i një kabllaje USB të miratuar nga Samsung.
- Kur përdorni karikues me valë, mos vendosni materiale të huaja si objekte metalike, magnetë dhe karta me shirit magnetik midis pajisjes dhe karikuesit me valë.



Veçoria e karikimit me valë ose karikimit të shpejtë është e disponueshme vetëm në modelet e mbështetura.

Kur pajisja nxehet gjatë përdorimit

Kur përdorni veçori ose aplikacione që kërkojnë më shumë energji ose i përdorni për periudha të gjata, pajisja mund të nxehet përkohësisht për shkak të rritjes së konsumit të baterisë. Mbyllni çdo aplikacion të hapur dhe mos e përdorni pajisjen për njëfarë kohe.

Shikoni shembujt e mëposhtëm të situatave në të cilat pajisja mund të nxehet tepër.

- Gjatë konfigurimit fillestar pas blerjes ose kur rivendosni të dhënat.
- Kur shkarkoni skeda të mëdha

- Kur përdorni aplikacione që kërkojnë më shumë energji ose kur përdorni aplikacione për periudha të gjata
 - Kur luani lojëra me cilësi të lartë për periudha të gjata
 - Kur regjistroni video për periudha të gjata
 - Kur shikoni video streaming ndërsa përdorni ndriçimin maksimal
 - Kur lidheni me televizorin
- Kur bëni shumë detyra njëkohësisht (ose, kur hapni shumë aplikacione në sfond)
 - Kur përdorni Multi window
 - Kur përditësoni ose instaloni aplikacione ndërsa regjistroni video
 - Kur shkarkoni skeda të mëdha gjatë një telefonate video
 - Kur regjistroni video ndërsa përdorni një aplikacion navigimi
- Kur përdorni një sasi të madhe të dhënash për sinkronizim me cloud, email ose llogari të tjera
- Kur përdorni një aplikacion navigimi në makinë ndërsa pajisja është vendosur nën dritën direkte të diellit
- Kur përdorni hotspotin celular dhe veçorinë e lidhjes tethering
- Kur e përdorni pajisjen në vende me sinjale të dobëta ose nuk ka sinjal
- Kur karikoni baterinë me një kabëll USB të dëmtuar
- Kur xheku multifunksional i pajisjes është dëmtuar ose ekspozuar ndaj materialeve të huaja si lëngje, pluhur, metal dhe plumb lapsi
- Kur jeni në roaming

Kur pajisja nxehet shumë, veproni si më poshtë:

- Mbajeni pajisjen të përditësuar me softuerin më të fundit.
- Konfliktet midis aplikacioneve të hapura mund të bëjnë që pajisja të nxehet. Rindizeni pajisjen.
- Çaktivizoni veçoritë Wi-Fi, GPS dhe Bluetooth kur nuk i përdorni.
- Mbyllni aplikacionet që rritin konsumin e baterisë ose që punojnë në sfond kur nuk i përdorni.
- Fshini skedat ose aplikacionet e papërdorura.
- Ulni ndriçimin e ekranit.
- Nëse pajisja nxehet tepër ose është e nxehtë për kohë të gjatë, mos e përdorni për njëfarë kohe. Nëse pajisja vazhdon të nxehet tepër, kontaktoni një qendër shërbimit të Samsung ose një qendër shërbimi të autorizuar.

Masat paraprake kundër nxehjes së pajisjes

Nëse filloni të mos ndiheni rehat për shkak të nxehjes së pajisjes, mos e përdorni më pajisjen.

Kur pajisja nxehet, veçoritë dhe performanca mund të jenë të kufizuara ose pajisja mund të fiket për t'u ftohur. Kjo veçori është e disponueshme vetëm në modelet e mbështetura.

- Nëse pajisja nxehet tepër, ndriçimi i ekranit, shpejtësia e rifreskimit të ekranit dhe performanca do të kufizohen me qëllim që të ulët temperatura e pajisjes. Edhe nëse shfaqet ikona treguese e karikimit të baterisë, karikimi mund të jetë i ngadaltë. Kur karikimi ndalon për shkak të rritjes së papritur të temperaturës së pajisjes, ikona treguese e baterisë do të pulsojë.
- Nëse pajisja nxehet tepër dhe arrin njëfarë temperature, do të shfaqet një mesazh paralajmërues për të parandaluar dëmtimin e pajisjes, irritimin dhe dëmtimin e lëkurës, dhe rrjedhjet e baterisë. Aplikacionet e hapura do të mbyllën dhe të gjitha aplikacionet e veçoritë e tjera do të kufizohen, përveç telefonatave të emergjencave, derisa pajisja të ftohet.
- Nëse shfaqet mesazhi i dytë për shkak të një rritjeje të mëtejshme në temperaturën e pajisjes, pajisja do të fiket. Mos e përdorni pajisjen derisa temperatura e pajisjes të jetë brenda rrezes së rekomanduar të temperaturës për përdorimin. Nëse shfaqet një mesazh i dytë gjatë një telefonate emergjence, telefonata do të shkëputet për shkak të një mbylljeje të detyruar.



Rrezja e rekomanduar e temperaturës për përdorimin

Rrezja e rekomanduar e temperaturës për përdorimin e pajisjes është 0 °C deri në 35 °C.

Përdorimi i pajisjes jashtë rrezes së rekomanduar të temperaturës mund ta dëmtojë pajisjen ose mund të ulë jetëgjatësinë e baterisë.

Masat paraprake për ambientin

Pajisja juaj mund të nxehet për shkak të ambientit në kushtet e mëposhtme. Bëni kujdes për të shmangur uljen e jetëgjatësisë së baterisë, dëmtimin e pajisjes ose shkaktimin e zjarrit.

- Mos e mbani pajisjen në temperatura shumë të ftohta ose shumë të nxehta.
- Mos e ekspozoni pajisjen nën dritën direkte të diellit për periudha të gjata.
- Mos e përdorni ose mbani pajisjen për periudha të gjata në vende shumë të nxehta, si për shembull brenda makinës në verë.
- Mos e mbani pajisjen në vende ku mund të nxehet tepër, si për shembull mbi një tapet me ngrohje elektrike.
- Mos e ruani pajisjen tuaj pranë ose në ngrohës, mikrovalë, pajisje gatimi me nxehtësi ose enë me presion.
- Mos e përdorni kablllo që është zhveshur ose është dëmtuar, dhe as mos përdorni karikues ose bateri që është dëmtuar ose nuk funksionon mirë.

Si të gjeni informacionin për konsumin e energjisë në gjendje joaktive për këtë produkt

- Hyni në www.samsung.com/global/ecodesign_energy.
- Kërkoni duke përdorur numrin e modelit të produktit.



Kjo veçori mund të mos jetë e disponueshme në varësi të rajonit, operatorit ose modelit.

Shtojcë

Zgjidhja e problemeve

Para se të kontaktoni një qendër shërbimi të Samsung ose një qendër shërbimi të autorizuar, provoni zgjidhjet e mëposhtme. Disa situata mund të mos zbatohen për pajisjen tuaj.

Gjithashtu mund të përdorni Samsung Members për të zgjidhur çfarëdo problemi që mund të hasni gjatë përdorimit të pajisjes.

Kur e ndizni pajisjen ose kur po e përdorni atë, ajo ju kërkon të formoni një prej kodeve të mëposhtme:

- Fjalëkalimi: Kur të jetë e aktivizuar veçoria e kyçjes të pajisjes, duhet të futni fjalëkalimin që keni caktuar për pajisjen.
- PIN: Kur përdorni pajisjen për herë të parë ose kur është e aktivizuar kërkesa për PIN, duhet të futni PIN-in e dhënë me kartën SIM ose USIM. Mund ta çaktivizoni këtë veçori duke përdorur menunë e Kyçjes të Kartës SIM.
- PUK: Karta juaj SIM ose USIM është e bllokuar, zakonisht si rezultat i futjes së kodit tuaj PIN shumë herë gabim. Duhet të vendosni kodin PUK që ju ka dhënë operatori.
- PIN2: Kur hapni një menu që kërkon PIN2, duhet të formoni PIN2 të dhënë me kartën SIM ose USIM. Për më shumë informacione, kontaktoni operatorin.

Pajisja juaj shfaq mesazhe gabimesh në rrjet ose shërbim

- Kur ndodheni në zona me sinjale të dobëta ose pak valë, mund të humbni sinjalin. Zhvendosuni në një zonë tjetër dhe provoni përsëri. Gjatë lëvizjeve, mund të shfaqen vazhdimisht mesazhe gabimi.
- Nuk mund të përdorni disa opsione pa një abonim. Për më shumë informacione, kontaktoni operatorin.

Pajisja juaj nuk ndizet

Kur bateria është e shkarkuar plotësisht, pajisja juaj nuk do të ndizet. Karikojeni plotësisht baterinë para se ta ndizni pajisjen.

Njohja e prekjeve punon ngadalë ose nuk punon siç duhet

- Njohja e prekjeve mund të mos punojë siç duhet në situatat e mëposhtme:
 - Nëse keni vendosur mbrojtës ekranit ose aksesore opsionale në ekran
 - Nëse mbani doreza, nëse nuk i keni duart të pastra kur prekni ekranin, ose nëse e shtypni ekranin me ndonjë objekt të mprehtë ose me majat e gishtave
 - Kur ka lagështi ose kur ekspozohet ndaj ujit
- Rindizeni pajisjen për të pastruar çdo problem të përkohshëm softueri.
- Sigurohuni që softueri i pajisjes tuaj të jetë përditësuar në versionin më të fundit.
- Nëse ekranin gërvishtet ose dëmtohet, shkoni te një qendër shërbimi të Samsung ose te një qendër shërbimi të autorizuar.

Pajisja juaj ngrin ose has një problem fatal

Provoni zgjidhjet e mëposhtme. Nëse problemi nuk zgjidhet përsëri, kontaktoni një qendër shërbimit të Samsung ose një qendër shërbimi të autorizuar.

Rindezja e pajisjes

Nëse pajisja juaj ngrin ose nuk përgjigjet, mund t'ju duhet të mbyllni aplikacionet ose ta fikni pajisjen dhe ta ndizni përsëri.

Rindezja me detyrim

Nëse pajisja juaj ka ngrirë dhe nuk përgjigjet, shtypni dhe mbani shtypur butonin anësor dhe butonin e uljes së volumit njëkohësisht për më shumë se 7 sekonda për ta rindezur.

Rivendosja e pajisjes

Nëse këto metoda nuk e zgjidhin problemin tuaj, bëni një rivendosje të të dhënave të fabrikës.

Hapni **Cilësimet** dhe shtypni **Menaxhimi i përgjithshëm** → **Reseto** → **Resetimi në parazgjedhjet** → **Reseto** → **Fshij të gjitha**. Para se të kryeni rivendosjen e të dhënave të fabrikës, mos harroni të krijoni kopje rezervë të të gjithë të dhënave të rëndësishme të ruajtura në pajisje.

Telefonatat nuk lidhen

- Sigurohuni që të përdorni rrjetin celular të duhur.
- Sigurohuni që të mos keni caktuar ndalimin e telefonatave për numrin që po telefononi.
- Sigurohuni që të mos keni caktuar ndalimin e telefonatave për numrin e telefonit në hyrje.

Të tjerët nuk mund t'ju dëgjojnë kur flisni në një telefonatë

- Sigurohuni që nuk po mbuloni mikrofonin e telefonit.
- Sigurohuni që mikrofoni të jetë afër me gojën tuaj.
- Nëse përdorni kufje, sigurohuni që të jenë lidhur mirë.

Jehona zëri gjatë një telefonate

Rregulloni volumin duke shtypur butonin e volumit ose lëvizni në një vend tjetër.

Një rrjet celular ose interneti shkëputet shpesh ose cilësia e zërit është e dobët

- Sigurohuni që nuk jeni duke bllokuar antenën e brendshme të pajisjes.
- Kur ndodheni në zona me sinjale të dobëta ose pak valë, mund të humbni sinjalin. Mund të keni probleme me lidhjen për shkak të problemeve me stacionin bazë të operatorit. Zhvendosuni në një zonë tjetër dhe provoni përsëri.
- Kur e përdorni pajisjen gjatë lëvizjes, shërbimet e rrjeteve me valë mund të çaktivizohen për shkak të problemeve me rrjetin e operatorit.

Bateria nuk karikohet mirë (Për karikuesit e aprovuar nga Samsung)

- Sigurohuni që karikuesi të jetë i lidhur mirë.
- Vizitoni një qendër shërbimit të Samsung dhe ose një qendër shërbimi të autorizuar dhe ndërroni baterinë. Merrni me vete karikuesin dhe kabllon USB që përdorni për shërbim më të mirë.

Bateria bie më shpejt se kur u ble në fillim

- Kur e ekspozoni pajisjen ose baterinë ndaj temperaturave shumë të ftohta ose të nxehta, karikimi i përdorshëm mund të bjerë.
- Konsumi i baterisë do të rritet kur përdorni disa veçori ose aplikacione të tilla si GPS, lojëra ose internet.
- Bateria është e konsumueshme dhe karikimi i përdorshëm do të shkurtohet me kalimin e kohës.

Shfaqen mesazhe gabimesh kur hapet kamera

Pajisja juaj duhet të ketë hapësirë magazinimi dhe bateri të mjaftueshme për të përdorur aplikacionin e kamerës. Nëse merrni mesazhe gabimesh kur hapni kamerën, provoni të mëposhtmet:

- Karikoni baterinë.
- Lironi hapësirë magazinimi duke i transferuar skedarët në një kompjuter ose duke i fshirë ata nga pajisja.
- Rindizeni pajisjen.

Nëse përsëri keni probleme me aplikacionin e kamerës edhe pasi keni provuar këto këshilla, kontaktoni një qendër shërbimi të Samsung ose një qendër shërbimi të autorizuar.

Cilësia e fotografisë është më e dobët se pamja

- Cilësia e fotografive tuaja mund të ndryshojë, në varësi të ambientit dhe teknikave të fotografisë që përdorni.
- Nëse bëni fotografi në vende të errëta, natën ose brenda, mund të ndodhë zhurmë imazhi ose imazhet mund të jenë pa fokus.

Mesazhe gabimi shfaqen kur hapni dosje multimediale

Nëse merrni mesazhe gabimi ose skedarët multimedialë nuk luhen kur i hapni në pajisjen tuaj, provoni të mëposhtmet:

- Lironi hapësirë magazinimi duke i transferuar skedarët në një kompjuter ose duke i fshirë ata nga pajisja.
- Sigurohuni që skedari i muzikës nuk është i mbrojtur nga Digital Rights Management (DRM). Nëse skedari është i mbrojtur nga DRM, sigurohuni që keni licencën e duhur ose çelësin për të luajtur skedarin.

- Sigurohuni që formatet e skedarëve të mbështeten nga pajisja. Nëse një format skedari nuk mbështetet, si për shembull DivX ose AC3, instaloni një aplikacion që e mbështet. Për të kontrolluar formatet e skedarëve që mbështet pajisja juaj, vizitoni faqen e internetit të Samsung.
- Pajisja juaj mbështet fotografi dhe video të kapura me pajisjen. Fotografitë dhe videot e kapura me pajisje të tjera mund të mos funksionojnë mirë.
- Pajisja juaj mbështet skedarë multimedialë që janë të autorizuar nga operatori juaj ose nga ofruesit e shërbimeve të tjera. Disa përmbajtje që qarkullojnë në internet, si tone të ziles, video ose figura sfondi, mund të mos funksionojnë mirë.

Bluetooth nuk punon mirë

Nëse nuk ndodhet një pajisje tjetër Bluetooth ose nëse ka probleme me lidhjen ose ka probleme performance, provoni të mëposhtmet:

- Sigurohuni që pajisja me të cilën doni të lidheni është gati për t'u skanuar ose për t'u lidhur.
- Sigurohuni që tableta dhe pajisjet e tjera Bluetooth janë brenda rrezes maksimale të Bluetooth (10 m).
- Në tabletën tuaj, hapni **Cilësimet**, prekni **Lidhjet** dhe më pas prekni çelësin **Bluetooth** për ta aktivizuar përsëri.
- Në tabletën tuaj, hapni **Cilësimet**, prekni **Menaxhimi i përgjithshëm** → **Reseto** → **Reseto cilësimet e Wi-Fi dhe Bluetooth** → **Ricilëso cilësimet** për të rivendosur cilësimet e rrjetit. Mund të humbisni informacione të regjistruara kur bëni rivendosjen.

Nëse këto sugjerime nuk e zgjidhin problemin, kontaktoni një qendër shërbimi të Samsung ose një qendër shërbimi të autorizuar.

Nuk bëhet lidhja kur e lidhni pajisjen me një kompjuter

- Sigurohuni që kablloja USB që po përdorni është i pajtueshëm me pajisjen tuaj.
- Sigurohuni që të keni të instaluar drejtuesin e duhur dhe të keni përditësuar kompjuterin.

Pajisja nuk mund të gjejë vendndodhjen tuaj

Sinjalet GPS mund të pengohen në disa vende, si për shembull brenda. Vendoseni pajisjen që të përdorë Wi-Fi ose një rrjet celular për të gjetur vendndodhjen tuaj në këto situata.

Të dhënat e ruajtura në pajisje kanë humbur

Gjithmonë krijoni kopje rezervë të të gjitha të dhënave të rëndësishme të ruajtura në pajisje. Përndryshe, nuk mund t'i rivendosni të dhënat nëse dëmtohen ose humbasin. Samsung nuk është përgjegjës për humbjen të dhënave të ruajtura në pajisje.

Një hapësirë e vogël duket rrotull pjesës të jashtme të kasës të pajisjes

- Kjo hapësirë është një veçori e nevojshme prodhimi dhe mund të ndodhin disa goditje ose dridhje të pjesëve brenda.
- Me kalimin e kohës, fërkimet midis pjesëve mund të bëjnë që kjo hapësirë të zgjerohet pak.

Nuk ka hapësirë të mjaftueshme në magazinën e pajisjes

Fshini të dhënat e panevojshme, të tilla si memorien cache, duke përdorur veçorinë e kujdesit për pajisjen ose fshini manualisht aplikacionet ose skedarët e papërdorur për të liruar hapësirën e magazinës.

Butoni Bazë nuk shfaqet

Shiriti i navigimit që ka butonin Bazë mund të zhduket kur përdorni disa aplikacione ose veçori të caktuara. Për të parë shiritin e navigimit, tërhiqeni lart nga fundi i ekranit.

Heqja e baterisë

- Për të hequr baterinë, kontaktoni një qendër shërbimi të autorizuar. Për të marrë udhëzime për heqjen e baterisë, vizitoni www.samsung.com/global/ecodesign_energy.
- Për sigurinë tuaj, **nuk duhet të provoni ta hiqni** baterinë. Nëse bateria nuk hiqet si duhet, mund të çojë në dëmtime të baterisë dhe pajisjes duke shkaktuar dëmtime dhe të bëjë që pajisja të mos jetë më e sigurt.
- Samsung nuk pranon përgjegjësitë për asnjë dëmtim ose humbje (qoftë në kontratë ose ndryshe, përfshirë pakujdesinë) e cila mund të lindë nga mosndjekja e saktë e këtyre paralajmërimeve dhe udhëzimeve, përveçse vdekjes dhe lëndimeve të shkaktuara nga pakujdesia e Samsung.

E drejta e autorit

E drejta e autorit © 2025 Samsung Electronics Co., Ltd.

Ky udhëzues është i mbrojtur nën ligjet ndërkombëtare të të drejtave të autorit.

Asnjë pjesë e këtij udhëzuesi nuk mund të riprodhohet, shpërndahet, përkthehet ose transmetohet në asnjë formë me asnjë mjet, elektronik ose mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin ose ruajtjen në ndonjë sistem magazinimi.

Markat Tregtare

- Samsung dhe logoja Samsung janë marka tregtare të regjistruara të Samsung Electronics Co., Ltd.
- Bluetooth® është një markë tregtare e regjistruar e Bluetooth SIG, Inc. në të gjithë botën.
- Wi-Fi®, Wi-Fi Direct™, Wi-Fi CERTIFIED™, dhe logoja Wi-Fi janë marka tregtare të regjistruara të Wi-Fi Alliance.
- Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby, Dolby Atmos dhe simboli me dy D janë marka tregtare të Dolby Laboratories.
- Të gjitha markat e tjera tregtare dhe të drejtat e autorit janë pronë e pronarëve të tyre përkatës.